

Xhafer Durmishi
SKENDER

VEPRA
15



SKENA

Në janar të vitit 2010 për herë të parë, falë kujdesit të madh të Faridin Tafallarit u botuan të gjitha letrat e Jusuf Gërvallës dërguar Sabri Novosellës dhe disa të tjerëve. Përfundim bënë Raporti i korrikut 1981 i Jusufit për Degën e LNÇKVSHJ "Hasan Prishtina" në Turqi, të cilin për herë të parë m'u dha rasti ta lexoj më 30 maj 2011. Duke i pasur faktet në dorë dhe njohuritë e mia të detajuara se me çfarë force do t'i përdorja ato, ia fillova punës me përgatitjen e SKENËS, duke u munduar së pari, që gjatë vitit 2010 ta bëjë një reprizim të vitit 1980, me rastin e 30 vjetorit të daljes së Jusuf Gërvallës në skenën djalërisë atdhetare shqiptare dhe në ballë të luftës së popullit për liri dhe bashkim kombëtar.

Të gjitha punimet e mëposhtme dhe disa të tjera që nuk janë përfshirë në këtë përmbledhje, me pjesën kryesore të komenteve i përgatita për faqen www.pashtriku.org

N. N. "Përshëndetje Xhafer,

Siç të kam thënë: në saje të kujdesit dhe të përkushtimit tënd, gjatë këtij viti, Jusufi ishte i pranishëm mes nesh aq i ri, aq aktual dhe aq madhështor sa në kohën e tij, ndoshta edhe më shumë. Ashtu si dikur, pena e Jusufit po godet edhe sot si shpatë e Skënderbeut. Shëndet dhe përpara!" (5 gusht 2010)

1. JUSUF GËRVALLA ODISEU DHE BEKIMI I NËNËS
2. REVISTA "NIN" E BEOGRADIT FSHEH TË VËRTETËN MBI GJENDJEN E POPULLSISË SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI
3. LOKOMOTIVA E LËVIZJES
4. Letër e hapur satrapit J. B. Tito
5. LUFTA JONË ËSHTË E DREJTË
6. FAQJA POETIKE NË REVISTAT E JUSUF GËRVALLËS
7. PROCESI
8. "BASHKIMI" BËN FUQINË
9. "BASHKJETESA" E XHELATIT ME VIKTIMËN
10. TRADHTARËT E VJETËR DHE TRADHTARËT E RINJ
11. Kadare Jusuf Gërvalla dhe romani i tij "Rrotull"
12. SI U DENUAN SHABAN KLAIQI E ISLAM RAFUNA PËR ZËRIN E KOSOVËS
13. Baladë për vdekjen e Jusuf Gërvallës
14. UDB'a E PRANON SE I KA VRA: JUSUF E BARDHOSH GËRVALLËN
15. VËLLA I DHEMBJES KRENARE- S. Novosella
16. E DASHURA NANË SHQIPTARE FERIZ KUNUSHEFCI
17. Vrasja e poetit Ndoc Papeleka
18. Enver Hadri JA VDEKJE, JA LIRI!

1. JUSUF GËRVALLA ODISEU DHE BEKIMI I NËNËS

Në Prishtinë sot mbledhje komemorative në nderim të Bekim Fehmiut

Prishtinë, 21 qershor 2010 - Me rastin e vdekjes së aktorit të madh shqiptar Bekim Fehmiu, sot në kinemanë ABC në Prishtinë do të mbahet një mbledhje komemorative në nderim të aktorit të madh dhe veprës së tij. Ndërkaq dje në Prizren në prani të familjarëve të aktorit të ndjerë, bashkëshortes, dy djemve dhe vëllezërve, në diskrecion të plotë, **është hedhur hiri në lumin Lumbardh** (Bistricë) që kalon nëpërmes të Prizrenit. Bekim Fehmiu, 74 vjeçar, vdiq tragjikisht (bëri vetëvrasje) më 15 qershor në Beograd. (www.kosova.com)

Odiseu

është i thjeshtë çdo fillim
 duket se bie si yll në malin tuaj
 duket se frynë edhe bënë furtunë
 as sqota pulëbardhat i trembë
 është një zjarr tjetër si uji
 që rrjedh

2.
 nën tokë
 dhe tekdo që ta kërkosh e gjen
 s'ka në dorë as shpatë as lule, çudi
 bredh e bredh kudo e thotë
 "e vogël është kjo botë".

Bekimi i NËNËS

le të piquen pemët kur të kesh ardhur sërish
bari i zverdhur fare le të jetë
nën çatitë e kullës le të pikoj shi
le të vërë trashë cipa e tëmblit në kusi
le t'i marrë lumi urat e trerët le të thyhen
në cung le të ketë një shtëpi për dru
lulet e verës le t'i ketë prerë me barë kostari le të ftohet
ka stinë kur veç parzma e nënës do të ngrohet.

Marrë nga libri i parë me poezi "Fluturojnë e bien" i Jusuf Gërvallës, i botuar më 1975.
(www.pashtriku.org, 22 qershor 2010)

2. REVISTA "NIN" E BEOGRADIT FSHEH TË VËRTETËN MBI GJENDJEN E POPULLSISË SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI

www.pashtriku.org, 6 mars 2010

Në prill të vitit 1979, Revista „Ylli“ botoi artikullin me titullin "Revista NIN" e Beogradit fsheh të vërtetën mbi gjendjen e popullsisë shqiptare në Jugosllavi". Ishte ky një artikull që bëri jehonë shumë të madhe në Kosovë e në të gjitha viset shqiptare në Jugosllavi. Ky shkrim, në atë kohë, artikulon kulmin e luftës verbale-mediale në mes Qendrës shoviniste serbe, (UDB-së, NIN-it e Tanjugut) dhe ideatorëve të politikës dhe diplomacisë shqiptare të Tiranës. Revistën „Ylli“ nga Biblioteka Kombëtare e nxjerr Kadri Rexha për t'ia dhënë Jusufit. Në një ndejë në banesën e vet Kadriu e lexon këtë artikull në prani të Jusufit dhe të dhjetë shokëve të tyre më të ngushtë, me ç'rast artikulli analizohet dhe komentohet hollësisht. Me popullarizimin dhe përhapjen e ideve të këtij artikulli, nga gjiri i forcave të organizuara në Kosovë, mirret më së shumti Jusufi. Anëtarët e Lëvizjes konkrete me emrin "Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe Viseve Shqiptare në Jugosllavi", me fjalë tjera Lëvizjes së Jusuf Gërvallës, më 10 korrik 1979, nëpër shumë qytete të Kosovës shkruajnë parullën "NINi rren - Ylli nuk rren". Të arrestuarit e kësaj Lëvizje, në dhjetorin e vitit 1979, Shefqet Jashari, Ramadan Pllana, Avdi Kelmendi, Avdyl Lahu, Skender Jashari, Isa Demaj, Sylejman Qyqalla dhe Hysen Gërvalla, pas disa muajsh dënohen me një burg total prej 38 vitesh. Njëra ndër pikat rënduese të UDB-së mbi anëtarët e Lëvizjes është edhe propagandimi i artikullit të „Yllit“, të cilin për lexuesit po e sjellim në vijim. Faqja „Pashtriku.org“ është e vetmja faqe që, për herë të parë dhe në mënyrë të plotë, pas 30 vjetësh e riboton këtë artikull shumë e shumë herë të cituar. Asokohe ky artikull ngriti lartë frymën e qëndresës së shqiptarëve nën Jugosllavi dhe në të njëjtën kohë propagandimi i hapur i tij mund të konsiderohet si akti paralajmërues i daljes së Jusuf Gërvallës në skenën djalërisë atdhetare shqiptare dhe në ballë të luftës së popullit për liri dhe bashkim kombëtar.

Në shkrimet që ka botuar kohët e fundit për Kosovën revista e përjavshme "NIN" përpiqet të minimizojë prapambetjen ekonomike të kësaj krahine dhe në mënyrë të veçantë të kombësisë shqiptare dhe të fshehë shkaqet e vërteta të kësaj gjendjeje.

Me qëllim që të sqarohet e vërteta mbi prapambetjen e Kosovës, po botojmë këtu disa të dhëna të marra nga shtypi dhe statistikat zyrtare jugosllave që zbulojnë burimet dhe shkaqet e kësaj prapambetjeje, të cilat revista e Beogradit i lë në heshtje.

1

Dihet se Kosova është një zonë e begatshme me pasuri natyrore që ka minerale të shumta, toka pjellore shumë të përshtatshme për bujqësi si dhe një popullsi aktive punëdashëse. Megjithatë Kosova si edhe viset me popullsi shqiptare në Maqedoni dhe në Mal të Zi janë krahinat më të prapambetura të Jugosllavisë. Kjo prapambetje është rrjedhim i politikës diskriminuese që ndiqet ndaj këtyre krahinave.

Kosova është një vend i pasur me minerale. Rezervat e saj të qymyrit, të zbuluara deri tani, arrijnë në rreth 12 miliardë tonë dhe përbëjnë 64 për qind të të gjitha rezervave të këtij lloji të Jugosllavisë. Në këtë krahinë gjenden gjithashtu 30 për qind të rezervave energjetike të të gjithë Jugosllavisë, 24 për qind të rezervave të nikelit dhe të hekurit, 67 për qind të rezervave të plumbit dhe të zinkut, 28 për qind të rezervave të magnezit etj. Megjithëse disponon kaq pasuri të mëdha minerale dhe energjetike dhe si pasojë kushte shumë të favorshme për zhvillimin mbi këtë bazë të industrisë përpunuese, në Kosovë një gjë e tillë nuk është bërë.

Vendin kryesor në ekonominë e saj e zënë bujqësia, industria nxjerrëse dhe ajo e përpunimit fillestar të lëndëve të para. Industria e lëndëve të para minerale dhe ajo bazike japin 2/3 e prodhimit industrial. Po të shtojmë këtu peshën e madhe të industrisë tekstile që zë 18 për qind të prodhimit industrial të Krahinës, atëherë formojmë një ide të plotë për zhvillimin e njëanshëm të ekonomisë së Kosovës, për strukturën e saj të gjymtuar. Kosova përdoret si një burim që furnizon me lëndë të para e minerale të papërpunuara, me energji elektrike dhe me prodhime bujqësore republikat e tjera të Jugosllavisë. Në të njejtën kohë ajo është kthyer në një treg për shitjen e mallrave të gatshme të këtyre republikave.

Objektet më të mëdha të industrisë nxjerrëse të Kosovës janë Kombinati "Trepça" me qendër në Mitrovicë, me minierat e plumbit dhe të zingut, me uzinën e shkrirjes dhe rafinerinë e plumbit etj. si edhe Kombinati "Kosova" me qendër në Obiliq.

Kombinati "Trepça" është prodhuesi më i madh i plumbit dhe i zingut në Jugosllavi dhe një ndër të parët në Evropë dhe në botë. Minierat e tij po shfrytëzohen në mënyrë tepër intensive. Në vitin 1978 u nxorrën rreth 700 mijë tonë mineral plumb-zingut nga i cili një pjesë shkrihet në uzinën e Mitrovicës ndërsa pjesa tjetër shkon si mineral në uzinat e republikave të Jugosllavisë.

Kombinati "Kosova" që përfshin minierat e qymyrgurit, termocentralet e Obiliqit etj. jep 30 për qind të prodhimit industrial të Kosovës. Në këto miniera në vitin 1978 u prodhuan 8 milionë tonë qymyr. Ndërsa termocentralet e Kosovës me një fuqi të instaluar prej 800 mijë kilovatësh prodhuan gjatë vitit 1978, 3 miliardë e 485 milionë kilovatorë energji elektrike.

Këto burime minerale dhe energjetike nuk përdoren për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës, por shfrytëzohen kryesisht për të plotësuar nevojat e industrisë dhe të ekonomisë të republikave tjera, të Serbisë, Kroacisë, Sllovenisë dhe Maqedonisë. Kosova është e detyruar të furnizojë këto republika me energji elektrike në kohën kur ajo ka vetë

nevojë të madhe për këtë energji. Nga sasia e përgjithshme e energjisë elektrike që prodhon Kosova më shumë se 2/3 shfrytëzohet nga republikat e Jugosllavisë. Ndonëse Kosova është prodhuese e madhe e energjisë elektrike, sasia që konsumon këtu një familje është me e pakët se ajo që konsumojnë familjet në republikat dhe se mesatarja e Jugosllavisë. Mungesën e madhe të energjisë elektrike e ndjen sidomos fshati kosovar, i cili ende nuk është elektrifikuar plotësisht. Nga 22 komuna të Kosovës elektrifikimi është përfunduar vetëm në 9 komuna. Nga rreth 1300 fshatra 250 janë fare të paelektifikuara. Qindra të tjerë janë të elektrifikuar vetëm pjesërisht. Fshatra të paelektifikuara ka edhe në komunat e Prishtinës dhe të Mitrovicës që janë qendrat kryesore të Kosovës.

Edhe qymyri dhe gazi i prodhuar në Kosovë shkon në një masë të konsiderueshme në republikat e tjera. Nga 200 milion m³ gaz që parashikohej të prodhohej në Kosovë në fund të vitit 1978, 148 milionë m³ ishte caktuar për Uzinën metalurgjike të Shkupit në Maqedoni.

Minierat e "Trepçës" si dhe minierat e tjera që janë kuçe të ekonomisë së Kosovës mbahen rigorozisht nën kontrollin e Beogradit, në institucionet e të cilin janë përqendruar të gjitha studimet dhe analizat që kanë të bëjnë me ngritjen dhe shfrytëzimin e tyre.

Kosova si një krahinë kryesisht me karakter bujqësor dhe blegtoral ka gjithçka të nevojshme për zhvillimin e industrisë së lehtë ushqimore e përpunuese. Megjithatë kjo e industrisë nuk ka gjetur zhvillim të mjaftueshëm për shkak se produktet e saj bujqësore e blegtorale shkojnë si lëndë e parë në fabrikat e republikave të Jugosllavisë. Në shtypin kosovarë, në tetor 1978 shkruhej kështu: "Kosova nuk e ka industrinë e përpunimit të grurit. Prodhon vetëm bukë. Republikat e tjera vijnë e marrin miellin me 4-5 dinarë 1 kg dhe na e shesin neve në Kosovë dhjetë herë më shumë si biskota, fidhe, makarona etj." Kjo lloj ndarje apo siç e quajnë në Jugosllavi "specializim i punës" brenda shtetit jugosllav e ka vënë Kosovën dhe popullsinë e saj në pozitë diskriminuese të një shkëmbimi ekonomik të pabarabartë, joekuivalent. Prapambetja dhe struktura e pavolitshme e Kosovës kushtëzohet jo vetëm nga gjendja e trashëguar, sikurse pohojnë në Beograd. Kryesorja është politika e interesave të ngushta të kapitalit të madh që ndodhet kryesisht në republikat e zhvilluara të Veriut, të cilat investojnë kreditë në sektorët që nuk i leverdisin ekonomisë kosovare. Sikurse pohon shtypi kosovar, "Krahina, në thelb më tepër i është përgjigjur nevojave të industrisë së zhvilluar në vend (në Jugosllavi), sesa zgjidhjes së problemeve kyçe të zhvillimit të vet, si inkuadrimi i popullsisë së aftë për punë dhe zgjerimi i akumulimit." Kjo është një politikë e përhershme e ndjekur në Jugosllavi dhe që synon të shfrytëzoj rezervat minerale dhe energjetike të Kosovës duke e maskuar këtë me thënie të tilla se gjoja është i "pavlefshëm mendimi që në Kosovë krahas industrisë nxjerrëse të zhvillohet edhe industria përpunuese".

2

Pasojat e kësaj politike shfrytëzuese dhe diskriminuese duken sidomos në të ardhurat për frymë të popullsisë që në Kosovë janë nga më të ulëtat e Jugosllavisë. Më 1957 arrinin në 49 për qind të mesatares së vendit, ndërsa pas 20 vjetëve ranë në 33 për qind të mesatares së Jugosllavisë. Të ardhurat kombëtare për frymë në Kosovë janë 6 herë më të pakta se në Slloveni. Sikurse rezulton nga të dhënat statistikore jugosllave gjatë viteve 1976-1978 prodhimi shoqëror i krahinës së Kosovës ishte parashikuar të rritej me një ritëm vjetor 60 për qind më të lartë se mesatarja e Jugosllavisë. Në fakt ky ritëm ka qenë 50 për qind më i ulët se kjo mesatare. Pra prirja e zhvillimit të ekonomisë kosovare shkon në të kundërtën e parashikimeve të bëra. Kjo ka çuar në atë që të thellohen edhe më shumë dallimet e prapambetja e saj në krahasim me ekonominë e republikave të tjera.

Ja dhe një fakt tjetër që dëshmon për këtë. Gjatë vitit 1978 ritmi i rritjes së prodhimit industrial në Kosovë ka qenë 4-5 herë më i vogël se ai i Serbisë.

Shfrytëzimi i Kosovës duket edhe në politikën e investimeve. Në Kosovë, si në gjithë Jugosllavinë, po përhapet gjithnjë e në shkallë më të gjerë sistemi kapitalist i dhënies së kredisë nga ana e bankave në vend të financimit buxhetor të investimeve për zhvillimin e forcave prodhuese dhe të aktiviteteve të tjera. Shtypi kosovar vë në dukje se "ekonomia e Kosovës është mbështetur dhe po mbështetet kryesisht në shfrytëzimin e kredive të fondit federativ dhe të kredive ndërkombëtare."

Ky sistem ka bërë që mbi 90 për qind e mjeteve financiare që janë përdorur në ekonominë e Kosovës gjatë vitit 1978 t'u përkasin bankave jugosllave dhe atyre të huaja dhe vetëm 7,7 për qind të vijnë nga të ardhurat e Kosovës. Mirëpo bankat, qofshin ato jugosllave apo të huaja bëjnë investime kryesisht në objekte me karakter tregtar, turistik ose në objekte tjera që janë shumë rentabile dhe sigurojnë fitime të mëdha. Kreditë jepen me kamatë të lartë dhe afate të shkurtra. Kjo mënyrë kreditimi e kufizon shumë mundësinë e investimeve dhe pengon zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Shtypi kosovar shkruan se aftësia riprodhuese e akumuluese e Krahinës po zvogëlohet nga viti në vit ndërsa borxhet e saj po shtohen shumë. Më 1978 kreditë e papaguara u shtuan dhe arritën shumën 2,4 miliardë dinarë. Vetëm si kamatë për kreditë më 1978 Kosova pagoi 1 miliardë dinarë. Po të shtojmë këtu edhe humbjet në industri që më 1978 arritën në 1 miliardë e 630 milionë dinarë, atëherë bëhet e qartë se përse vetëm 7,7 për qind e investimeve financohen nga burimet e vet Kosovës. Edhe ato pak fonde që ishin destinuar për investime janë realizuar vetëm 40 për qind. E ndodhur përballë kësaj gjendjeje Kosovës iu desh të marrë kredi të reja. Kështu më 1978 për çdo 100 dinarë të investuar ajo kishte 140 dinarë borxhe.

Kosova dhe popullsia e saj shfrytëzohet jo vetëm nga borgjezia jugosllave, por edhe nga ajo e shteteve imperialiste e socialimperialiste nëpërmjet kapitaleve që investojnë këtu, kryesisht në formën e huave. Më 1978 Banka ndërkombëtare për rindërtim dhe zhvillim i akordoi Jugosllavisë një kredi tjetër prej 100 milion dollarësh nga e cila 40 milionë dollarë iu dhanë Kosovës. Deri në fund të vitit 1978 sipas marrëveshjeve ajo duhej të merrte nga SHBA një kredi prej 140 milionë dollarësh. Në Kosovë ka filluar të futet kapitali i socialimperializmit sovjetik i cili u angazhua, sipas marrëveshjes së 1978 t'i jap firmës "Feronikelit" në Glllogovc një kredi prej 34 milionë dollarësh. Krerët e Kosovës që kanë deklaruar se "Kosova është e hapur për botën e jashtme", i kanë ofruar firmave kapitaliste të Francës, RF Gjermane, Austrisë, Italisë si dhe vendeve të Evropës Lindore që të bëjnë investime kreditive për shfrytëzimin e minierave e sidomos të qymyrit të saj. Prapa këtyre kredive fshihet synimi i kapitalit të huaj për të shfrytëzuar pasuritë natyrore të Kosovës.

Prapambetja ekonomike reflektohet edhe në prapambetjen teknike-shkencore të Kosovës. Për këtë dëshmon edhe fakti se 95 për qind e projekteve të atyre pak objekteve që ndërtohen në këtë Krahinë i bëjnë ndërmarrjet e projektimit që ndodhen jashtë saj, në republikat e tjera. Po kështu 45 për qind e këtyre objekteve ndërtohen nga firmat jugosllave.

Politika e "gërshërës" së çmimeve që vendosen nga qendra është mjete më i preferuar që zbaton borgjezia jugosllave për të nxjerrë fitime sa më të mëdha. Prodhime të tilla si drithi, energjia elektrike, qymyrguri etj. i mirren Kosovës me çmime më të ulta dhe të pandryshueshme. Shtypi kosovar duke bërë fjalë për humbjet e industrisë nxjerrëse të "Trepçës" e minierave të tjera shkruan se "kjo industri është vënë në regjimin e kontrollit rigoroz të çmimeve të ulëta".

Ndërsa çmimet e prodhimeve industriale që vijnë në Kosovë nga republikat ngrihen vazhdimisht. Kosova është e privuar nga kjo e drejtë dhe nuk mund të ngrej

çmimet e prodhimeve kryesore të saj që u shet republikave duke u vënë kështu në pozita krejt diskriminuuese. Gjatë vitit 1978 vazhdoi grindja midis Kosovës dhe Maqedonisë për shkak se Maqedonia ia merrte energjinë elektrike me çmim shumë të ulët, nën nivelin e atij jugosllav. Një politikë e tillë në caktimin e çmimeve i sjell humbje të mëdha ekonomisë së Kosovës dhe ka ulur shumë shkallën e akumulimit të saj. Gjatë vitit 1977 në Kosovë dolën me humbje 132 ndërmarrje me një shumë të përgjithshme prej 1 miliardë e 250 milionë dinarësh. Ndërsa në vitin 1978 numri i ndërmarrjeve me humbje u rrit në 161 dhe shuma e humbjes në 1 miliardë e 638 milionë dinarë që është 35 për qind më e madhe se ajo e vitit 1977.

Politika e çmimeve që ndjek Federata dhe republikat ndaj Kosovës dhe që i ka shkaktuar humbje ndërmarrjeve kosovare bënë që në fakt një pjesë e madhe e të ardhurave kombëtare të krijuar me mundin dhe djersën e punëtorëve kosovarë të rishpërndahet dhe të shkojë në favor të republikave. Po të shikohet buxheti federativ dhe ai i republikave del se gjoja janë këto që kompensojnë buxhetin e Kosovës. Në realitet është ekonomia e Kosovës ajo që u jep të ardhura republikave të tjera dhe buxhetit federativ.

Tregu kosovar në një masë të konsiderueshme është në duart e 200 firmave tregtare të republikave të Jugosllavisë që kanë në Kosovë përfaqësitë e tyre dhe rreth 600 njësi tregtare nga të cilat 200 në Prishtinë. Shtypi kosovar shkruan se "qëllimi i tyre është të vjelin sa më shumë para dhe pa prituri muzgun t'i dërgojnë në republikat jashtë Kosove". Krahina nuk ka të drejtë t'u vërë tatime firmave jokosovare që sigurojnë në Kosovë qindra milionë dinarë fitime.

Tregtia e jashtme e Kosovës sikurse ajo e tërë Jugosllavisë ka defiçite të mëdha. Sipas të dhënave të Entit të Statistikave të Beogradit, Jugosllavia ka një defiçit të madh tregtar që arrin në 79 miliardë dinarë. Më 1977 bilanci negativ i tregtisë së jashtme të Jugosllavisë arriti 4 miliardë dollarë, ndërsa rezervat në devizë ishin vetëm 2,8 miliardë dollarë. Nga ana e vet tregtia e jashtme e Kosovës më 1978 pati një defiçit prej 1 miliardë e 184 milionë dinarësh.

Një nga tiparet e jetës ekonomike të Kosovës është edhe zgjerimi i zejtarisë private. Shtimi i dyqaneve dhe punishteve private inkurajohet me anë të ligjit. Më 1977 në Kosovë kishte 5086 punishte artizanale private ku shfrytëzohen mijëra punëtorë... Në mjaftë raste pronarë të ndërmarrjeve të tilla kapitaliste, sidomos të atyre hoteliere janë "biznismenët ilegalë" që punojnë në sektorin e ashtuquajtur shoqëror ("vetadministrues").

3

Ekonomia bujqësore, që është sektori më i prapambetur i ekonomisë së Kosovës, ndodhet në një krizë të rëndë që është pasojë e varfërimit të familjeve fshatare dhe e thellimit të polarizimit klasor në fshat. Prodhimi bujqësor ka ardhur gjithnjë duke rënë. Megjithëse me të merret gjysma e popullsisë, ajo jep sot vetëm 20,9 të prodhimit shoqëror.

Në bujqësinë kosovare, si në gjithë ekonominë jugosllave, zotëron prona private. Ka një copëzim shumë të madh të pronave, numri i parcelave individuale arrin në 1840 000. Sektori privat në bujqësi ka në duart e veta 88 për qind të tokave të punueshme të Kosovës, rreth 310 mijë ha tokë, 95 për qind të fondit të bagëtisë dhe 5/6 e mekanikës bujqësore. Nga 10 000 traktorë që u përdorën më 1978 e që përgjithësisht kanë fuqi të vogël, më shumë se 8000 janë pronë e fshatarëve të pasur. Për të inkurajuar sektorin privat, bankat jugosllave japin kredi për ngritjen e "minifermave" bujqësore dhe blegtorale, për të blerë tokë, bagëti. Deri më sot Banka e Kosovës ka akorduar kredi për ngritjen e 580 fermave të fshatarëve të pasur.

Vendin kryesor në bujqësinë e Kosovës e zë kultura e misrit, rreth 62 për qind e tokave të mbjella. Shtypi kosovar shkruan se bujqësia kosovare ka rendimentin më të ulët në Jugosllavi. Edhe blegtoria që jep 33 për qind të prodhimit të përgjithshëm bujqësor ka një rendiment shumë të ulët. Bagëtitë e sidomos lopët janë të racave të dobëta. Bujqësia vazhdon të ketë humbje të mëdha. Më 1978 humbjet në prodhimet bujqësore ishin gati tre herë më të mëdha se më 1977. Kulturat pranverore më 1978 patën një humbje prej 40-70 për qind. U vol vetëm 35 për qind e prodhimit të parashikuar të lulediellit. Të korrat e misrit ishin 70 për qind më të pakta se parashikimi.

Në Kosovë nuk tregohet interesim për bujqësinë. Mungon sistemi ujitës, mekanika bujqësore etj. Edhe ato mjete mekanike që ekzistojnë nuk shfrytëzohen si duhet. Kosova ka më pak quadro bujqësore nga të gjitha viset e Jugosllavisë: ndërsa Jugosllavia ka 1 specialist bujqësor për çdo 270 ha tokë, në Kosovë ka 1 specialist për 700 ha tokë.

Mungesa e interesimit të qarqeve drejtuese jugosllave për ekonominë bujqësore ka çuar në braktisjen e bujqësisë. Sipas të dhënave të shtypit kosovar, gjatë viteve 1968-1978 gjysma e popullsisë së fshatrave ishte nën ndikimin e emigracioneve të jashtme, të përhershme ose të përkohshme. Edhe pse Kosova është një krahinë me toka shumë pjellore, me një bujqësi me tradita të mira, me bujq punëdashës, si rezultat i krizës së thellë bujqësore që e ka mbërthyer, ajo u detyrua që në vitin 1978 të blejë jashtë mijëra ton misër për nevojat e popullsisë.

4

Akoma më të prapambetura janë viset me popullsi shqiptare në Maqedoni dhe Mal të Zi. Në prapambetje të theksuar ndodhen komunat e Tetovës, Dibrës, Gostivarit, Kumanovës etj. për çka shkruan vetë shtypi maqedonas. Investimet e parashikuara për vitet 1976-1980 për komunën e Tetovës nuk po realizohen. Nga 2,5 miliardë dinarë që duhej të realizoheshin në 2 vjet e gjysmë, u realizuan vetëm 764 milionë ose 30 për qind e shumës së parashikuar. Shtypi maqedonas e shpjegon këtë gjoja me "aftësitë e pakta akumuluese të kësaj komune". Investimet që janë bërë në komunën e Dibrës kanë për qëllim të shfrytëzojnë burimet energjetike dhe lëndët e saj të para bujqësore e blegtorale. Energjia elektrike e prodhuar në hidrocentralin "Spile" të Dibrës përbën 1/3 e energjisë elektrike të të gjithë Maqedonisë, megjithatë në këtë komunë si edhe në komunat tjera me popullsi shqiptare ka ende shumë fshatra të paelektrofikuara.

Edhe në fushën e ekonomisë ndiqet një politikë e theksuar diskriminuese ndaj kombësisë shqiptare. Punëtorët dhe personeli inxhiniero-teknik i atyre objekteve industriale që janë ndërtuar në komunat e Tetovës, Dibrës, Gostivarit etj. janë kryesisht të kombësisë maqedonase. Dibra, Tetova, Gostivari etj. kanë kushte të mira për bujqësi e blegtori megjithatë këto degë kanë mbetur të pazhvilluara dhe me rendimente shumë të ulëta. Është pakësuar sidomos numri i krerëve të bagëtisë.

Në viset me popullsi shqiptare të Malit të Zi, në Ulqin, Tivar, Tuz, Krajë, Guci etj. nuk ka asnjë fabrikë apo objekt të rëndësishëm industrial. Ishte parashikuar të ndërtohej një fabrikë për punime të drurit në Ulqin por edhe kjo nuk u realizua. Tokat e Ulqinit në Mal të Zi përmythen nga Buna, ndërsa sipërfaqe të tjera të mëdha nuk punohen. Edhe fusha e Ulqinit me 4 mijë ha tokë pothuajse lihet e papunuar në kohën kur mijëra ulqinakë braktisin vatrat e tyre. Qindra familje fshatare të viseve me popullsi shqiptare të Malit të Zi nuk kanë dritë elektrike. Shtypi kosovar shkruan se vetëm në Triesh e Tuz ka 800 shtëpi të paelektrofikuara.

Papunësia dhe emigracioni ekonomik janë plagë të rënda për Kosovën dhe viset me popullsi shqiptare të Maqedonisë dhe të Malit të Zi. Sipas statistikave kosovare popullsia e aftë për punë në Kosovë përbën 52 për qind të popullsisë së përgjithshme, d.m.th. rreth 800 000 frymë. Nga kjo popullsi deri në fund të 1978 ishin në marrëdhënie pune në sektorin e ashtuquajtur "vetadministrues", vetëm 156 mijë vetë nga të cilët 30 mijë janë gra. Rreth 117 mijë janë të zënë me punë në sferën ekonomike, ndërsa pjesa tjetër në administratën shtetërore, organizatat shoqërore, në arsim-kulturë etj.

Shkalla e zënies me punë e popullsisë së Kosovës është shumë e ulët, më e ulëta në tërë Jugosllavinë. Më 1978 në Slloveni ishin në marrëdhënie pune 40,3 për qind e popullsisë, kurse në Kosovë vetëm 10 për qind. Siç del nga shtypi kosovar edhe struktura kombëtare e njerëzve të zënë në punë është diskriminuese për shqiptarët. Në Kosovë i takon që të jetë në marrëdhënie pune 1 në çdo 4-6 malazezë e serbë dhe 1 në çdo 18 shqiptarë.

Papunësia dhe emigracioni ekonomik në Kosovë kanë marrë përmasa të mëdha. Në fund të vitit 1978 ishin regjistruar për të kërkuar punë rreth 65 mijë vetë. Shtypi kosovar shkruan se numri i tyre është shumë më i madh sepse ka shumë të papunë të tjerë që nuk regjistrohen në zyrat e punës. Shumica e të papunëve, rreth 70 për qind janë të rinj, nën 30 vjeç. Një pjesë e mirë e tyre, 30 për qind janë punëtor të kualifikuar, të rinj me shkollë të mesme e të lartë. Me mijëra janë ata që kanë 3 vjet e lart që janë regjistruar dhe presin të gjejnë punë. Midis të papunëve ka edhe gra, megjithëse gratë në shumicën e tyre, 90 për qind merren me punë shtëpiake dhe nuk regjistrohen për të kërkuar punë.

Komuna e Tetovës në Maqedoni dallohet për nga numri i shqiptarëve të papunë që arrin në 4500 vetë, në kohën kur sillen e vendosen në punë punëtorë maqedonas nga vise të largëta. Po kështu në Gostivar më 1978 ishin të regjistruar 2000 të papunë.

Papunësia shtohet më shumë duke futur sistemin e punës jashtë orarit. Gjatë vitit 1978 në Kosovë punuan me orar të zgjatur 51 865 punonjës.

Papunësia ka detyruar popullsinë e Kosovës, të viseve me popullsi shqiptare të Maqedonisë dhe të Malit të Zi, të shkojnë për punë jashtë shtetit, në vendet e Evropës e sidomos në Gjermaninë Perëndimore, në Belgjikë, Austri etj. Sipas të dhënave jo të plota, numri i shqiptarëve që kanë emigruar nga Kosova jashtë trojeve amtare arrin në 100 mijë vetë nga të cilët 40 mijë në Jugosllavi dhe 60 mijë në Evropë. Mijëra të tjerë kanë emigruar nga viset me popullsi shqiptare të Maqedonisë dhe të Malit të Zi. Vetëm nga komunat e Tetovës, Gostivarit, Strugës, Kumanovës kanë emigruar rreth 16 mijë shqiptarë, ndërsa nga Ulqini 4000. Sikurse thekson shtypi kosovar numri i shqiptarëve që kanë shkuar me punë të përkohshme jashtë Jugosllavisë është edhe më i madh, por një pjesë e tyre nuk shkon me anë të zyrave të posaçme që janë ngritur në Jugosllavi, por në mënyrë individuale.

Faktet e mësipërme vërtetojnë plotësisht se prapambetja e madhe e Kosovës dhe e viseve të tjera me popullsi shqiptare të Maqedonisë dhe të Malit të Zi është pasojë e politikës diskriminuese dhe kolonizuese që ndiqet ndaj popullsisë shqiptare.

Marrë nga YLLI, Revistë politiko-shoqërore dhe letraro-artistike
4 (222) Prill 1979 (www.pashtriku.org, 6 mars 2010)

3. LOKOMOTIVA E LËVIZJES

Jusuf Gërvalla: "Pardje dy javë, më 14 dhjetor, natën vonë e braktisa Prishtinën dhe Kosovën.

(...) Shoku i Lëvizjes, Bashkim Prishtina (Sabri Novosella - shën i Xh. D.), qe i mendimit se është shumë më mirë të arratisem, se sa të bie në burg: edhe dënimi do të kish qenë i rëndë, edhe do të rrezikohej eventualisht organizata.

(...) Bardhi s'kishte sjellë me vete ndonjë dokument të vyer për mua, mirëpo, me ardhjen e tij, unë u çlirova shumë. Para dreke bëmë ca plane, më në fund vendosëm që për Austri të ikja më këmbë, nëpër tunelin që shpie nga Hrushica (4-5 km larg Jesenice) deri në Rosenbah të Austrisë.

Në orën 17,30 u ndalëm me veturë në rrugën automobilistike të Hrushicës, 30-40 km nga tuneli. U nisa. Bardhin e porosita që po s'iu ktheva për 10 minuta, të nisej edhe ai me veturë për në Austri, nëpër kalesën kufitare në Podkoren të Kranjska Gorës. Afër hyrjes në tunel, pasi përgjova mirë e s'diktova njeri ndër oborret e ndër shtëpitë pranë, m'u ndërsye një qen. Ia lëshova dritën e baterisë së dorës dhe hyra me vrap në tunel.

Tunelin, 8100 m, e kalova, së paku 70% të gjatësisë, me vrap. Ishte aksioni im i parë në jetë në të cilin kisha hyrë me rrezik 100% që ose të shpëtoj, ose të bie në burg, ose, madje, edhe të vritem." (Jusuf Gërvalla, Vepra -vëllimi 4, Prishtinë 2010, f.245-247)



Jusuf Gërvalla, lokomotiva e qëndresës shqiptare, ka kaluar nëpër këtë tunel të trenit - për në Austri

TUNELI I KARAVANKEVE

Në ditarin e tij - Jusuf Gërvalla thotë se ka kaluar nëpër tunelin e Karavankeve, që lidhë Slloveninë me Austrinë. Tuneli i Karavankeve (gjermanisht: Karawankentunnel, sllovenisht: Predor Karavanke) është tuneli i katërt për nga gjatësia i Austrisë dhe më i

gjati i Sllovenisë me një gjatësi prej 7976 m. Rruga hekurudhore kalon në mes Rosenbachut në Austrinë jugore dhe Jesenicës në Slloveninë veriore. Tuneli është pjesë e rëndësishme e Hekurudhës të Karavankeve, e cila së bashku me Hekurudhën e Bohinjit është ndërtuar që të lidhë portin e Trieshtës me Klagenfurtin, kryeqytetin federal të Carinthia në Austri.

Në mes viteve 1867-1918, Trieshta ka qenë pjesë e Perandorisë Austro-Hungareze. Ajo (Trieshta) ka qenë porti kryesor për tregti tej oqeanike i mbretërisë së dyfishtë, por i mungonte lidhja adekuate e komunikacionit me Austrinë e brendshme. Për t'i dhënë një shtytje tregtisë së Trieshtës dhe Austrisë në përgjithësi, më 1901 vendoset të ndërtohet Hekurudha e Karavankeve e cila do të lidhte Trieshtën me Klagenfurtin. Hekurudha ndërtohet përmes Alpeve Karavanke, më e gjata hekurudhë malore në Evropë (120 km) në kufirin e sotshëm të Austrisë dhe Sllovenisë.

Tuneli i Karavankeve është inauguruar në 1 tetor 1906, nga Kryeprinci Franc Ferdinand, pra më 1 tetor, në ditën e cila në kalendarin shqiptar njihet si dita, kur Jusuf Gërvalla në 1 tetorin e vitit 1945 lindi në fshatin Dubovik të komunës së Deçanit.

Tuneli edhe sot ka rëndësi në qarkullimin e trenave ndërkombëtar. Një për të kalojnë më shumë se 80 trena në ditë.

Tuneli hekurudhor i Karavankeve nga bota do të vazhdoj të quhet Tuneli i Karavankeve, por për popullin shqiptar ky Tunel ka një simbolikë më të fuqishme se sa ajo që ka të bëjë me tregtinë. Ky Tunel ia zgjati jetën Jusuf Gërvallës për 25 muaj rresht, deri në vrasjen e tij më 17 janar 1982, dhe gjatë kësaj kohe Jusufi me bashkëveprimtarët e tij veproi pa u lodhur në mobilizimin e shqiptarëve në shtetet perëndimore për çlirimin e Kosovës së robëruar si dhe shkroi Programin kombëtar, dhe atë program e nisi për Kosovë përmes shokëve të tij, të cilët kaluan shumë herë pikërisht nëpër këtë tunel të shpëtimit.

Në youtube mund të gjenden xhirime filmike të shumta nga kënde të ndryshme dhe nga perspektiva e drejtuesit të lokomotivës, prej nga shihet rruga nëpër të cilën ka kaluar **Jusuf Gërvalla, LOKOMOTIVA E QËNDRESËS SHQIPTARE** në vitet 1980 dhe 1981.

4. Letër e hapur satrapit J. B. Tito

30 vjet nga dalja në skenë e Jusuf Gërvallës

Jusuf Gërvalla, pas largimit nga Kosova (14 dhjetor 1979), u vendos në Ludwigsburg të Gjermanisë, dhe qysh në ditët e para, me ndihmën e vëllaut të tij-Bardhoshit, kontakton dhe e njofton organizatën "Amnesty international" lidhur me situatën politike në Kosovë, pas burgosjeve masovike të shqiptarëve në fundvitin 1979. "Lajmet e fundit nga Kosova, përmes njerëzve që po vijnë së andejmi, thonë që burgosjet po vazhdojnë ende dhe se numri i të burgosurve ka arritur deri në 2000 vetë."- kështu shkruante Jusuf Gërvalla në ditarin e tij. Për këtë situatë të rëndë (që po mbretëronte në Kosovë) Jusufi ka shkruar edhe një material prej 13 faqesh, për revistën e njohur "Der Spiegel". Në këtë drejtim Jusufi nuk ndalet për asnjë çast. Ai, duke qenë i preokupuar në çdo moment, me atë çfarë po ndodhte në Kosovë dhe viset tjera shqiptare nën regjimin e Jugosllavisë titiste, në janar të vitit 1980 i ka shkruar edhe një letër të hapur satrapit

J.B.Tito. Faqja www.pashtriku.org, në vazhden e publikimit të materialeve arkivore, në "30 vjetorin e daljes në skenë (publikisht) të Jusuf Gërvallës", për herë të parë i sjellë opinionit shqiptar këtë letër, e cila pa diskutim ka vlerë të madhe historike. (Moderatori i pashtriku.org, 18. 07. 2010)

Letër e hapur satrapit J. B. Tito

Njeriu ka një të metë: ai di të mendojë!
(dordolecët dhe udbashët)

Nga Jusuf Gërvalla

Në të kaluarën tonë historike, para çdo vizite të sulltanëve në Shqipëri, thonë se nga Kryeqendra e Perandorisë çonin dofarë dordolecësh që e neverisinin dhe e shqetësonin popullin me të panjohurën që sillnin me vete. Pas tyre, bashkë me sulltanët, vinin edhe poetë kopukë, që kishin për detyrë ta madhëronin me këngë lavdinë e perandorëve. Në fund arrinte lartmadhëria e tij, sulltani, "fuqia e allahut në tokë", i cili, duke pasur "mall të madh për shqiptarët", s'e bënte as gjumin gjumë.

Nga ata që dilnin për ta pritur disa përuleshin sa më poshtë, se atje, në uljen dhe poshtërimin sa më të madh, gjendej thesari që u duhej atyre në këtë botë; të tjerë, si të shpëlarë trush, bënë sehir duke u hamendur në është ati I sulltanit kalë apo pelë; të tretët, duke pasur punë shumë më të urta në rrethanat e jetës skëterrë në robëri, mezi prisnin të kryhej formaliteti i pritjes dhe pa e vrarë fare mendjen pse ishte kështu kjo e ashtu ajo punë, ktheheshin tek fëmijët, tek gratë e veta, tek plangjet e veta, te puna e vet e krahut. Ishte ndërmjet tyre një palë njerëz kokëturjelë, të cilëve, thonë, hija e sulltanit mbi tokat e tyre ua shëmtonte ditën, se ia dinin gjithë marifetet atij, sulltanit, hijes së pejgamerit në tokë dhe kopukëve të tij që e prisnin me lepe-peqe, ia dinin të gjitha, edhe avazin këngës së poetëve kopukë. Prandaj, sa herë që vinte sulltani në trojet e tyre, ata seç bluanin plane të turbullta, sikundër ishin mësuar të mendonin edhe kur sulltani gjendej në selinë e vet të shenjtë, se ndryshe nuk dinin të mendonin kurrë.

Kish ilaç sulltani edhe për këta: litarin, burgun ose arratinë. Se ishin rebelë dhe rebelët i kishte rëndë toka e Perandorisë.

Në të sotmen e pjesës së robëruar të Shqipërisë, në Kosovë, vizitave të sulltanit Tito u prijnë agjentët dhe xhandarët e UDB-së, dukja e të cilëve është diçka më konkrete se ajo e dordolecëve, si në kohë kolendrash apo në kohë bajrami. Xhandarët hyjnë me rrëmbim shtëpi më shtëpi të shqiptarit, tym për tym marrin nga një mashkull (mundësisht më të mirët) dhe i bëjnë tok krye për krye në burgjet e Kosovës; e kur në këto burgje nuk mbetet vend, atëherë i mbyllin edhe nëpër bodrume të përshtatshme, duke ua lënë rojen përmbi kokë. Por, nëqoftëse as kjo nuk ka bërë punë për shuarjen e rebelimit të shqiptarëve, atëherë Titoja, si munxadhënësit e dikurshëm të perandorisë turke, nga Beogradi (selia e shenjtë e perandorisë jugosllave) kthehet me fytyrë nga Kosova, i drejton andej duart dhe ua përcjell shqiptarëve munxën: frikë sa më shumë për shqiptarët, mallkim të tmerrshëm për ta, o Zot! (O Karter! O Brezhnjev!) Atëherë, sa çel e mëshel sytë, burgjet jugosllave mbushen me vajza e djem të popullit, të cilët s'e kanë fort për lalë t'i shtrohen robërisë pa e qitur së paku atë fuqi që kanë.

Ky rit mistik, ky maskembull i pashembullt u përsërit edhe në nëntorin e vitit të kaluar në Kosovë.

Pa paralajmërimet e zakonshme pas të cilave Kosova përgatitet gjatë e gjatë, duke bërë mure dërrasash që ta fshehin realitetin për festën e pritjes së sulltanit Tito, ky bajloz i zi kësaj rradhe doli papritmas nga errësira dhe u sul mbi këtë pjesë të robëruar të

Shqipërisë që revizionizmi jugosllav e ka dërmuar tej mase në planin ekonomik, social, kulturor...

Kumbuan daullet, që bien në Beograd e të shurdhojnë në Kosovë. Në faqet e "Rilindjes", Radio Prishtinës dhe të Televizionit të Prishtinës, ato sillnin breshër: "Rrofsh sa malet shoku Tito - e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja jonë"!

Dhe nuk na lëshoi toka nga kjo hata. (E kaluara jonë sikur filloka në vitet dyzet të këtij shekulli, e jo më se para tremijë vjetësh!) Është bërë imune Kosova ndaj kësaj fatkeqësie, që po tërbohët me dekada si një rrebesh i fëlliqur, por s'po na shfaros dot.

U turrën dordolecët e UDB-së shtëpi për shtëpi dhe morën me vete (së paku) nga një mashkull, për t'ua kthyer sigurinë dhe rehatinë rrugëve nga duhej të parakalonte sulltani.

Populli shqiptar i Kosovës: fëmijë të rritur (bërrr, të ngjethet lëkura), nxënës, studentë, nëpunës, punëtorë, fshatarë, me një inercion e neveri të papërshkrueshme, lejuan kësaj radhe t'i organizojnë me dhunë për pritjen që u desh t'i bëhet satrapit Tito.

E atje, në rrugë, në "festën e pritjes", në "pritjen madhështore", ç'të shohësh:

Ndërmjet rreshtave të pafundmë të njerëzisë së nxjerr me dhunë në rrugë, ku për çdo njeri UDB-ja kishte siguruar nga një polic, kolona e automobilave të zez korb kaloi me një shpejtësi afro 80 km në orë. Sulltani i turpshëm i kishte lëshuar perdet në veturën e tij të zezë me gjashtë dyer!

(njeriu i vdekur dhe jonjeriu)

E para "Rilindja", Radioja dhe Televizioni u ranë me të madhe kambanave se kësaj radhe, ti, i dashuri i peygamberit dhe fuqia e allahut në tokë, sulltani Tito, kishte ardhur jo vetëm "të çmalleshe me shqiptarët e tu të dashur", po edhe të ndërmerrije diçka konkretisht për zbatimin rigoroz "të ndihmave" të Federatës për "zhvillimin e shpejtuar" të Kosovës. Megjithë robërinë, sikur këto qëllime të kishin qenë të vërteta, janë punë që nuk mund të quhen apriori të këqija, të dënueshme. Prandaj, ç'të frikësoi te kosovarët? Ata nuk ia duan të keqen vetes dhe dinë ta dallojnë mikun nga anmiku. Prandaj, s'ka si të mendohet se ata nuk duan zhvillimin e vet dhe se nuk dinë kish është ai që ua do të mirën dhe që i ndihmon! Pastaj, edhe nëse qëllimin e keq në ty e keni ditur vetëm ti dhe klika jote dhe kështu jeni frikësuar nga ndërgegja e juaj e ligur tej mase, ju për këtë s'kishit nevojë se njerëzit e "këqij", "rebelët", "rrugaqët" ishin "të siguruar" nëpër burgje e nëpër bodrume!

Ç'kishte që frikësoheshe aq shumë, "baba mbret"?! Pse të shqetësoj aq shumë UDB-ja?

Rrugën ta shtruan me dafine, me lule nëntori; rrugën ta ngjeshën me valle, me zërat e brishtë të fëmijëve të posadalë nga mëndelat (bërrr, sa ftohtë bënte atë nëntor!), dhe poetët kopukë ia thanë në gazeta e revista, në Radio e në Televizion, me himnizimet e tyre emfatiko-euforike-muziko-kopuke, duke madhëruar lavdinë tënde. Renegatët që i ke krijuar ti vetë, e jo njerëzit nga gjiri i popullit tonë, t'i shtruan rreth sofër dhe ata të raportuan me përunjësinë më të madhe (sado që nuk dinin të lexonin as si fëmijët e brishtë në rrugë) edhe për të "mbërrimet e mëdha", edhe për "lojalitetin e pashembulltë" të kosovarëve edhe për disa "irredentistë, nacionalistë, njerëz të krisur, bukëpërmbysës", të cilët po kërkojnë diçka më shumë, "pa ditur as vetë ç'është ajo që kërkojnë, dhe po e sakatojnë mirëqenien në bashkësinë socialiste" të jetës në një "paqe e harmoni të bekuar"!

As kështu s'ta dëshmuam dot "dashurinë tonë të madhe"?!

Përveç hijes sate, s'të ndiqte kush, Tito, ty as renegatët shqiptarë, që kanë hyrë në shërbim të përjetshëm tek ti, as policinë që kish mugulluar si bari i keq.

Apo, mos ishte kjo, hija e ndërgegjes, që nuk ju lente të qetë, megjithë të mirat që kishit përpara? Ç'ju dëftehet, vallë, në ëndërr, ty dhe klikës sate? Mos është fytyra jote, fytyra e dhunës, e kolonizimit të viseve shqiptare, fytyra e shfarosësit të shqiptarëve, që tani të del nga thellësitë e paqenësisë dhe të vjen përballë, duke të tmerruar edhe ty?

Ishe ti, Tito, me klikën tënde, që tradhtove idealet e shqiptarëve; ishe ti që ua shkele flamurin shqiptarëve, pasi ua ripushtove me tradhti një pjesë të tokave, se kështu të ndihmoi momenti i poshtër historik; ishte ti vetë që më 1947 ua rrëmbeve shqiptarëve të Kosovës edhe kokrrën e fundit të drithit dhe i le ata të ushqehen me barishte për më se një vit; ishte ti që patriotët shqiptarë, të cilët e kuptuan tradhtinë tënde, i hodhe në burgje, në kampet e tua të përqëndrimit, kurse me idenë e tyre të shenjtë luajte kapuç nëpër këmbë, duke i quajtur ata "informbyroistë", "tradhtarë të socializmit", "rrugaçë të thjeshtë"; ishe ti, e jo vetëm Rankoviçi - siç të pëlqen ty të mendoj bota - që poshtërove deri në shkallën më të ulët dinjitetin e shqiptarit, duke e zbruhur dru në të ashtuquajturin aksion të armëve, më 1956 dhe me një të goditur vrave dy lepuj: edhe dërmove shqiptarin edhe hoqe qafe rivalin e fronit tënd, Rankoviçin; ishe ti që qindra mijëra shqiptarëve ua dhe rrugën e mjerë të arratisë e të mërgimit në Turqi; ti, Tito studentët e Beogradit me demagogji, i përkdhele si "gjeneratë vigjilente" për ardhmërinë e vendit tënd, kur ata qenë ngritur në demonstrata, kurse ata të Prishtinës të cilët kërkonin të drejtat elementare njerëzore e kombëtare, i quajte "disa qindra rrugaçë, që egërsohen rrugëve, për modë, si në vendet e perëndimit"! Më në fund, ti me klikën tënde jeni ata që milni begatinë e pashtershme të Kosovës, kurse shqiptarit që jeton në vend të vet e nën robërinë tënde, ia ke vënë këmbën në fyt dhe i kërcënohesh se do t'ia zesh frymën.

"Dhe kush nga ne pati uri, ai në betejë ra.

Dhe kush na vdiq ndër duar, ai nga dorë e tyre u vra.

Ai që e morën me policë, urinë (lexo: robërinë) nuk e pat pranuar.

Ai që ia thyen nofullat, veç bukë pat kërkuar.

Atij që bukë i premtuan, tani i hidhen mu në grykë.

Ai që e rrasin brenda, të vërtetën e thosh pa frikë.

Dhe ai që u besoi se qenkan miq me ne,

ai paskësh pritur kot që shiu nga toka të derdhej në re."

Ç'pate lum "dashamiri", që u drodhe me kaq frikë në Kosovë kësaj radhe? Ç'hetove ashtu, në ajri, që mund ta rrezikojë shëndetin tënd, shëndetin e "vetadministrimit" tënd specifik, të cilin e ke mbërthyer aq fort me demagogji, me fuqinë e mungesës së argumentit; "unitetin" e mbretërisë sate të shtrenjtë dyzetvjeçare?

Që nga viti 1947 e këtej, siç të ka treguar para tri vjetësh (në "Rilindje") bashkëkombësi yt sllav, Milija Kovaçeviqi, për çdo dinarë të investuar në Kosovë, ke marrë prej Kosove dy dinarë e gjysmë. Prandaj, së paku njëherë për njëherë, s'ka frikë se kosovarët do të forcoheshin ekonomikisht deri në ndonjë shkallë që do ta rrezikonin ty vendin. Duke menduar se mund të paguash me kokë një hap të vetëm naiv, ti Krahinën e "shkarkove" nga përgjegjësia e saj si qendër ushtarake, dhe atë përgjegjësi ia "ngarkove" Nishit, ku rekrutohen tash shqiptarët; dhe s'të erdhi turp, as s'të ngau kush të arsyejoje këtë hap. Kurseve Kosovën nga brengat e tepërta! Prandaj, s'ke frikë se shqiptarët e robëruar mund të bëjnë ndonjë ditë edhe "komplot" ushtarak. Ti krerëve kosovarë, sikur t'u kishe dhënë të pinë hashash, ua mbushe gushën, dhe po i tërhek për hunde e po i sjell

për kërpesi si gjënë e gjallë në mazgjah, pasi ua ke topitur mirë ndjesitë me forcën e metodave të hartuara e të studiuara në Institutin për Shfarosjen e Shqiptarëve, në Beograd, dhe tash s'ke si të frikësohesh se të dalin dore vasalët. Ti e "kurseve" qiellin kosovar nga tymi i industrisë: për nënshtetasit e tu shqiptarë ti ke dashuri të posaçme - nuk do që ata të sëmuren nga tymi i fabrikave e as të lodhen duke punuar në ndonjë fabrikë; më mirë e kanë të shëtisin rrugëve të lirë, me duar në xhepa, të thithin në lirinë e pafundme ajrin përmbi kokë, e në daçin, kur të mos kenë bukë, le të "hanë" ajër! Edhe për historianin shqiptar do të kish qenë ngarkesë e madhe sikur ai të zbriste më thellë kah rrënjët e historisë së vet. Edhe këtu ke bërë lehtësime: historiani apo nxënësi, apo studenti, përgjithësisht shqiptari, le ta mësojë historinë e Nemanjiqëve, ose së paku atë të LNÇ të Jugosllavisë, mjafton. Lidhur me LNÇ-në le të zgjedhin tema disertacionesh dhe ty le të thurin ditirambe. Çdo ngritje e vetëdijes kombëtare, që lindet nga përtrirja e kujtesës kombëtare me të mësuar të historisë së vërtetë, do të shkaktonte kokëçarje - do t'i bënte shqiptarët të kërkonin të dalin më vete, të bashkohen me shqiptarët tjerë, që i kanë vëllezër gjaku. Çdo bëje ti pastaj pa shqiptarët "e tu të dashur", alias, pa pasurinë që ka atdheu i tyre dhe që ty po ta ndërton sot Serbinë, Malin e Zi etj.?

"Gjeneral, njeriu është shumë i dobishëm. Ai mund të fluturojë dhe të vrasë njerëz. Por e ka një të metë: Ai di edhe të mendojë." Dhe, kur merr të mendoj shqiptari, çkado që ti thuash ti, ai e di se po i thua kështu:

Ti je shqiptar, pasardhës i popullit më të vjetër në Ballkan, me një civilizim të lashtë. Kot ke luftuar kundër Romakut, bizantit dhe turkut, që deshën të ta japin emrin e vet dhe të ta shkëlin tokën. Historia jote aq e gjallë dhe qëndresa jote e paepur ndaj përpjekjeve të vazhdueshme të të huajit që ta zhdukë nga faqja e dheut emrin, gjuhën, kulturën dhe qenësinë tënde fizike kombëtare shqiptare duhet të ndalen, të hynë në një fazë ngurosjaje, e cila është e domosdoshme - jo pse është i tillë çasti yt historik e kombëtar, po pse kështu e do logjika ime pushtuese. Ti duhet të mburrësh që po ta jap emrin tim - jugosllav (sllav i jugut), hymnin tim gjithëslav "Ej slaveni"; duhet të jesh i kënaqur nëse mëson të marrësh frymë si sllav, si pjesëtarë i një race më të lartë, ta ndërrosh bioritmin tënd kombëtar, duke shkelur vetveten, historinë dhe atdheun tënd.

Këtë erdhe t'ia thuash edhe njëherë shqiptarit të Kosovës?

A s'e dite se s'ia duron midja?!

Gojë e këqija po flasin sikur të paska rënë diçka në vesh, atje, në selinë tënde të shtrenjtë, në Beograd. Të thanë kushedi se çka lugetërit hegjemonistë, të etshëm për të mbajtur ende nën thundër koloninë parajsore, Kosovën, dhe ti, në çastet e fundme të jetës prej matufi, në ankthin e halucinacioneve, që janë pasojë e poshtërsisë sate historike e cila tash të del para sysh me përmasa të shumëfishuara e me lëvizje të rrëmbyeshme, si lugati, si lubi, ke bërë dallash hesap: Shkova t'ua ndreq edhe njëherë samarin "shqiptarëve të mi" të pabindur! Për të arsyetuar para botës gjestin tënd, ti gjete pretekstin: "Kosova ka ngecur shumë prapa, ajo ka nevojë për zhvillim të shpejtuar, prandaj po shkoj... po u hedh atje poshtë, në koloni, pak hi syve, le të mendojnë se nuk kam tjetër punë pos halleve të shqiptarëve."

Ç'thonë pastaj gojëkëqinjte?

Aha, po! Po flitet se ke ardhur t'ua shtrëngosh edhe njëherë frerin vasalëve të tu, Fadilit (Hoxhës), Xhavitit (Nimani) me kompani, pse disa shqiptarë po marrin guxim të mendojnë ndryshe e jo si jugosllavë. Ç'të bëjnë edhe ata të shkretët, Fadili e Xhaviti! Ata e kanë punën edhe më ngushtë: ti kërkon prej tyre të të binden vetë dhe t'i detyrojnë edhe të tjerët të të binden ty. Kurse shqiptarëve s'po u bëhet vonë t'u shtrohen as Firmës Fadil

& Co e as ty që të kanë “xhan”, por ja që s’po mbërrijnë, nga telashet e veta. S’po duan që s’po duan shqiptarët të mendojnë si ju; kanë marrë një avaz të ri, po duan të dalin më vete, të bashkohen me vendin e tyre amë, me Nënë Shqipëri, siç e quajnë me afsh atdheun e tyre, e kjo bën ta flakin robërinë jugosllave.

Kjo gjë të habit. Pos të tjerash, pos që me ekonomi në tokat shqiptare ke lejuar lojën “Laje, lyeje, kape maco, shkërryeje!”, ti ke marrë masa edhe për përçarjen e tyre: le të vriten sa më shumë vëllau me vëlla! Këtë fjalë e këtë ide i ka përfillur besnikërisht gjithë aparati yt i fëlliqur shtetëror. Dhe shqiptarët kanë zënë qemoti dhe po vazhdojnë edhe sot të vriten, të gjakosen si armiqtë më të mëdhenj ndërmjet veti.

Ky fenomen, me të cilin krenohesh pse ka mbirë brenda kufijve të shtetit tënd, ngërtheu me vete dy momente të rëndësishme. I pari: “Më mirë ia lan shteti tatimin kriminelit që e lind vetë, sesa populli që i lan tatimin shtetit.” Duke u nisur nga shkalla e kriminalitetit të madh në Jugosllavi del se sistemi yt revizionist është nga më të tmerrshmet xheheneme të kësaj bote. Dhe e dyta: kur të ketë marrë vëllau të vritet me vëlla në kolonitë e botës, - po thotë një njeri i mençur, - vëllau e vret të vëllanë duke dashur ta vrasë në të gjithë poshtërimin e përbashkët të të kolonizuarit. Dhe siç ka dashur historia, siç po dëshmon kudo epoka e dekolonizimit në botë, nuk shkon gjatë dhe në vend të vëllait i kolonizuari do ta kthejë pushkën kah armiku i vërtetë, kolonizatori.

Ky proces është ngjizur moti te shqiptarët, a s’te duket edhe ty? Fol drejt, a të ka shkuar ndonjëherë mendja se vjen edhe dita që shqiptari, I detyruar me dhunë për ta pritur “si miku” gjakësorin e vet më të madh, të dalë në shesh sikur pranë varreve të “shkjeve”, pa dashuri, pa ndjenjë egërsimi, pa gaz në buzë, po edhe pa pezmatim. A s’te duket se kjo është një ftohje e rrezikshme gjaku? Mendoje se dashuria pushon në themele të gënjeshtërs, të dhunës?! Apo s’çaje kokë si do të vente puna me shqiptarët. Metodrat e tua të shfarosjes, të ka shkuar mendja, do të arrinin shpejt e shpejt efektin që s’e arritën dot me shekuj metodrat romake, bizante, turke: asimilimin apo shfarosjen e shqiptarëve. (Kush kanë qenë romaku, bizanti, turku në krahasim me fuqinë tënde!).

Ti klithje që nga Beogradi: “Barazi për të gjithë kombet dhe kombësitë!”, se kjo të lypsej për demagogjinë tënde. Kurse në mbrëmje kokën e fusje, sa ishe më i ri e më i fortë, nën cepin e jastëkut me hingirizje, duke u gëzuar që ja, me rrena po kalon edhe një ditë në lumturi!

Dhe pati që të besuan dhe asish që mbetën duke bërë sehir, pa u përzier kurrë. Për të parët do të vijë dita t’ua këndojmë këngën:

“Turpin e madh si e durove
Dhe me ç’ilaç zemrën e mpive,
Kur me kasapët u pajtove
Dhe për ata në llum u shtrive...
Mjerë ata që duart i kanë ndyrë
Me krime që as gurët nuk t’i falin”

Të dytët e dinë se “prej atyre që rrinë e bëjnë sehir presim që, të paktën t’u vijë turp”

A e do edhe një nga lajtmotivet e tua më të preferuara, i cili po zvarritet që më se tridhjetë vjet përmbi Kosovën, si zallahi që të shpon veshët? “...në vitet e ardhshme, duhet të kemi parasysh që Krahinën tuaj (kuptohet Kosovën) ta ndërtojmë deri në maksimumin e mundësive tona...”! A e di kur i ke thënë këto fjalë? Me 18 mars 1951! Ku? Në “Rilindje”. Po e vërteta, ku qëndron ajo? Gjashtë vjet më vonë, më 1957, të ardhurat për krye të një banori në Kosovë arritën në 49 për qind të mesatares në Jugosllavi. Ani mirë. Nga ky vit e tutje, puna ka ecur më tej. Por –së prapthi. Si gaforrja: me 1977,

të ardhurat për krye të një banori në Kosovë ranë në shkallën 33 për qind të mesatares jugosllave! Sa do që nuk duam të të shqetësojmë (pasi edhe atëherë kur ti je në shtrat dhe asnjë fuqi fizike nuk ke, don të jesh mbret!), dhe ta bëjmë me dije se s'ke pasur as do të kesh lojalitet të shqiptarët që bukës i thonë bukë, duhet të ta themi se kopallat e tua s'do t'ia hedhësh më askujt. Se, në shtëpinë tënde vetëm gënjeshtër çirret fort...përreth të lavdërojnë shtypësit, kurse të shtypurit të fajësojnë. "Në mos më besofsh mua, pyete B. Brehtin. Ose cilin do njeri që ka një lugë tru në kokë.

Ja ç' thotë me një rast një dijetar, ta zëmë, duke folur për të kolonizuarit në botë (e ç' vlen për këta, vlen edhe për shqiptarët, të pushtuar nga Jugosllavia, apo jo?). Luftëtari i lirisë ka parë tek ia heqin zvarrë, tek ia vrasin të jatin në mënyrë brutale..., dhe ka mbajtur mend. Dalëngadalë është rritur, është martuar dhe është bërë babë. Historia është përsëritur: atë e kanë marrë nga shtrati I gruas, e kanë rrahur ndër sy të saj e të fëmijëve, dhe pastaj e kanë rrasur në burg. Familja ka mbetur e tmerruar, pa bukë. Ai vetë ka „shkalluar“. Kur të dalë në liri, historia mund të përsëritet prapë edhe më, edhe më... Prandaj as që i shkon mendja se urtia, dashuria, lumturia e kësaj bote mund të kërkohet këndeje guximit, këndeje vdekjes, këndeje robërisë: dhe ai i bije shkelm "gjithë të mirave" të kësaj bote këndeje dhe takimin me çdo gjë të mirë e cakton përtej kufirit të guximit, matanë vdekjes. Rugë tjetër nuk ka. Në qoftë se merr guxim dhe s'ia ndan luftës kundër armikut të tërbuar, një ditë do të vritet, do të bëhet njeri i vdekur. Në qoftë se dorëzohet, shtrëngohet të përulet deri në baltë, dhe nuk do të jetë më njeri fare.

Ti i di këto. Nuk je armik për t'u përbuzur. Demagogjia jote me dekada po pi ujë edhe në Jugosllavi edhe gjetkë. Se mos nuk e ditka bota që gjithë „filozofia“ jote s'është tjetër veçse një demagogji, mbi të cilën pushon një rend i kalbur shoqëror? Merita jote: dite ta shfrytëzosh situatën që ha kopalla si të tuat! Prandaj s'je i pa mençur. Duke qenë i tillë, ti e di domosdo një gjë. Kur njeriu pajtohet me një fat, pra me luftën dhe me vdekjen, s'ka më vend për shqetësim, për nervozizëm.

Këtë dinë shqiptarët në Kosovë dhe në tokat tjera të tyre të pushtuara nga Jugosllavia. Sikur të mos e dinin ata do dëshpëroheshin dhe do të humbnin toruan për shkak të burgosjeve masive politike, që bëre ti në Kosovë dhe përgjithësisht ndër shqiptarët brenda shtetit jugosllav. Përkundrazi, për revolucionarët shqiptarë, këto burgime të papara janë shenjë e qartë se nervoza e gjan gremine dhe që po afron dita e luftës së hapur dhëmb për dhëmb e shqiptarëve të kolonizuar kundër armikut të tyre shekullor- Jugosllavisë.

Mjerë ti dhe klika jote kur të shpërthejë ithati ynë, i cili nuk e do të shtrydhet pak nga pak, se e ka kohën të shërohet përfundimisht.

“Duke marrë parasysh se çfarëdo që të na thotë,
ne qeverisë (sate) kurrë s'do t'i besojmë,
kemi vendosur që, nën drejtimin tonë e me besim të plotë,
një jetë më të mirë për vete të ndërtojmë.
Duke marrë parasysh se ju me siguri
përveç gjuhës së topave tjetër nuk kuptoni,
kemi vendosur që grykat e tyre tani
nga ju t'i drejtojmë që t'i shijoni!”

(Bertolt Brehti)

Në pastë qenë kjo frika jote gjatë vizitës së fundit ndër shqiptarë, atëherë je njëmend njeri i arsyeshem: frikësohu edhe më shumë! Janar, 1980

Marrë nga numri i parë i "Bashkimit" të drejtuar nga Jusuf Gërvalla

(www.pashtriku.org, 18 korrik 2010)

5. LUFTA JONË ËSHTË E DREJTË

Në 30 vjetorin e gjykimit të anëtarëve të LNÇKVSHJ dhe të daljes në skenë të udhëheqësit të saj Jusuf Gërvalla

Sulmi i UDB'së dhe kundërsulmi i Jusuf Gërvallës në shtypin e kohës

Dihet mirëfilli, se në nëntor - dhjetor të vitit 1979 në Kosovë dhe në viset tjera Shqiptare në ish'Jugosllavi, regjimi titist përmes UDB'së famëkeqe ndërmori një fushatë të egër kundër Lëvizjes sonë Kombëtare, me ç'rast burgosi dhjetëra veprimtarë të kësaj Lëvizjeje. Në këto zhvillime të rënda për popullin shqiptar, ishte zbuluar edhe aktiviteti i Jusuf Gërvallës. Më 14 dhjetor 1979, Jusuf Gërvalla, për t'i shpëtuar burgosjes nga UDB'a jugosllave, (pas konsultimit me shokët e Lëvizjes) - largohet nga Kosova dhe emigron në Gjermani. Jusufi largimin e tij nga Kosova për në Gjermani e përshkruan detalisht në ditarin e tij.

Jusuf Gërvalla, me të arritur në Gjermani, në janar 1980 nis aktivitetin e tij, për ta njohur opinionin e huaj lidhur me situatën e rëndë që po kalon populli shqiptar në Kosovë dhe në viset tjera etnike në ish'Jugosllavi. Jusufi me ndihmën e Bardhit (vëllaut të tij), fillimisht i shkruajti një letër organizatës "Amnesty Intenacional" ku e njoftoi për burgosjet masive të shqiptarëve në Kosovë dhe pastaj me porosinë e revistës gjermane "Der Spiegel" përgatiti një material prej 13 faqesh, në të cilin shpërfaqti historinë e popullit shqiptar dhe hodhi në dritë burgosjet e fundvitit 1979 që kishin ndodhur në Kosovë.

Ato ditë janari, Jusuf Gërvalla (pasi ishte njohur edhe me disa veprimtarë që vepronin në Gjermani), shkruan disa artikuj që do të botohen në muajin shkurt në gazetën "Bashkimi", dhe në numrin vijues në prill 1980. Ai do të shkruaj edhe për gazetën "LIRIA" që e nxirrte Kadri Zeka në Zvicër. Siç vihet në pah, Jusuf Gërvalla ia fillon punës duke i ndihmuar të tjerët në aktivitete të shumta që i kishin nisur prej kohësh, i bindur se ajo punë ishte me interes kombëtar. Në këtë kohë, UDB'ja kishte shtuar aktivitetin e saj në Evropë dhe i survejonte veprimtarët shqiptar në ato përmasa siç i ndiqte veprimtarët në Kosovë dhe në viset tjera etnike shqiptare.

Në pranverë të këtij viti, në kohën kur lufta shantazhuese kundër Jusufit në Shtutgart intensifikohet përmes provokatorëve të UDB'së, të cilët kurdisnin edhe atentate e kërcënime të ndryshme, duke shpresuar se Jusufi do të izolohej, më 4 qershor 1980, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (në bazë të aktakuzës PP.nr.180/79 datë 9 maj 1980) në "emër të popullit" i dënoi tetë anëtarë të Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve tjera shqiptare në Jugosllavi (LNÇKVSHJ). Pikërisht në këtë ditë, (më 4 qershor 1980) Jusuf Gërvalla kishte nisur përgatitjet për botimin e "Lajmëtarit të lirisë", një revistë Kombëtare që solli, shpresë, guxim e vetëbesim tek shqiptarët në mërgim dhe në gjithë etnikumin kombëtar në ish'Jugosllavi.

Qysh në numrin e parë të "Lajmëtarit të lirisë" (gusht 1980), Jusuf Gërvalla u vu në mbrojtje të bashkëveprimtarëve të tij të burgosur nga UDB'ja famëkeqe, duke sipërfaqësuar njëkohësisht, gjithanshëm edhe kauzën tonë kombëtare.

Me këtë rast për pashtriku.org po shkëpusim këtë fragment:

"Duke u nisur nga lufta jonë e drejtë, sepse ndryshe s'ka si cilësohet lufta për mbrojtjen e tokave të tua dhe të interesave jetike të popullit tënd; si dhe nga pjesëmarrja aktive e përhershme e shqiptarëve të Kosovës në vlimet e përgjithshme të historisë së Shqipërisë për ruajtjen e tokave dhe të popullit nga copëtimet e ndryshme barbare; pastaj, me vetëdije të lartë se qeveria titiste e Beogradit, mashë e imperializmit dhe e revizionizmit botëror meriton tek e fundit edhe urrejtjen e popujve jugosllavë, që lëngojnë si mos më keq nën këmbën e shovinizmit serb, është e natyrshme që ne, revolucionarët kosovarë të ndahemi diametralisht me mendime nga kjo qeveri dhe nga ky shtet. Ç'ka quan Jugosllavia mik, për ne do të jetë (dhe ka qenë) armik. Dhe anasjelltas, kur ajo quan armiq djalërinë më përparimtare shqiptare, që s'i ka lënë vend harresës kombëtare dhe që s'e ka hequr mendjeje rrezikun nga zhdukja prej dorës jugosllave as dashurinë dhe respektin ndaj detyrave dhe nderit historik e kombëtar, atëherë ne atë djalëri do ta quajmë djalëri e vërtetë shqiptare. Në të tillë kontekst e shohim edhe aktivitetin revolucionar të të pesëdhjetë organizatave tona patriotike e revolucionare, që UDB-ja jugosllave i ka terrorizuar dhe i ka masakruar që nga Lufta II Botërore e deri më sot. Në të tillë kontekst do ta shohim patjetër edhe aktivitetin e patriotëve shqiptarë, që para disa muajsh i mbushën ding të gjitha burgjet dhe bodrumet e policisë jugosllave në Kosovë.

Nëse gjyqi, shtypi, radioja dhe televizioni jugosllav e shohin të arsyeshme t'i dënojnë "Për veprën penale të propagandës dhe të bashkimit me qëllim të veprimtarisë armiqësore kundër popullit dhe shtetit" patriotët dhe revolucionarët Shefqet Jashari, Ramadan Pllana, Avdi Kelmendi, Abdyl Lahu, Isa Demaj, Sylejman Quqalla, Skënder Jashari, Hysen Gërvalla, Ibrahim Shala, Asllan Loshi, Ruzhdi Saramati dhe gjithë kusurin që tepron nga dy mijë e më shumë të burgosur politikë shqiptarë brenda disa muajsh (që mund të supozojmë pse nuk shpallen botërisht emrat e tyre), ç'na mbetet neve tjetër pos t'i nderojmë këta revolucionarë dhe të mburremi siç mburret çdo popull me bijtë e vet më të mirë."

Me rastin e 30 vjetorit të procesit të parë gjyqësor kundër anëtarëve të Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve tjera shqiptare në Jugosllavi, të mbajtur më 4 qershor 1980, www.pashtriku.org, boton për herë të parë Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të shpallur "në emër të popullit" kundër tetë veprimtarëve të kësaj Lëvizjeje Kombëtare.

AKTGJYKIMI I GJYKATËS SË QARKUT NË PRISHTINË

P - nr. 137/80, datë 4 qershor 1980

NË E M Ë R T Ë P O P U L L I T

Gjykata e Qarkut në Prishtinë, në Kolegjin e përbërë nga gjyqtari Isak Nishevcii kryetar, gjyqtari Metush Sadiku dhe gjyqtarët porotë Azem Emini, Maksimoviq Dojqin dhe Qazim Goxhufi, anëtarë, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Bedrije Kasumi punëtore e kësaj gjykate, në çështjen penale të akuzuarëve:

Shefqet Jashari nga fshati Strofc, të cilin e mbronë sipas detyrës zyrtare Jusuf Hakaj av. nga Prishtina, për veprën penale bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136 al. 1, lidhur me nenin 114 të LPJ,

Ramadan Pllana nga fshati Shtitaricë, të cilin e mbronë Zeqir Arni av. nga Prishtina, sipas detyrës zyrtare, për veprën penale bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136 al. 1 lidhur me nenin 114 të LPJ,

Avdi Kelmendi nga Lipjani, të cilin e mbron Hasan Kryeziu av. nga Prishtina, për veprën penale propagandë armiqësore nga neni 133 al. 1 të LPJ,

Avdyl Lahu, nga fshati Gllamnik të cilin e mbronë sipas detyrës zyrtare Zeqir Arni av. nga Prishtina, për veprën penale propagandë armiqësore nga neni 133 al. 1 të LPJ,

Skender Jashari, të cilin e mbronë Latif Krasniqi av. nga Prishtina për veprën penale propagandë armiqësore nga neni 133 al. 1 të LPJ,

Isa Demaj nga fshati Shkrel, të cilin e mbronë dr. Millutin Gjuriq av. nga Peja, për veprën penale propagandë armiqësore nga neni 133 al. 1 të LPJ,

Sylejman Qyqalla nga fshati Bellaqefci i Madh, të cilin e mbronë sipas detyrës zyrtare Hasan Kryeziu av. nga Prishtina, për veprën penale propagandë armiqësore nga neni 133 al. 1 të LPJ dhe

Hysen Gërvalla nga fshati Dubovik, të cilin e mbronë Gavrillo Vuleviq av. nga Peja, për veprën penale propagandë armiqësore nga neni 133 al. 1 të LPJ,

të akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë publike të qarkut në Prishtinë PP. nr. 180/79 dt. 9 maj 1980, në praninë e të akuzuarve, mbrojtësve të tyre dhe përfaqësuesit të akuzës publike, zëvendës prokurorit publik të qarkut, Ruzhdi Kozmaqi, më 4 qershor 1980 mori dhe publikisht shpalli këtë

A K T G J Y K I M

Të akuzuarët:

Shefqet Jashari, i lindur më 15 maj 1944 në fshatin Strofc, KK Vushtëri, ku edhe jeton, ka kryer shkollën e lartë pedagogjike.

Ramadan Pllana, i lindur më 6 korrik 1947 në fshatin Shtitaricë, KK Vushtëri, ku edhe jeton, ka kryer vitin e tretë të Fakultetit filozofik - dega e gjuhës Frengje.

Avdi Kelmendi, i lindur më 21 dhjetor 1951 në fshatin Ribari i Vogël KK Lipjan, tani jeton në Lipjan, drejtor i repartit të Fabrikës "Mineks" në Ferizaj,

Avdyl Lahu, ka kryer fakultetin filozofik grupi i gjuhës dhe letërsisë shqipe.

Skender Jashari, i lindur më 11 korrik 1954 në Prishtinë ku edhe jeton, punëtor në ndërmarrjen "Ramiz Sadiku" në Prishtinë.

Isa Demaj, i lindur më 12 janar 1946 në fshatin Shkrel KK Pejë, tani jeton në fshatin Pavlan, ka kryer Fakultetin filozofik - grupi i gjuhës dhe letërsisë shqipe.

Sylejman Qyqalla, i lindur më 29 qershor 1954 në fshatin Bellaqefci i Madh KK Prishtinë ku edhe jeton, punëtor në Fabrikën e amortizatorëve në Prishtinë, ka kryer shkollën e nxënësve në ekonomi.

Hysen Gërvalla, i lindur më 11 dhjetor 1941 në fshatin Dubovik KK Deçan ku edhe jeton, ka kryer katër klasë të shkollës fillore.

JANË FAJTORË

Dhe atë:

I akuzuari Shefqet Jashari

Sepse për të kryer vepra penale kundër bazës së rregullimit shoqëror socialist vetëqeverisës, të sigurisë së RSFJ, e veçanërisht të cenimit kundër revolucionar të rregullimit shtetëror, të drejtuar në rrëzimin e pushtetit të klasës punëtore e njerëzve punues, shkatërrimin e bashkim-vllaznimit e të barazisë së kombeve e kombësive si dhe të ndërrimit antikushtetutar të rregullimit shtetëror federativ, gjatë vitit 1977 në Prishtinë, si një ndër organizatorët, në kontaktet e takimet e shpeshta me Sabri Novosellën dhe të akuzuarin Avdyl Lahu, me qëllim të masovizimit të grupit ilegal armiqësor të Kosovës dhe viset tjera të RSFJ ku jetojnë shqiptarët, merren vesh për formimin e organizatës "Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës" të cilën edhe e formojnë në vitin 1978 dhe vendosin që të njejtën ta udhëheqë "Komiteti Qendror" e që njëri prej anëtarëve të tij të bëhet i akuzuari Shefqet Jashari, njëherit e aktualizojnë çështjen e përfitimit të anëtarëve

të rinj, dhe të shkruarjes së afisheve e parullave me përmbajtje armiqësore, në tremujorshin e parë të vitit 1979 në Prishtinë, pas shumë kontakteve dhe bisedave të mëparshme gjatë viteve 1977 dhe 1978 që i pati me të akuzuarin Ramadan Pllanën e udhëzoi që grupin armiqësor ilegal “Shkëndija e Kuqe” të cilin e kishte formuar gjatë vitit 1978, ta pagëzoi me emrin e ri “Organizata e Lëvizjes së Rinisë nacionalçlirimtare Kosovare”. Me këtë rast i akuzuari Shefqet Jashari e njohton të akuzuarin Ramadan Pllanën se është pranuar për anëtarë të “Komitetit Qendror”, e pastaj përveç udhëzimeve për veprime konspirative dhe formimin e grupeve të “Treshit”, ia jep letrën përshëndetëse, “Betimin”, “Vendimin” mbi formimin e grupit ilegal armiqësor me emërtim të ri dhe “Vendimin” se anëtarët ripajtohen t’i bashkangjiten “Lëvizjes”, të cilin grup edhe e formoi i akuzuari Ramadan Pllana më 12 mars 1979 në Prishtinë, gjatë muajit prill 1979 të akuzuarit Ramadan Pllana i jep Statutin e Lëvizjes prej pesëmbëdhjetë pikave, “Parathënien” dhe “Udhëzimin e qëndrimit të anëtarëve të Lëvizjes”, materialet: “Një komb shqiptar, një shtet shqiptar” në 9 faqe, “Rritja dhe kalitja ideopolitike e anëtarëve detyrë primare dhe permanente” dhe “Fjala e një renegati shqiptar” e me qëllim që tua shpërndaj anëtarëve të “Lëvizjes”, në fillim të muajit korrik 1979 në Prishtinë, afër stacionit të autobusave, i akuzuari Shefqet Jashari, pas një takimi i jep detyrë të akuzuarit Ramadan Pllana që në emër të “Lëvizjes NÇK” nëpërmes të anëtarëve të grupit të tij të ndërmerrë akcionin e shkruarjes së parullës “NIN-i rren Ylli nuk rren”, të cilat parulla edhe janë shkruar më 10 korrik 1979, në gjysmën e dytë të muajit korrik të vitit 1979, në emër të “Komitetit Qendror” të akuzuarin Ramadan Pllana e udhëzon që të shkojë në Francë për të kontaktuar me udhëheqësit e fraksionit “Marksist-Leninist” të Partisë Komuniste Franceze, në mënyrë që ata të njoftohen për ekzistimin e “Lëvizjes” dhe qëllimet e saja, gjë që ky udhëton dhe qëndron në Francë prej 20 korrik gjer më 5 gusht 1979. Në fillim të muajit tetor 1979 në Prishtinë, në takimin me të akuzuarin Ramadan Pllanën, këtij i jep detyrë të caktuar që në emër të “Lëvizjes” të shkojë në Stamboll dhe të kontaktoj me udhëheqësit e organizatës ilegale armiqësore që vepron në Turqi, me qëllim të bashkëpunimit, për çka i akuzuari Ramadan Pllana shkojë në Stamboll dhe qëndroj prej 5 deri më 8 tetor 1979 dhe kontaktoj me udhëheqësit e organizatës ilegale armiqësore e pastaj kur kthehet i raporton të akuzuarit Shefqet Jashari për të gjitha këto. Në fillim të muajit tetor 1979 i drejtohet Abdullah Hotit, e njohton për ekzistimin e organizatës “Lëvizja NÇK” dhe qëllimet e saja e pastaj nga ai kërkon që të bëhet anëtarë, por ky këtë ofertë e refuzon. Më 15 nëntor 1979 gjatë bastisjes së shtëpisë së tij, janë gjetur poezitë “Mëngjesi i së nesërme”, “Kosovës” dhe materialet tjera me përmbajtje armiqësore, me çka ka kryer veprën penale bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136 al. 1 lidhur me nenin 114 të LPJ.

I akuzuari Ramadan Pllana

Gjatë vitit 1978 në Konviktin e studentëve në Prishtinë, organizoi dhe formoi grupin ilegal armiqësor “Shkëndija e Kuqe”, me përbërje prej pesë anëtarësh, të akuzuarit Ramadan Pllana si kryesor dhe anëtarëve Abdullah Hoxha, Musa Neziri, Demë Jashari e Latif Pllana, e pastaj të njejtëve u jep për lexim dhe përpunim literaturë e material propagandues duke i përfutur në këtë mënyrë që të punojnë armiqësisht ndaj sistemit të RSFJ, në fillim të vitit 1979 pas shumë kontakteve e bisedave të mëparshme gjatë viteve 1977 e 1978 që i pati me të akuzuarin Shefqet Jashari, nga ky është njohtuar se u pranua për anëtarë të “Komitetit Qendror” dhe ka marrë instruksione që grupin armiqësor “Shkëndija e Kuqe” ta pagëzoi me emrin e ri “Organizata e Rinisë së Lëvizjes Nacionalçlirimtare Kosovare” me ç’rast ai përveç udhëzimeve për punë konspirative dhe formimit të grupeve të “Treshit”, mori “Letrën përshëndetëse”, “Betimin”, “Vendimin” e pajtimin për bashkangjitje “Lëvizjes”, “Vendimin” mbi formimin e grupit në emër të ri,

pastaj më 12 mars 1979 në “Tokë bashqe” në Prishtinë me anëtarët e grupit të vet e mban mbledhjen ku e japin betimin dhe marrin përsipër detyrën e formimit të grupeve të reja të “Treshit”. Gjatë muajit prill 1979 nga i akuzuari Shefqet Jashari mori materiale propaganduese e udhëzime tjera për veprimtari armiqësore, e në të njëjtën kohë i jep atij në shiqim punimin e vet “Rini shqiptare-Rini revolucionare”. Në fillim të muajit korrik 1979 pas marrjes së udhëzimeve dhe detyrës nga i akuzuari Shefqet Jashari se duhet të shkruhet parulla “NIN-i rren Ylli nuk rren” i organizaon anëtarët e grupit të vet Abdullah Hoxhën, Musa Nezirin e Hilmi Llugën, të cilët këtë parullë e shkruajnë natën e 10 korrikut 1979 në disa vende në Prishtinë. Prej datës 20 korrik deri më 5 gusht 1979 pas instruksioneve që i merr nga i akuzuari Shefqet Jashari në emër të “Komitetit Qendror” udhëton në Francë, me ç’rast udhëheqësit e frakcionit “Marksist-Leninist” të Partisë Komuniste Franceze i njohton për ekzistimin e “Lëvizjes NÇK”, qëllimet e saja dhe njëherit nga ata kërkon ndihmë. Prej datës 5 deri më 8 tetor 1979 pas udhëzimeve që i merr nga i akuzuari Shefqet Jashari, udhëton në Stamboll me qëllim të kontaktimit me udhëheqësit e organizatës ilegale armiqësore që vepron në Turqi, e pas kthimit të njëjtin e njohton për bisedimet që ka patur atje. Gjatë vitit 1979 në Lipjan njohtohet me të akuzuarin Avdi Kelmendi dhe në bisedat e kontaktet e mëtutjeshme këtë e njohton për ekzistimin e “Lëvizjes NÇK” dhe i propozon që të formoj grupet e “Treshit”, ndërsa i akuzuari Avdi Kelmendi i pranon detyrat dhe në këtë kohë e fillon veprimtarinë armiqësore intensive duke e formuar “Komitetin Qarkor” në Lipjan prej pesë anëtarësh. Gjatë viteve 1978 dhe 1979 shumëherë kontakton me të akuzuarin Sylejman Qyqalla, shkëmben me te literaturë me përmbajtje armiqësore, me biseda të shpeshta shprehen negativisht ndaj sistemit të RSFJ dhe të njëjtin e udhëzon për veprimtari armiqësore. Gjatë bastisjes së banesës së tij më 12 dhjetor 1979 dhe më vonë janë gjetur: “Statuti i LNÇK”, vendimet nga mbledhjet e mbajtura, “Letra përshëndetëse”, “Udhëzimi në tetë vargje”, “Parathënia”, “Fjala e një renegati shqiptar”, “Rrita dhe kalitja ideopolitike e anëtarëve detyrë primare dhe permanente” dhe shumë materiale tjera me përmbajtje armiqësore, - me çka ka kryer veprën penale bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136 al. 1 lidhur me nenin 114 të LPJ.

I akuzuari Avdi Kelmendi

Sepse me shkrim dhe gojarisht nxiti ndërrimin antikushtetutar të rregullimit shoqëror socialist e vetëqeverisës dhe shkatërrimin e bashkim vëllazërimit dhe barabarsisë së kombeve dhe kombësive të RSFJ, kështu që gjatë viteve 1975 deri 1978 si profesor i Shkollës së mesme në Lipjan, i frymëzuar nga i akuzuari Isa Demaj lexoi dhe këmbej libra me përmbajtje armiqësore, ndër të tjera edhe “Mëngjeset e bardha”, “Ç’thurje dhe degjenerim”, “Shota dhe Azem Galica”, kurse gojarisht është shpreh negativisht për gjendjen politike, ekonomike dhe shoqërore në RSFJ dhe ka cekur moszhvillimin e barabartë socialoekonomik e politik të kombësisë shqiptare në KSA të Kosovës. Prej gjysmës së vitit 1978 deri më 20 tetor 1979 është takuar disa herë me Sabri Novosellën, përndryshe një ndër anëtarët e “Komitetit Qendror” të “Lëvizjes NÇK” dhe në bisedat që i ka patur në Prishtinë kanë diskutuar për paknaqësinë e shqiptarëve me sistemin ekzistues të RSFJ, se “Revolucionarët” po bien nëpër burgje dhe se ka ardhë koha që të kalohet në punë ilegale e revolucionare, se në Kosovë ekziston një “Lëvizje” e madhe dhe e fortë, etj. Gjatë vitit 1979 pas kontakteve të shumta e bisedave me karakter armiqësor me të akuzuarin Ramadan Pllana, nga ky është njohtuar se ekziston dhe vepron “Lëvizja NÇK” e “Komiteti Qendror”, ka marrë udhëzime për ta formuar “Komitetin Qarkor” në Lipjan dhe në këtë drejtim i angazhon disa persona siç janë Ismajl Gashi, Beqir Leci, Qemajl Aliu, Banush Bytyqi, Muhamet Ademi dhe Ali Zejnullahu. Pastaj të njëjtit i furnizon me materiale e literaturë propaganduese, i njohton për ekzistimin e “Lëvizjes” dhe qëllimin

e “Komitetit Qarkor” të porsaformuar në Lipjan. Gjithashtu nën udhëheqjen e të akuzuarit Avdi Kelmendi kanë qenë të përgatitur që për festat e nëntorit të vitit 1979 të shpërndajnë pamflete e shkruajnë parulla me përmbajtje armiqësore, mirëpo akcioni mbetet në tentativë pasi që në ndërkohë janë paraburgosur, -me çka ka kryer veprën penale propagandë armiqësore nga neni 133 al. 1 të LPJ.

I akuzuari Avdyl Lahu,

Sepse me shkrim dhe gojarisht nxiti ndërrimin antikushtetutar të rregullimit shoqëror socialist e vetëqeverisës dhe shkatërrimin e bashkim vëllazërimit dhe barazisë së kombeve dhe kombësive të RSFJ, e poashtu me qëllim të keq dhe rrejshëm i paraqiti rrethanat rrethanat politiko-shoqërore në RSFJ, kështuqë gjatë viteve 1977 e 1978, në Prishtinë në kontaktet e takime me të akuzuarin Shefqet Jashari dhe Sabri Novosella e me qëllim të forcimit e masovizimit të grupit ilegal armiqësor të Kosovës dhe viseve tjera të RSFJ ku jetojnë shqiptarët merren vesh për formimin e organizatës “Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës” e njëherit pajtohen që njëri prej anëtarëve të Komitetit Qendror të bëhet i akuzuari Shefqet Jashari, me ç’rast e aktualizojnë çështjen e përfitimit të anëtarëve të rinjë dhe shkruarjen e afisheve dhe parullave me përmbajtje armiqësore. Poashtu gjatë vitit 1978 në Prishtinë e në vendet tjera, me kontakte të shpeshta me të akuzuarin Skender Jashari e persona tjerë e ka kritikuar sistemin e ndarjes së të ardhurave personale në Jugosllavi, ka cekë se Kosova është në pozitë të vështirë dhe se fajin për këtë e ka RS e Serbisë, se kombësia shqiptare në Kosovë me paraqitjen e rastit të volitshëm duhet të ngritet në revolucion, duhet kërkuar e afruar persona me mendime identike në mënyrë që të njejtit të aktivizohen në grupe armiqësore, se shpejt sistemi në RSFJ do të përçahet e çdo republikë do të formohet si e pavarur dhe gjatë muajit maj 1979 të akuzuarit Skender Jashari në shtëpinë e tij ia ka dërguar materialin armiqësor të shkruar në makinë me titull “Informatë për situatën politike e ekonomike të krahinave shqiptare të bashkangjitura vullnetarisht në RSFJ” i cili tekst fillon me fjalinë se iu është dedikuar “Organizatave politiko-shoqërore shqiptare në Jugosllavi - si atyre legale ashtu edhe atyre në ilegalitet - popullit dhe klasës punëtore të Kosovës” dhe përfundon me fjalinë “Pa pavarësi territoriale, politike e ekonomike s’mund të ketë barazi nacionale, se pas këtyre elementeve mshehet eksploatimi kolonialist”, se gjatë bastisjes së shtëpisë së tij janë gjetur shumë traka megnetofonike të inçizuar me këngë nacionaliste e armiqësore, -me çka ka kryer veprën penale propagandë armiqësore nga neni 133 al. 1 të LPJ.

I akuzuari Skender Jashari

Sepse me shkrim dhe gojarisht nxiti ndërrimin antikushtetutar të rregullimit shoqëror socialist vetëqeverisës dhe shkatërrimin e bashkim-vëllazërimit dhe barazisë së kombeve e kombësive të RSFJ, e poashtu me qëllim të keq dhe rrejshëm i paraqiti rrethanat politiko-shoqërore në RSFJ, gjatë vitit 1978 në Prishtinë e vendet tjera në kontakte të vazhdueshme me të akuzuarin Avdyl Lahu ka cekur se KSA e Kosovës ka ngecur në zhvillimin ekonomik, se kombësia shqiptare duhet të organizohet për ngritje në revolucion ngase nuk kanë kurrfarë të drejtash dhe është e robëruar, se në Kosovë njerëzve të aftë e të arsimuar nuk iu mundësohet punësimi, se në rast nevojë pas ndonjë krize politike në Jugosllavi ai i ka të tubuar rreth vetes disa persona që do t’i kryejnë detyrat konkrete e që parashtrihen para tyre, poashtu se duhet gjetur ithtarë me qëllim që të bëhen anëtarë të grupit “Lëvizja NÇK” dhe të paguajnë anëtarësinë për blerjen e materialit propagandues.

Gjatë vitit 1978 dëshmitarëve Vesel Veseli, Rexhep Maqedonci, Gafurr Ajvazi etj., u ka folur për grupin e organizatës “LNÇK” dhe u ka propozuar që edhe ata të bëhen anëtarë të kësaj organizate armiqësore e të paguajnë anëtarësinë. Gjatë muajit maj 1979

nga i akuzuari Avdyl Lahu në shtëpinë e vetë e ka marrë materialin të shkruar në makinë me titull “Informatë për situatën politike e ekonomike të krahinave shqiptare të bashkangjitura vullnetarisht në RSFJ” i cili tekst fillon me fjalinë se iu është dedikuar “Organizatave politiko-shoqërore shqiptare në Jugosllavi – si atyre legale ashtu edhe atyre në ilegalitet - popullit dhe klasës punëtore të Kosovës” dhe përfundon me fjalinë “Pa pavarësi territoriale, politike e ekonomike s’mund të ketë barazi nacionale, se pas këtyre elementeve mshehet eksploatimi kolonist”. Së fundit gjatë bastisjes në shtëpinë e tij më 15 nëntor 1979 është gjetur “Informata” e përmendur, një afishe “Lexoje, shpërndaje, armikut mos ia dorëzo” dhe materiale tjera propaganduese e armiqësore, - me çka ka kryer veprën penale propagandë armiqësore nga neni 133 al. 1 të LPJ.

I akuzuari Isa Demaj

Sepse me shkrim dhe gojarisht nxiti ndërrimin antikushtetutar të rregullimit shoqëror-socialist e vetëqeverisës dhe shkatërrimin e bashkim – vëllazërimit e barazisë së kombeve e kombësive të RSFJ, e po ashtu me qëllim të keq dhe rrejshëm i paraqiti rrethanat politiko-shoqërore në RSFJ, kështu që gjatë viteve 1975 deri në 1979 në Lipjan dhe vendet tjera gjatë bisedave me të akuzuarin Avdi Kelmendi, e pastaj me Ismajl Gashin, Beqir Lecin, Ekrem Llugiqin dhe persona tjerë ka deklaruar se në Jugosllavi nuk ekziston socializmi i vërtetë po vetëm politika revizioniste, se shoku Tito është antikomunist dhe se politika e tij të cilën e udhëheqë shkon në favor të kapitalizmit, se Beogradi udhëheqë politikë shfrytëzuese ndaj Kosovës, se RSFJ i shfrytëzon pasuritë natyrore të KSA të Kosovës. Poashtu ka kritikuar sistemin socialist vetëqeverisës dhe ka deklaruar se duhet punuar me rininë shqiptare në mënyrë që e njehta të ngritet ideologjikisht për veprimtari armiqësore ndaj RSFJ, e pastaj në banesën e Ismajl Gashit në Lipjan ka deklaruar se situata politike e Kosovës nuk ka ndryshuar pas Plenumit të Katërt, kurse para nxënësve të QAMO në Lipjan, ku ka qenë i inkuadruar në veti të profesorit të gjuhës shqipe ka recituar vargje nga “Lahuta e Malësisë” dhe shumë herë është shprehur armiqësisht ndaj sistemit socialist në RSFJ, dhe gjatë bastisjes në shtëpinë e tij më 27 dhjetor 1979 janë gjetur shtatë ekzemplarë të revistës “Ylli”, vjersha “Kosovës” e materiale tjera me përmbajtje armiqësore, - me çka ka kryer veprën penale propagandë armiqësore nga neni 133 al. 1 të LPJ.

I akuzuari Sylejman Qyqalla

Sepse me shkrim dhe gojarisht nxiti ndërrimin antikushtetutar të rregullimit shoqëror-socialist e vetëqeverisës dhe shkatërrimin e bashkim – vëllazërimit e barazisë së kombeve e kombësive të RSFJ, e po ashtu me qëllim të keq dhe rrejshëm i paraqiti rrethanat politiko-shoqërore në RSFJ, kështu që nga viti 1978 e më tutje në fshatrat Bellaqevc e Shtitaricë dhe Prishtinë ka kontaktuar me të akuzuarin Ramadan Pllana, i është lavdëruar se në bibliotekën e tij ka libra me përmbajtje armiqësore dhe njëherit kanë bërë shkëmbimin e librave dhe materialeve propaganduese. Në bisedë me të ka theksuar se zhvillimi ekonomik social e kulturor në RSFJ nuk është i drejtë, se në mënyrë sistematike duhet të organizohet e të frymëzohet kombësia shqiptare për shkëputjen nga RSFJ. Pastaj gjatë shërbimit ushtarak prej muajit qershor 1978 deri më 6 shtator 1979 e ka përpiluar ditarin me përmbajtje armiqësore të drejtuar kundër sistemit politiko-shoqëror në Jugosllavi, me përmbajtje nacionaliste e irredentiste dhe plot fyerje e përbuzje të drejtuara kombeve e kombësive që jetojnë në RSFJ.

Pas kthyerjes nga shërbimi ushtarak në fillim të muajit shtator të vitit 1979 vazhdon bisedat dhe kontaktet me Ramadan Pllanën e pastaj rreth vetit tubojnë disa nxënës të QAMO “Milladin Popoviç” në Prishtinë, të cilët i organizoi për veprime

propagandistike, iu dha të lexojnë literaturë me përmbajtje armiqësore, para dëshmitarëve Nexhmedin Melenica e Rrahim Rama dhe të tjerëve ka kritikuar sistemin shoqëror vetëqeverisës të RSFJ, duke cekur se në Jugosllavi ekziston papunësia e madhe, se Kosova ka ngec mbrapa në zhvillimin ekonomik mu për shkak se ndodhet në kuadër të RSFJ, dhe gjatë bastisjes së shtëpisë së tij më 10 nëndor 1979 janë gjetur 260 ekzemplarë të gazetës “Zëri i Popullit”, revista “Dielli”, “Drita”, “Shqipëria e Re”, “Zëri i Rinisë”, shtatë kopje të “Ditarit” e shumë e shumë libra, revista, gazeta dhe materiale tjera me përmbajtje armiqësore, - me çka ka kryer veprën penale propagandë armiqësore nga neni 133 al. 1 të LPJ.

I akuzuari Hysen Gërvalla

Sepse me shkrim dhe gojarisht nxiti ndërrimin antikushtetutar të rregullimit shoqëror - socialist e vetëqeverisës dhe shkatërrimin e bashkim - vëllazërimit e barazisë së kombeve e kombësive të RSFJ, e po ashtu me qëllim të keq dhe rrejshëm i paraqiti rrethanat politiko-shoqërore në RSFJ, kështu që gjatë vitit 1979 në fshatin Dubovik, KK Deçan, nga Isuf Gërvalla, përndryshe vëllau i tij është njohtuar se ekziston dhe vepron organizata ilegale “Lëvizja NÇK” për çka edhe ka shprehur dëshirën që edhe ai të bëhet anëtarë, për çka edhe e ka marrë Statutin e organizatës “LNÇK” e libra e materiale propagandistike me përmbajtje siç janë: “Lidhja Kosovare”, “Kongresi i parë”, “Vetadministrimi Jugosllav – teori dhe praktikë kapitaliste”, “Lidhja Shqiptare e Prizrenit”.

Të njëjtat i ka lexuar e pastaj ua ka dhënë Muharrem Blakajt, Mal Morinës e Ahmet Haxhiajt për lexim dhe ngritjen e tyre ideologjike si dhe për punë armiqësore. Gjatë muajit korrik 1979, pasi që më parë ka marrë instruksione prej vëllaut të tij Isuf Gërvallës, Muharrem Blakajn e Mal Morinën i ka pregaditur e udhëzuar që në disa vende në Pejë e Istog të shkruajnë parullën “NIN-i rren Ylli nuk rren”, të cilat parulla këta nën ndikimin e tij edhe i shkruan më 10 korrik 1979, për çka në ditën e nesërme e informojnë se detyrën e dhënë e kanë kryer dhe gjatë bastisjes së shtëpisë së tij më 14 dhjetor 1979 janë gjetur shumë libra e materiale propagandistike, ndër të cilat edhe këto: “Rini shqiptare – rini revolucionare”, “Parathënia”, “Një komb shqiptar një shtet shqiptar”, “Bashkëpunëtorët e okupatorit nuk janë përfaqësues të popullit shqiptar”, “Statuti i LNÇK”, “Rrita dhe kalitja ideopolitike e anëtarëve detyrë primare dhe permanente”, “Udhëzime” dhe “Fjala e një renegati shqiptar”, - me çka ka kryer veprën penale propagandë armiqësore nga neni 133 al. 1 të LPJ.

Prandaj gjykata në bazë të neneve të lartcituara si dhe neneve 5, 33, 38, 41 dhe 50 të LPJ si dhe nenit 351 të LPP i

G J Y K O N

Të akuzuarin Shefqet Jasharin me dënim me burg në kohëzgjatje prej 8 (tetë) vjetësh.
Të akuzuarin Ramadan Pllanën me dënim me burg në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) vjetësh.
Të akuzuarin Avdi Kelmendin me dënim me burg në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vjetësh.
Të akuzuarin Avdyl Lahun me dënim me burg në kohëzgjatje prej 4 (katër) vjetësh.
Të akuzuarin Skender Jasharin me dënim me burg në kohëzgjatje prej 3 (tri) vjetësh.
Të akuzuarin Isa Demaj me dënim me burg në kohëzgjatje prej 4 (katër) vjetësh.
Të akuzuarin Sylejman Qyqallën me dënim me burg në kohëzgjatje prej 4 (katër) vjetësh.
Të akuzuarin Hysen Gërvallën me dënim me burg në kohëzgjatje prej 3 (tri) vjetësh.

Më 10 nëntor 1980 Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga kryetari i gjykatës Riza Fazlija dhe gjyqtarët: Aqif Tuhina, Nikë Lumezi, Ramo Vodopiq e Shefqet Bytyqi, anëtarë, me bashkëpunëtoreshen profesionale, Sadije Dedinca - procesmbajtëse, në praninë e zëvendësprokurorit publik krahinor Sahit Meraku, mbrojtësve Zeqë Arni, Hasan Kryeziu dhe dr. Millutin Gjuriqiqi, shqyrtoi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P - nr. 137/80 datë 4 qershor 1980, dhe me këtë rast me Aktgjykimin (Ap - nr. 248/80 dt.10 nëntor 1980) përveç uljes së dënimit të Ramadan Pllanës nga shtatë (7) në gjashtë (6) vjet dhe të Avdi Kelmendit nga pesë (5) në katër (4)vjet, të gjithë të tjerëve ua vërtetoi dënimin e dhënë nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë. (www.pashtriku.org, 2 qershor 2010)

6. FAQJA POETIKE NË REVISTAT E JUSUF GËRVALLËS

30 vjet nga dalja në skenë e Jusuf Gërvallës

Jusuf Gërvalla është një figurë monumentale e Kombit tonë. Përveçse atdhetar dhe drejtues i organizatës LNÇKVSHJ, Jusufi ishte edhe krijues i përsosur. Ai i takon brezit të tretë të krijuesve të poezisë së sotme shqipe. Në këtë brez Jusuf Gërvalla, sikur edhe pak krijues të artit poetik, do të hyjë jo thjesht si krijues i artit letrar, por edhe si individualitet me prirje të shumanshme kulturore e intelektuale. Prandaj, në rrethet kulturore në përgjithësi dhe në ato letrare në veçanti, Jusuf Gërvalla është krijues i pranuar në shumë fusha: publicist, interpretues, përkthyes, prozator e poet.

Në Kosovë Jusufi ka botuar tri përmbledhje me poezi: Fluturojnë e bien (1975), Kanjushë e verdhë (1978) dhe Shenjat e Shenjta (1979). Edhe pas arratisjes nga Kosova Jusufi vazhdon të shkruaj poezi, por në gazetën e tij apo në ato gazeta të redaktuara nga ai nuk e boton asnjë poezi të vetën. E vetmja poezi e Jusuf Gërvallës që është botuar në revistat e kohës është poezia "SHQIPJA BËN EDHE PA GJËMË, I MJAFTON LAVDIA" e botuar në revistën "Liria", nr. 4-5, gusht 1981, faqe 23. Revistën "Liria" Jusufi e ka ndihmuar me të gjitha mënyrat por, nuk ka qenë redaktor i saj. Kjo poezi është zgjedhur për botim nga bashkëveprimtari i tij Kadri Zeka.

Jusuf Gërvalla në rubrikën "Këndi poetik" të revistave të tij, ka botuar poezi të autorëve: Abdyl Latif Arnauti (Siri), Tahsin Saraçi (Turqi), Ulmar Qvicku (Suedi), Petraq Risto, Çajupit, Hydajet Hysenit, Ismail Sylës, Ismail Kadaresë etj. Në gazetën "Bashkimi" ka disa poetë tjerë që nuk përmenden këtu. Nga të gjithë poetët shqiptar, Jusuf Gërvalla, hapësirë më të madhe në revistën "Lajmëtari i lirisë" i ka dhënë poetit Ndoc Gjetja.

Poeti Ndoc Gjetja është ndarë nga jeta më 7 qershor 2010, në moshën 66-vjeçare. Vdekja e parakohshme e poetit erdhi për shkak të një sëmundjeje të rëndë. Ai u lind më 1944 në fshatin Bërdicë të Shkodrës, por në Lezhë u vendos me familjen që kur ishte 7 vjeç. Shtegtoi drejt Tiranës në kohën kur krijimtaria e tij u bë e njohur në vitin 1971. Kishte botuar vëllimin e parë poetik "Rrezatim", pastaj erdhën gjashtë të tjerë: "Shqiponja rreh krahët" (1975), "Qëndresa" (1977), "E përditshme" (1982), "Çaste" (1984), "Poezi" (1987), "Kthimet" (1991) dhe "Dhjata ime" (1998). Poeti Gjetja dikur do të thoshte: "Edhe pse kam botuar shtatë vëllime me poezi, unë e konsideroj veten autor i një libri të

vetëm, që do të hartohet duke përzgjedhur poezitë më të mira që kam arritur të krijoj." Studiuesit e kanë cilësuar Gjetjen si poet që di me çdo varg t'i bjerë bukur tastierës së humanizmit dhe prandaj jo pa qëllim e kanë quajtur "poet humanist". Kjo përmasë në poezinë e tij rri pa zhurmë dhe me dinjitet në rendin e poezisë bashkëkohore shqipe. Për më tepër Ndoc Gjetja konsiderohet si një nga poetët më origjinalë shqiptarë.

Në shenjë nderimi për Ndoc Gjetjen, faqja www.pashtriku.org i ka shkëputur katër poezi nga revista "Lajmëtari i lirisë", për t'iu bërë jehonë fjalëve të këtij poeti të madh, në të njëjtën përmasë, siç ka bërë Jusuf Gërvalla para 30 vitesh. (Pashtriku.org - 26 qershor 2010)

MË KISHIN ARDHUR NJERËZIT

Para ca vitesh isha sëmurë
i kisha humbur ndjenjat fare
dhe tek krevati m'u duk sikur
më erdhi ajo, armikja e të gjallëve.

Në dhomën me heshtje të rëndë
lëvizte me çapa të pandjerë
sikur më tha: - Ngreu në këmbë!
Po të fal dhe kësaj herë.

Ajo priste që t'i thosha
por s'i thash: - Falemnderit!
Unë u ngrita se te koka
më kishin ardhur njerëzit.

UNË SHTËPINË E KAM TË FALA "SHOK"

Më kanë ardhur kaq telegrame
"Lajmëro shëndetin"
nga shokë të largët pas tërmetit.
Me këta vargje desha t'u përgjigjem:
"Ju paça të gjithëve, falemnderit!"

Shtëpia u rrëzua, shumë gjëra u prishën
por nga kjo s'e pata vështirë
se unë prej kohësh e kisha hyrjen
te zemra juaj, njerëz të mirë.

Sa njerëz më erdhën tek çadra sot!
Prit e përcjell më kaloi gjithë dita,
unë shtëpinë e kam te fjala "Shok",
me themele në zemra e me çati prej drite.

Ja, rri e mendoj me vete sonte:
me shumë gjëra në jetë jam ngopur
por asnjë herë dashuria e shokëve
të më teprojë s'më ka ndodhur.

Se gjithçka në botë ka një madhësi,
mbushet me diçka dhe nuk nxë më tepër
por njeriu kur s'u mbushka me njeri
dhe universin mund ta nxërë në zemër.

Gjyshit tim

Gjithë jetën e kaloi me një martinë hedhur krahut duke luftuar mal më mal kundër
zaptuesve. Ka qenë 93 vjeç kur e rrëmbyen armiqtë natën në kullë dhe s'u kthye më. Nuk
dihet se ku e kanë vrrarë dhe as kufomën nuk ia gjetë njeri.

NGA NJË GOJËDHANË

Jeta e gjyshit - një gojëdhanë
një gojëdhanë me tridhjetë fjalë
se fjalët e tjera i kanë rënë
rrokje-rrokje nga një këngë,
se s'është lehtë njëqind vjet
të trokasësh nëpër zemra,
të hysh në to dhe të bëhesh
fjalë që digjet nëpër breza.

Vallë ku mbin gjithë ato fjalë
që i patë folë kur ishte gjallë
se fjalët e gjyshave janë si farat
që çajnë plisin në pranverë,
nëpër zemra lëshojnë rrënjë,
ato mbijnë e nuk lënë
jetën kur të mbetet djerrë.

Në ato fjalë si thelbi në farë
është përkdhelja edhe puthja,
është martina edhe lahuta,
është Shqipëria me gjithë hallet
dhe ajo e bardhja bjeshkë
kokrra e misërit, Besa e Dhënë
më të shenjtë se zoti vetë.

More gjysh, Ulisi i Bjeshkëve!
Askërkund s'ta gjeta varrin,
gjithkah brodha vërri e më vërri,
pyeta hënën e s'mu përgjegj,
pyeta përrenjtë e nuk u ndalën,
pyeta diellin e tha: Nuk di!

Më në fund thash me vete:
Bjeshka e Namun me shtatë male
ngrihet sot mbi eshtra të gjyshit
Bjeshka e Namun me shtatë maja
që tallin e sfidojnë

piramidat e Egjyptit.

Si t'i shtyj shtresat e tokës,
si t'i shtyj shtresat e kohës
si t'i ngrej malet e Bjeshkës
të ta gjej thelbin e zemrës
se ty mali të ka marrë
të të hedh një tufë me fjalë
të të hedh një degëz ahu,
të të hedhë një hingëllim kali,
të të hedhë ca hala pishe,
të të sjellë një djep fëmije
të shohësh jetën si lëvizë
nëpër rrembat e Shqipërisë...

Qëkur vdiqe more gjysh
njëqind vjetë kanë kaluar
e ti s'mundesh që ta dish
se sa shumë që ka ndryshuar
faqja e jetës dhe faqja e botës
po të ngjalleh tre dekada
tre dekada ta shikosh
nuk besoj se do ta njohësh.

Ngreu e shih fillin e lëmshit
që është lidhur nyje-nyje
në tavolinë të supershtetit,
në politikën e të gjithë krajlive,
janë bërë një rrahja e puthja,
janë bërë një paqja e lufta,
janë bërë një tregu e miqësia,
janë bërë një burgu e liria,
janë bërë një gjoksi e shpina...

Të dhëmb syri dhe zemra
kur sheh bankat "Nëna e bija"
mbushë me letra që vlerësohen
shumë më tepër se burrëria,
shumë më tepër se atdheu
shumë më tepër se fytyra,
kur sheh urat që montohen
me gjymtyrë e kafka kombesh
ku kalojnë tanket e jankit
edhe trenat e Moskovit.

Për ta gjetur të vërtetën
duhet sot t'i kthesh përmbys
shtatëmijë male ngritë me letra
ngritur shkronjën përmbi shkronjë
dhe çdo fjalë ta thyesh si arrën

mos ka brenda varrin tonë.

Larg nga detet dhe kontinentet
nga sarajet e krajlive
vijne ca zëra si përkdhelje,
vijne ca zëra si gjëmime
Ç'janë sirenat e Uliksit
more gjysh përpara tyre?

Si gra të lëshueme propagandat
nëpër udhë të botës ecin
në buzëqeshje fshehin prangat,
fshehin thikën brenda fjalës.
Disa thonë: - Çaj përmes!
Disa thonë: - Bjeri anës!

Na u dashka t'i thuash vetes
ndizu flakë e digje trupin,
me kurriz s'fiton asgjë,
rënë në gjunjë të ha poshtimi
të kafshon me dhëmbë prej qeni,
më mirë luftës jepja gjoksin
në llogore ta haj plumbi.

Krejt si njerëzit edhe kombet!
Nga kurrizi u vjen vdekja
rënë në gjunjë humbin veten
u zbret qyqja në thelb të zemrës
mbi shpinëkrrusjen vjen mandata,
më mirë flakë ta ndezin shtatin
dhe në dorë t'u shkrihet shpata.

Po shekullit tim e rrugës sime
në mos i shkofsha për midis
në mos vdeksha për këto vërrie
mos arritsha të bëhem gjysh!

Gjakun tim te udha e jetës
pika-pika e piftë dheu
gjithsaherë t'i thahet buza
gjithsaherë ta marrë etja
e iu bëftë shëndet e gëzim
u bëftë lule, gjeshe e bar
u bëftë rrita e Shqipërisë,
zë fëmije ndër pelena!

Këto poezi janë marrë nga "Lajmëtari i lirisë", nr.1, gusht 1980

TE GRYKA E HONIT KU PREHEN ESHTRAT E AZEMIT

Iu afrova grykës së honit,
ia ngula sytë heshtjes, territ
dhe s'di pse zemrës brenda gjoksit
iu dha t'i thërrasë Azemit.

- A po më ndien, o Azem Galica? -
thirra ndoshta njëqind herë.
Një shqiponjë doli nga gryka,
me tërsëllimë u ngrit në qiell.

I thash vetes: Mos thirrë më!
Se Azem Galica doli.

Marrë nga "Lajmëtari i lirisë", Nr. 1, janar - shkurt 1981 (26 qershor 2010)

7. PROCESI

PERSONAZHET

SAMI BREGU
NAIM BALA (Sabri Novosella)
TOMË NDREU
GJYQTARI
PROKURORI
VELI NEZA
E BURGOSURA
ROJA
HETUESI I
HESTUESI II
IMITATORI
NËNA PREJ PUBLIKU
ZËRI NGA TELEFONI

Policë, burra, gra (prindër), në gjykatore
Ngjarja ndodh në Prishtinë

PAMJA E PARË

NAIMI

(Në shirit të magnetofonit) "Kjo që rugën time, prej një njeriu të thjeshtë e të përvuajtur, po e lidhni me rugën e ndershme të patriotit tonë të madh, më bënë nder. Por, e vërteta është se kurrë nuk kam plakur asnjë orë me të.

HETUESI I

(Në shirit të magnetofonit) Natyrisht ju kanë mjaftuar nga disa minuta. E dimë si kanë shkuar takimet tuaja: "shpejt, shkurt, konciz!"

NAIMI

(Në shirit...) Unë them se nuk kam pasur kurrfarë takimesh me të, as me njeri tjetër nga ata që kërkonin ju!

HETUESI II

(Hyn bashkë me imitatorin)

S'bënë të mashtrohemi me këto imitime të shkrimit të tyre nga grafologu ynë. Ç'shkarravitje!

IMITATORI

Ata janë të regjur dhe do t'i bien në fije.

HETUESI I

Punë e madhe. Kush çan kokën për ata, nëse e pranon materialin prokurori!

HETUESI II

S'e pranon. Mund të na dalin telashe më vonë në gjyq. Ai rrobaqepësi ka një kokë që s'bëhet, kushedi se çdo të bëjë në gjykim. Mund të nxitet publiku.

IMITATORI

Më duket se publik nuk do të ketë. Por edhe një imitim si ky nuk na shpie gjëkund.

HETUESI I

Po atëherë, e ta dërgojmë te grafologu në Beograd!

HETUESI II

Jemi për ngut. Të provojmë njëherë me imitim e zërit nga magnetofoni. Është material më bindës për publikun dhe demoralizues për të burgosurit!

HETUESI I

Ta provojmë, ta provojmë...

HETUESI II

Unë shkova. Kanë sjellë të arrestuar të rinj.

IMITATORI

Pse s'thua punë të re, na doli shpirti ditë e natë!

HETUESI I

Ndashtë, kështu do të këpusim në rrënjë kopukët!

HETUESI II

Ka mundësi të gabojmë. Në krizën e sotme, mund t'u bëjmë edhe shërbim rebelëve.

HETUESI I

Si po mendon?

HETUESI II

Mund të ketë diçka të vërtetë në atë mendimin e tyre.

HETUESI I

Për çfarë mendimi e ke fjalën?

HETUESI II

"Një nga shenjat më të mira për suksesin e luftës sonë dhe për afrimin e fitores, janë burgjet e mbushura përplot revolucionarë e patriotë", thuhet kështu në ato shkresurat e tyre?

HETUESI I

Vetëm le të mendojnë kështu. Me rëndësi është që kërbaçi ynë kurrë s'ka ngrënë kaq mish rebelësh. Dhe kur ka qenë më i qetë se tash populli?

IMITATORI

Pas çdo qetësie ka rrezik për shtrëngatë.

HETUESI II

Mua kjo nuk më pëlqen fort. Kam frikë mos bluhet në heshtje ndonjë gjë ndaj këtyre kokëshkretëve?

HETUESI I

Më në fund, për këto le të çajnë kokën atje lart nga na kanë urdhëruar (kah imitatori). Atëherë pra na mbetet t'ia imitojmë zërin këtij... Urdhërin e kemi që të sigurojmë patjetër së paku një deklaratë të vyeshme prej tyre...

IMITATORI

Përpiqemi.

(del Hetuesi II)

NAIMI

(Në shirit) "Unë nuk them se nuk kam pasur kurrfarë takimesh me të dhe as që njoh njeri tjetër nga ata që kërkonin ju! Mund të më mbytni po deshët, por, ja ku jua them sheshit: edhe po të kisha ndenjur me të unë kurrë..."

HETUESI II

(Në shirit) Do të flasësh, bir i bushtrës!

HETUESI I

Ti po e di ç'rëndësi ka për ne një deklaratë. E ke për detyrë të bësh çmos. (del Hetuesi I)

IMITATORI

(Inçizohet në shirit) Një kohë jemi takuar në shtëpinë e Sami Bregut. Pastaj kur na u duk se shtëpia po përgjohej, takoheshim në natyrë...

(Perdja)

PAMJA E DYTË

(Në gjyq)

PROKURORI

... Në një kohë të konsolidimit të madh të forcave tona socialiste, ATA janë bashkuar për agjitacion e propagandë armiqësore kundër integritetit të vendit tonë, me qëllim që të përmbysin të mbërrimet e vetëqeverisjes socialiste dhe të popullit tonë punonjës... Prandaj në cilësinë e prokurorit publik të Qarkut të Prishtinës, nga ky gjyq i ndershëm kërkoj dënimin e merituar për të akuzuarit: Sami Bregu, i lindur në Ferizaj më 1939, profesor në Fakultetin Filozofik në Prishtinë, Naim Bala, rrobaqepës nga Prishtina, Tomë Ndreu, bujk nga fshati Bishtazhin, para arrestimit me punë të përkohshme në botën e jashtme.

GJYQTARI

Siç e kemi parë nga materialet e shqyrtuara në seancat e deritashme, ne kemi përpara një grup njerëzish që janë deklaruar në mënyrë të rrezikshme kundër sistemit dhe realitetit tonë të vetëqeverisjes socialiste dhe kundër integritetit territorial të Jugosllavisë. ATA, ndonëse u përkasin strukturave të ndryshme shoqërore, përfaqësojnë mendime të afërta, gati identike. Kjo do të thotë se të akuzuarit, pa përjashtim, janë zhytur thellë në rrugën e tyre armiqësore. Ne bëme përpjekje të mëdha që ATA të ndjekin rrugën si i ka hije rregulli i këtij gjyqi. Ashtu do të kish pasur mundësi të gjejmë edhe ndonjë rrethanë lehtësuese për ta. Por përpjekjet tona shkuan huq. Megjithatë, të vetëdijshëm se në mesin e tyre ka njerëz që kanë rënë viktimë e veprimtarisë së disa personave që janë përgjigjur edhe më herët për vepra armiqësore kundër popullit dhe shtetit, ne do t'ua japim të akuzuarve edhe një shans. Le të kujdesen, nga ky çast, për pozitën e tyre...

Si thoni ju i akuzuari, Sami Bregu, a është detyrë e intelektualit dhe e njeriut të ndershëm t'i shërbej atdheut apo të luftojë për shembjen e tij?

SAMIU

T'i shërbej atdheut, me përpjekje mbinjerëzore dhe pa u lodhur kurrë.

GJYQTARI

Më vjen mirë që po e dëgjoj nga goja juaj! Si bënë atëherë që ju, me gjithë këtë mendim të drejtë, ju vetë keni vepruar për shembjen e atdheut tonë, madje keni shtyrë edhe njerëz të tjerë në rrugën tuaj të gabuar e të rrezikshme?

Samiu

Këta shokë këtu, unë as nuk i njoh, në qoftë se kanë punuar si unë, nuk është faji im. Kurrë nuk mund të jemi të sigurt kush do të bëhej me ne dhe kush do të na përbuzë. Varet nga morali dhe drejtësia e njeriut e sidomos nga kushtet e përgjithshme jetësore...

GJYQTARI

Nuk di sa e lehtëson kjo pozitën tuaj edhe sikur të besonim se nuk keni kontaktuar me ta, autoriteti juaj prej intelektualit të njohur dhe puna juaj rrënuese kundër atdheut i ka shtyrë ata, drejtpërdrejt apo tërthorazi, të vihen në shërbim të armikut të brendshëm e të jashtëm.

SAMIU

Nuk di kë quani ju atdhe? Sa për Atdheun tim, në qoftë se këta vëllezër kanë punuar ashtu siç i ngarkon aktakuza, atëherë e çmoj lartë punën e tyre dhe besoj se atdheu do t'i shpërblej herdokur!

PROKURORI

Ne një atdhe kemi - Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë. Dhe kush çohet kundër saj ka bërë tradhti të rëndë.

NAIMI

Atdheun tuaj mbajeni për vete... Dihet cili është Atdheu i vasalit!

GJYQTARI

Qetësi!

SAMIU

Çuditë, që kur ju kështu prokuror?!

PROKURORI

Si - që kur!

SAMIU

Ka disa shokë të cilëve nganjëherë, u pëlqen t'i kujtojnë ditët e maturës në gjimnaz. Ata s'ia qëllojnë dot, ç'doli kështu që ju shtyri të merrni përsipër një detyrë si kjo dhe t'i shkelni të gjitha bindjet dhe pikëpamjet tuaja të përparshme!

NAIMI

Ç'na shtyri? Një sorrë me shumë emra: oportunist, renegat, tradhtar!...

PROKURORI

Mbylle gojën! A lejohet kështu, shoku gjyqtar, të fyhet kaq rëndë njeriu në cilësinë time dhe i tërë gjyqi?!

SAMIU

More, fshehu ti në daç prapa zanatit tënd, në daç prapa këtij gjyqi të okupatorit, tradhtia mbetet tradhti dhe ajo paguhet shtrenjtë.

GJYQTARI

I akuzuari Naim Bala ju i keni mohuar kontaktet tuaja me irredentistin e rrezikshëm Adem Dema-Demaçi para se ai të binte në burg për herë të tretë, më 1975?

NAIMI

Po.

GJYQTARI

Ne ju kuptojmë, por kemi në dorë një material që e dëshmon në mënyrë të pakundërshtueshme të kundërtën e asaj që thoni ju.

NAIMI

Të shohim çfarë çorbe na keni zier tash.

GJYQTARI

Në interesin tuaj është që të thoni të vërtetën, e cila mund t'ju ndihmoj.

NAIMI

Të vërtetën, gjithmonë vetëm të vërtetën!

IMITATORI

(Në shirit) "Pos meje, me Adem Demën-Demaçin janë takuar edhe Sami Bregu, Besnik Mema, Arben Gega..."

HETUESI II

(Në shirit) Ku i mbanit takimet?

IMITATORI

(Në shirit) "Një kohë jemi takuar në shtëpinë e Sami Bregut. Pastaj kur na u duk se shtëpia po përgjohej, takoheshim në natyrë..."

NAIMI

Ç' mjeshtri! Po pranoj se metodat i keni të përsosura. Po kjo nuk dëshmon gjë tjetër pos një mjerim të aparatit tuaj të fëlliqur!

PROKURORI

Kjo e bënë edhe më të rëndë situatën tuaj. Në vend që t'i përmbaheni rregullit dhe të thoni haptas para këtyre njerëzve atë që keni thënë pas shpinës së tyre, ju, ktheheni dhe sulmoni gjyqin e Jugosllavisë vetëqeverisëse!

SAMIU

... I cili është gjyq i dhunës e i gënjeshtërs me bisht dhe të cilit ne nuk jemi të marrë t'i bindemi si ju shkon mendja juve!

GJYQTARI

Qetësohuni, shoku prokuror! I akuzuari Sami Bregu të keni kujdes si shpreheni. Më në fund, ky është gjyqi i vetëm, para të cilit ju duhet të përgjigjeni dhe si revolucionarë që thoni vetes duhet ta dini se "disiplina është një virtyt që shpreh në cilësi të lartë njerëzore dhe revolucionare". Kështu thuhej në materialet tuaja, që supozojmë t'i keni lexuar edhe ju?

NAIMI

Për shkelje të nderit dhe të disiplinës mund t'ju akuzoj unë juve. Punë më të pandershme s'keni mundur të bëni se sa duke imituar zërin tim në magnetofonin tuaj të fëlliqur. Por unë nuk zemërohem as ligem. Kjo tregon qartë sa nevojë të ngutshme keni ju për një deklaratë, të cilën, më në fund ua kërkon edhe Beogradi. E paskeni imituar mirë zërin tim. Ju lumtë! E dyta, ky nuk është gjyq i vetëm, ky është gjyqi juaj. Po nderin tim, disiplinën dhe përgjegjësinë time i kam për gjyqin e vërtetë, atë të popullit. Ja atje, në

dritaret tuaja, me shami në dorë, populli qanë hallin e bijve të vet, sot, nesër, pa shami, do të kujdeset si t'jua bëjë varrin juve!

GJYQTARI

I akuzuar, jua marr fjalën? Gjyqi nuk lejohet të bëhet tribunë pikëpamjesh anarkiste, informbyroiste, irredentiste me të cilat ju kanë helmuar "prijësit" tuaj... Le të vijë dëshmitari Veli Neza! (E sjellin dëshmitarin)

PROKURORI

I akuzuari Naim Bala a e njihni këtë njeri?

NAIMI

Po e njoh.

PROKURORI

(Dëshmitarit) Na e thuani ju lutem çka dini për kontaktet e Naim Balës me irredentistin Adem Dema-Demaçi dhe me të akuzuarin Sami Bregu?

VELI NEZA

Ademi ka qenë disa herë në dyqanin e Naimit.

PROKURORI

Si e dini?

VELI NEZA

Me Naim Balën jemi fqinjë të parë në dyqanet.

PROKURORI

Pos në dyqan, a i keni parë të takohen edhe gjetiu?

VELI NEZA

Kam dëgjuar se Naimit i kanë shkuar edhe në shtëpia ata.

GJYQTARI

Nuk na intereson këtu çka keni dëgjuar, por ç'keni parë dhe ç'dini me siguri?

VELI NEZA

E pra, jo.

GJYQTARI

Çka jo?

VELI NEZA

Tjetërkund s'i kam parë.

PROKURORI

Kurse në dyqan po?

VELI NEZA

Si urdhëroni!

NAIMI

Kur? ... Atëherë ...

GJYQTARI

I akuzuar mos flisni pa leje!

NAIMI

Më falni por unë jam avokat edhe i vetvetes. Desha të pyes fqinjnin tim kur më ka parë?
Më mirë, kur ka pas nevojë për t'ia dredhur unë dorën?

PROKURORI

Ç'po dërdëllisni kështu?

NAIMI

Pyetni atë!

GJYQTARI

S'ka nevojë.

NAIMI

Jo pra, se përndryshe do t'ju tregonte ç'e ka shtyrë të flasë për mua çka është e s'është. Do t'ju tregonte se ç'kishte ndërmend të bënte, me dhunë, në terrin, mes dy dyqaneve tona, me atë vajzën e re, së cilës ia kishte mbyllur gojën sa të mos mund të kërkonte ndihmë.

PROKURORI

Ah, profkat tuaja!

NAIMI

Po, pra. Ky është një delikuent i rëndit të posaçëm. Dhe, të tillët ju i ruani si sytë e ballit. Sepse, i keni harç për t'i bërë mashë që të gjurmoni me ndihmën e tyre njerëzit e ndershëm. Kjo është praktika e gjyqeve tuaja të fëlliqura, që i jep dorë shumimit të delikuencës, të cilin do ta rreshtoni në radhët e spiunëve...

GJYQTARI

Shqyrtimin e vazhdojmë në seancën e pasditës.

(Perdja)

PAMJA E TRETË

(Korridori i banesës së gjyqtarit)

GJYQTARI

Nuk jua di aspak për nder për punën që me keni ngarkuar. Ju dija për mi, e ju po ma merrni shpirtin.

ZËRI NGA TELEFONI

Ç'është ky shqetësim?!

GJYQTARI

Është dashur një prokurori, sidomos hetuesit të mbledhin material më të mirë, Ka rrezik të pësojmë keq...

ZËRI NGA TELEFONI

Si do që të bëhet gjykimi një përfundim duhet të ketë. Ju këtë e dini. Në ju dalshin vështirësi të reja, nxjerreni fare jashtë publikun, t'i lini vetëm familjet e të akuzuarve! Mos lejoni asesi t'ju marrin nëpër këmbë. Jeni gjyq, pastaj i keni edhe organet tuaja.

GJYQTARI

Si urdhëroni, por jua them si mikut, do të kemi vështirësi...

ZËRI NGA TELEFONI

Veproni në përputhje me urdhrat që keni marrë nga lart.

GJYQTARI

Si urdhëroni!

(Perdja)

PAMJA E KATËRT

(Qeli burgu)

ROJA

Erdhi koha të shkojmë, bijë.

E BURGOSURA

Vetë e sata do të jem?

ROJA

Vetë e pesta.

E BURGOSURA

Kaq pak? Po të tjerat, kur do t'i nxjerrin në gjyq?

ROJA

Pak nga pak. Nuk kanë guxim t'ju gjykojnë me shumicë. Gjithë punën e mbajnë në fshehtësi të madhe...

E BURGOSURA

A di gjë sa janë krejt?

ROJA

Kështu si ti? Këtu nja shtatëdhjetë. Në Mitrovicë ka gjithashtu vajza. Thonë se atje e kanë burgosur një klasë të tërë bashkë me profesorin e tyre.

E BURGOSURA

Po djem, a ka shumë?

ROJA

Shumë, bijë, shumë! Por mos më pyetë më gjatë.

E BURGOSURA

Bukur! Shumë, thua?

ROJA

Shumë... Sa nëna kanë mbetur me duar në gji?

E BURGOSURA

Ti mos u mërzit baba i ndershëm. Kjo është fjalia më e mirë që ke mundur të ma thuash. Burgjet plot - liria në derë! Kështu më kanë thënë shokët dhe kështu duhet të jetë.

ROJA

Ja edhe një fjalë, një letër!

E BURGOSURA

Gëzohu, baba i ndershëm! (Lexon nga pusulla):

- Mbahu motër! Jemi më të fortë se asnjëherë. Armiku ynë i egër po bie në provim. Rroftë populli shqiptar i lirë e i bashkuar!"

ROJA

Të shkojmë tash, bijë. Të prift... Ju priftë e mbara!

E BURGOSURA

Oh, baba i ndershëm, ky është gjerdeku im më madhështor!

(Perdja)

PAMJA E PESTË

(Në gjyq)

PROKURORI

Si në traktet e afishet që kanë shpërndarë, ashtu edhe në materialet e tjera të shkruara e në deklaratat e tyre verbale, qëndron një armiqësi e madhe ndaj gjithë asaj që ka krijuar ky popull, duke e përqafuar me vullnetin e vet të mirë rrugën e socializmit vetëqeverisës dhe të realitetit tonë. Lidhur me të akuzuarit dhe me të gjithë ata që kanë sulmuar sistemin tonë, populli e tha fjalën e vet dhe për të gjithë kërkoj dënime të rënda. Sikur të udhëhiqeshim nga kërkesat këmbëngulëse të masës, të akuzuarit që i kemi përpara do t'i dënonim sipas procedurës së shkurtër. Por, kjo përjashtohet vetvetiu. Ne kemi gjyqet tona dhe s'kemi nevojë të dalim jashtë suazave të kushtetutës e të gjyqit. Mirëpo nga të akuzuarit kemi pengesa të dukshme, në shqyrtimin e çështjes kontestuese. Ata, me ndërhyrjet dhe përgjigjet e tyre të pakontrolluara na detyrojnë që këtij procesi t'i biem më shkurt, do të thotë, duke bërë thjeshtësimin e elementeve të vetëkuptueshme...

SAMIU

Po të kishim mbrojtje ajo do të thoshte se ju po hyni në kompetencat e gjyqit. Dihet se prokurori është juridikisht vetëm një palë sikur edhe ne. Dhe nuk çuditem aspak pse nuk ju ndërhyjnë gjyqtari. Nga përvoja e disave, ky gjykim, si të gjithë gjykimet politike të

shqiptarëve deri më sot, është fare formal. Sepse, teshat na janë prerë në Beograd, në të ashtuquajturën udhëheqje kolektive.

GJYQTARI

I akuzuari Sami Bregu, jua marr fjalën. Mos ndërhyini pa leje. Mbrojtjen do t'ua siguronte vetë gjyqi, por e keni refuzuar.

SAMIU

Natyrisht, s'më duhet mbrojtje për një vepër që s'e kam bërë, sidomos një mbrojtje që do të më siguron ju, për të më gremisur edhe më lehtë. Nëse më jepni leje të vazhdoj, do të pyesja prokurorin: A e kishte ndërmend fare, kur foli për kërkesat e popullit, atë babanë që paska kërkuar t'ia dënojnë sa më rëndë të birin sipas gazetës "Politika" të Beogradit.

PROKURORI

Atë edhe shumë të tjerë.

SAMIU

Si ata artikujt e "Rilindjes", ku thuhet se vetë populli e dënoi me vdekje Selim Talin pse vrau një "pjesëtar të kombësisë tjetër"? Si ata artikuj! Ku populli e dënon veprimtarinë e Adem Demës-Demaçit? Këto profka nuk janë as për lojë fëmijësh. Pyetni gjyqin e popullit atje poshtë, të shohin ç'po thuhet?...

NJË NËNË NGA PUBLIKU

E dimë këtë mirë, ç'po thotë populli!

GJYQTARI

Qytetarë, qetësi, se do të zbrazim sallën!

NËNA NGA PUBLIKU

Pse pak të zbrazur e keni? Doni t'ua hani kokën pa dëshmitarë bijve tanë më të mirë që mezi i ngritëm me mundin, djersën dhe gjakun tonë...

SAMIU

Në atë gazetë thuhej qartë se gjykimi do të bëhej në kushte të jashtëzakonshme, sepse ka rrezik që të dalin e të na vrasin baballarët tanë!...

NËNA NGA PUBLIKU

Këta m'i vraftë ... reja! Ç'na e nxinë jetën bigari hak!... (Me vrazhdësi një polic don ta nxjerrë jashtë salle).

Shporru pjellë e keqe! Vij vetë, dhe nuk ndahem në këtë moshë nga bijtë e mi. (Ju drejtohet gjyqtarit dhe prokurorit). Çfarë nëne paska qenë ajo që ju rriti për t'ia ngrënë kokën vëllait për hatër të hasmit!

SAMIU

Kështu na gjykon ne populli.

GJYQTARI

Qetësi!

NAIMI

Mjerë ju bastardë, kur t'i ndërrojmë rolet. Kur t'iu nxjerrim ne para gjyqit të vërtetë të popullit!

GJYQTARI

Ne këtu i kemi edhe organet.

PROKURORI

I akuzuari Tomë Ndreu! Ju në tubimin e punëtorëve tanë me punë të përkohshme në botën e jashtme më 24 maj 1978 në Munihi keni deklaruar haptazi sa vijon: "Deri kur do të vazhdojnë mbi ne shantazhet e organeve të Sigurimit? Lëre që na keni shitur si krah pune te kapitalistët dhe i mbushni arkat me deviza që i sjellim ne këtij vendi duke çuar jetë qeni në dhe të huaj, larg familjes e vendlindjes, por edhe kur shkojmë në shtëpi për t'u çlodhur sadopak dhe për të hequr për disa ditë ndryshkun e jetës kurbetçare, na thirrni në polici: Jo a e ke parë filanin, jo ç'bënë fisteku, jo fol më mirë se nuk ta japim pasaportën..." A është e vërtetë?

TOMA

E vërtetë?

PROKURORI

Pastaj: "Ku e merrni të drejtën të na futni në evidencat e të zënëve në punë. Ne jemi të zënë në punë te gjermani, jo në shtëpi! Në shtëpinë tonë merret me punë i huaji. Keni bërë prej nesh një ushtri dyqindmijëshe nizamësh të përjetshëm, këndeje na quani punëtorë të përkohshëm, vetëm e vetëm që t'i zbrazni trojet tona dhe të shkretëni nëpër to si t'ua dojë qejfi, më zi se çetnikët e Drazhës e të krajlit...!" A po e pohoni këtë!

TOMA

Në tërësi. Kush paska qenë ai pehlivan që ka shënuar aq shpejt e aq saktë?!

NAIMI

Mikrofoni në jakën e konsullit jugosllav!

GJYQTARI

I akuzuar, mos folni pa leje!

PROKURORI

I akuzuari Tomë Ndreu, a e dini se deklarata juaj e mësipërme është sulm i drejtpërdrejtë mbi realitetin tonë socialist dhe mbi punën e organeve tona të sigurimit?

TOMA

E di.

PROKURORI

A qëndroni prapë në pozita të njejta?

TOMA

Jo.

PROKURORI

A do të thotë kjo se keni për të shtuar, apo eventualisht për të ndërruar gjë në deklaratën tuaj të deritashme.

TOMA

Si urdhëroni!

PROKURORI

Urdhëroni për cilën deklaratë e keni fjalën?

TOMA

Për të gjitha gati...

PROKURORI

Ku ishit më herët? Gjyqtari bëri disa herë apel, i vetëdijshtëm se jo të gjithë të akuzuarit kanë hyrë me vetëdije të plotë në këtë lojë të rrezikshme e naive.

TOMA

Ende më mbante inati nga dajaku që hëngra gjatë hetimeve...

GJYQTARI

I akuzuar lidhur me ndëshkimet fizike ju keni folur edhe më parë dhe ne kemi pasur për detyrë ta vërtetojmë deklaratën tuaj. Komisioni i mjekëve ngul këmbë se juve, posaçërisht as që ju kanë prekur me dorë.

NAIMI

Rroftë kërbaci - hekur e rrip!

GJYQTARI

I akuzuar, mos flisni pa leje!

TOMA

Komisioni është komision. S'do mend që e di punën më mirë se unë...

PROKURORI

Urdhëroni pra! Flisni!

TOMA

Unë atëherë mendoja se duhet ta zbrazë sidokudo atë pak vrer, që të lidhet në gjoks nga jeta e vështirë larg familjes e atdheut. Njeriu ndien nevojë ta shkarkojë kohë pas kohe barrën e rëndë të jetës. Unë si njeri i thjeshtë, më heret një bujk i paditur dhe pastaj një argat i vetmuar në dhe të huaj, nuk dija as se si dhe ku mund të shkarkohej ajo barrë.

Mallkoja dhe s'dija kë po mallkoj, fatin tim? Por, këtë fat e ndanin me mua edhe shumë të tjerë si unë, prandaj i lash mallkimet. Qyqja që kur u kurdis dynjaja, atë punë bënë - vajton rremb më rremb, po bota e shurdhër s'ia veshin. Pastaj rruga e madhe e jetës më përpoqi me hallexhinj të tjerë. Vajtonin edhe ata, por, si naiv që isha, më dukej se vaji i tyre nuk ishte i pashpresë si imi. Njerëzit marrin nga njëri-tjetri dhe unë domosdo merrja diçka prej tyre, dhe një ditë pash se nuk po mallkoja fatin tim, por villja kundër dikujt që më dukej se na e kishte zënë diellin. Ky ishte mashtrimi im dhe për këtë pendohem thellë dhe e lus këtë gjyq të ketë parasysh pendesën time.

GJYQTARI

(I drejtohet daktilografistit triumfalisht) Shënojeni!... Natyrisht që gjyqi do të ketë parasysh këtë gjest fisnik.

PROKURORI

A kam leje shoku gjyqtar? (Merr nga gjyqtari shenjën e aprovimit) A keni gjësend për të shtuar i akuzuari Tomë Ndreu?

TOMA

Po. Ju lutem ta futni në procesverbal... Unë isha një kokëshkretë. Mendoja se loja ku po më "futni" ende nuk ishte aq e "rrezikshme". Tani po e shoh se kam qenë një egërsi, i lig, që kërkon shesh për të ruajtur shëndetin e vet me britma e të vjellja kundër një armiku... (Ndalet. I shikon të akuzuarit me radhë me një domethënie të thellë dhe me njëfarë akuze të fshehtë. Gjyqtari nxiton për t'i dhënë zemër që të vazhdoj)

GJYQTARI

Vazhdoni, vazhdoni ...

TOMA

Dhe lufta kundër këtij armiku, mendoja unë i shkreti, bëhet duke zhburrëruar veten me fjalë. Dhe flisja. Kam folur ç'mos. Aq sa thuhet e s'tuhet në letrat që i ka ky "gjyq i nderuar", tani po e shoh që shokët e mi paskan ditur ta ruajnë veten (unë nuk i zbulova nga inati që më lindi kundër dajakut... Më falni gjatë hetimeve) prej kësaj kokës sime të mjerë. Prandaj, pendohem thellësisht... Këtë çast e tutje, unë nuk do të sillem në mënyrë egoiste për t'i zbrazur në mes të rrugës, vajtimet qyqare, të cilave s'ua vë veshin bota... Kurrë më nuk do të shikoj se si t'ia lehtësoj vetes barrën.

Ja edhe këtë do t'ia di për nder sa të më rrah zemra në krahor që më solli në vete.

PROKURORI

I përmendët shokët që "paskan ditur ta ruajnë veten", mos keni ndërmend të ndërroni qëndrimin, e të kallëzoni konkretisht?

GJYQTARI

Nuk është nevoja këtu, shoku prokuror. Ka kohë...

TOMA

Jo, shoku gjyqtar, pasi nisa dua ta mbaroj. Në më lejofte "gjyqi i nderuar" dua t'i kallëzoj të gjithë shokët, por janë shumë dhe druaj s'do të mund t'i përmend të gjithë me emra. Shokët e mi janë të gjithë ata që luftën për liri nuk e kuptojnë si mundësi për ta zbrazur helmin dhe pezmin e vet në ajër, me aq fuqi sa ka një pickim mize në shpatullën e buallit, dhe dashurinë e atdheut e kanë të atillë që të bën ta harrosh vetveten...

PROKURORI

Me gjithë vullnetin e mirë, ju kuptojmë si duhet dhe do ta kemi ndërmend gjestin tuaj të mirë, por këto fjalë nuk kanë si të hynë në procesverbal dhe nuk na ndihmojnë për të dalë konkretisht te çështja kontestuese. Na e thuaj së paku një emër.

GJYQTARI

Ju thash se nuk është nevoja, shoku prokuror. Mos insistoni!

TOMA

Janë shumë. Emrat ua di një pakice. Por të gjithë mund të përmbliidhen me një emër të vetëm. Shoku im është gjithë ai shqiptar-punëtor, fshatar, zejtar, intelektual popullor, i cili është ngritur deri në atë shkallë të ndershme revolucionare sa çështjen e çlirimit kombëtar e klasor nga nacional-shovinizmi jugosllav, çështjen e bashkimit të shenjtë me Nënë Shqipëri, nuk e merr si punë, që mund të bëhet apo që mund të pres për më vonë, por si luftë që duhet të marrë zjarr me dhembje, me ngut, me alarm...

(Perdja)

Në vjeshtën e vitit 1980, veprimtarët Remzi Ademaj, Hysen Gega dhe Faridin Tafallari, me rastin e 28 Nëntorit - Ditës së Flamurit, i kërkojnë Jusuf Gërvallës ta shkruaj një dramë, e cila do të shfaqet në mbrëmjen festive. Jusufi e shkruan dramën "Procesi", por, për shkaqe të ndryshme, drama nuk u përgatit për t'u shfaqur atë vit. Ishin aktivistët e Brukselit në krye me Enver Hadrin, të cilët për herë të parë këtë dramë e përgatitën dhe e vunë në skenë. (Moderatori i pashtriku.org, 1 tetor 2010)

8. "BASHKIMI" BËN FUQINË

"Fronti Nacional Çlirimtar ishte Fronti unik i të gjithë popullit kundër armikut të jashtëm, që na kishte pushtuar vendin. Vija e Partisë në Front ishte për bashkim pa dallim klase, bindjeje politike, feje dhe krahine e të gjithë shqiptarëve të vërtetë, e të gjitha forcave patriotike e demokratike të vendit, e të gjithë atyre që ishin gati të luftonin kundër pushtuesve fashistë e tradhtarëve për një Shqipëri të lirë, të pavarur, demokratike e të popullit." Enver Hoxha

Liria nuk fitohet me vota. Dhe kurrë nuk ka ndodhur që pushtuesi të bëhet aq zemërgjerë sa t'ia kthejë një populli lirinë të cilën ia ka rrëmbyer njëherë. Vetëm lufta e vendosur dhe pa kursim e popullit të robëruar e heq qafe zgjedhën e huaj dhe botën e detyron t'ia njohë atij lirinë.

Në luftë kundër pushtuesit jugosllav dhe tradhtarëve shqiptarë, vasalë të qeverisë së Beogradit, ne nuk duhet të ushqejmë iluzione dhe t'i lejojmë vetes asi komoditeti që të ngelim jashtë rrymës së drejtpërdrejtë të stuhisë, qoftë në kuptimin e frazës reaksionare: "Ha përslesh, se ka kush i kqyr punët e fisit", qoftë në kuptimin e shmangies tonë për një kohë më të gjatë a më të shkurtër nga lufta, duke ndjekur vijën e rezistencës së ulët.

Dhe lufta jonë përballë një armiku të rrezikshëm, i cili gëzon edhe përkrahjen e forcave të shumta me afinitet të ngjashëm, do të jetë gjithsesi një luftë e vështirë. Faktori teknik, në kuadër të jetës nën një shfrytëzim të egër kolonial, është i pakët e edhe ai që është, është momentalisht në duart e armikut. Punonjësit dhe mbarë populli shqiptar në tokat tona të pushtuara jeton në skamje dhe mjerim dhe i ekspozohen jo vetëm shtypjes e grabitjes, por edhe një demagogjie e propagande të fuqishme revizioniste, e cila ka për qëllim ta përjetësojë pushtetin e huaj mbi popullin tonë.

Mirëpo, ne, po vepruam me përkushtim dhe energji patriotike e revolucionare, do të kemi në dorë një faktor tjetër vendimtar: faktorin POPULL. Kur të ketë hyrë i vendosur e i bashkuar në shërbim të luftës së drejtë çlirimtare, populli përbën një fuqi të jashtëzakonshme, e cila thyen çdo potencial teknik dhe numerik të armikut pushtues. Këtë e dëshmojnë luftërat çlirimtare dhe revolucionare në historinë e njerëzimit.

"Bashkimi" - gazetë e popullit

Organizata jonë masive, FRONTI I KUQ POPULLOR, dhe organi i saj "Bashkimi" kanë marrë përsipër detyrën e vështirë po të ndershme e të domosdoshme: grumbullimin dhe përgatitjen e forcave tona patriotike e revolucionare për luftën nacionalçlirimtare dhe bashkimin e tokave dhe të popullit shqiptar të viseve të robëruara me Atdheun e përbashkët, Shqipërinë socialiste.

Nuk ka kurrfarë leverdie dhe nuk është revolucionare të fryhen në mënyrë joobjektive rezultatet e arritura nga puna jonë. Do pranuar se këto rezultate, në kushte të vështira të ilegalitetit, kur për një fjalë goje dergjesh në burg, janë rezultate modeste. Mirëpo, nuk mund të mohohet as ndikimi i organizatës dhe gazetës sonë dhe depërtimi ynë gjithnjë më i madh në radhët e punonjësve dhe të masave popullore. Dhe, ç'është poashtu me rëndësi, tërbimi i armikut, si rrjedhim i punës sonë. Le të guxojë klika titiste ta lejoj shpërndarjen e lirë vetëm të një numri të "Bashkimit"! Le të dalë ai vetëm njëherë botërisht në fshatra e qytete, shkolla e fabrika - në trojet tona të robëruara! Natyrisht, ëndrra të tilla nuk shohim. Por, duke marrë me mend eventualitetin e tillë (absurd), do të shohim njëherazi efektin e fuqishëm të punës sonë, frikën e armikut për ekzistencën e vet dhe tërbimin e tij kundër së vërtetës, që ka për detyrë të sheshoj dhe që po e sheshon "Bashkimi". Kjo frikë nuk do të ekzistonte, tërbim nuk do të kishte, nuk do të burgoseshin njerëzit vetëm e vetëm pse i është gjetur "Bashkimi" sikur armiku t'i kishte sendërtuar ëndrrat e veta të liga për degjenerimin dhe asimilimin e popullit shqiptar në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi e në Serbi. Prandaj, në qoftë se ndonjëherë do të ligemi, të dëshpërohemi apo të bëhemi skeptikë, është një metodë e sigurtë për t'i njohur mundësitë dhe efektet tona: duke shikuar pasqyrimin e punës sonë në sy të armikut. Natyrisht, kjo u rekomandohet atyre individëve të vaktë, që vullnetin nuk ua cilëson çelikosja dhe rezultatet nuk ua jep puna sistematike dhe me gjithë qenien. Për pjesën e vetëdijshme të popullsisë sonë është e qartë njëherë e përgjithmonë se te ne kurrë nuk do të pinë ujë gënjeshtër dhe demagogjitë që kanë për qëllim t'ia zgjatin jetën robërisë sonë. Prandaj, në këso kushtesh, leja për shpërndarje të lirë të një numri të gazetës sonë, do të kish qenë vetëvrasje për qeverinë revizioniste të Beogradit.

"Bashkimi" po fiton përditë e më shumë autoritetin e një gazete të popullit për popullin. Ne nuk do të gjuhëzohemi para torturave dhe terrorit që po ushtron armiku barbar mbi forcat tona patriotiko-revolucionare. Le të na burgosin, le të na torturojnë. Kjo është puna e tyre. Puna e mizorit që i ka të numëruara ditët. Puna jonë është të qëndrojmë ballëllartë e të paepur, ashtu si do t'ia shtiem edhe më shumë tmerrin pushtuesit. Dhe punës nuk do t'ia ndajmë deri në fitoren e plotë. Prandaj edhe ju mblidhni forcat, mos u bëni "amin" burgosjeve, ndjekjeve, frikësimeve e shantazheve. Kjo le të jetë përgjigja e popullit për terrorin e armikut. Ne, po na e dhatë të drejtën dhe mundësinë, jemi të gatshëm të vdesim në ballë të radhëve tuaja.

Përvetësimi i literaturës revolucionare

"Po deshëm që lufta jonë, nga një rezistencë spontane, të kalojë në luftë të organizuar për çlirimin kombëtar dhe klasor, atëherë para nesh shtrohet si domosdoshmëri studimi dhe përvetësimi i historisë kombëtare dhe i literaturës revolucionare marksiste-leniniste. Zotërimi i kësaj literature nga avangarda jonë dhe popullarizimi i saj në masa ka qenë dhe mbetet detyrë primare për zgjimin e vetëdijes kombëtare e klasore të masave popullore dhe të punonjësve.

Nën kujdesin e Partisë së Punës të Shqipërisë, sot në Atdheun tonë socialist lulëzon një literaturë e begatshme revolucionare. Nga literatura e tillë, që duhet të përvetësohet në mënyrë të domosdoshme dhe të ngutshme, sidomos nga pararoja jonë revolucionare, donë veçuar këto pikëmbështetje kryesore: veprat e Marksit, Engelsit, Leninit, Stalinit e ato të marksist-leninistit dhe prijësit të madh shqiptar, shokut Enver Hoxha; historia kombëtare shqiptare, ajo e PPSH-së dhe dokumentet e PPSH-së; shtypi shqiptar, sidomos publikimet shkencore nga lëmi i historisë dhe ai i ndërtimit teorik dhe praktik të socializmit në Atdheun tonë.

Vetëm pasi të kemi përvetësuar këtë literaturë ne do të jemi të pajisur me një vetëdije të lartë kombëtare e klasore, e cila do ta bëjë më të sigurtë hapin tonë dhe depërtimin tonë në gji të popullit; me këtë vetëdije, forca jonë goditëse mbi armikun tonë shekullor, do të shumëfishohet.

Për një Shqipëri socialiste të të gjithë shqiptarëve

Lëvizja jonë, lufta jonë nacionalçlirimtare, revolucionin ynë, na shpien pikërisht te qëllimi ynë kryesor: te një Shqipëri socialiste e të gjithë shqiptarëve. Kjo aspiratë është vënë edhe në ballë të organit tonë "Bashkimi" në trajtë parulle.

Nëse lufta jonë nacionalçlirimtare synon çlirimin kombëtar të të gjitha trojeve tona të pushtuara nga Jugosllavia, atëherë jemi duke luftuar për një Shqipëri. Nëse pos çlirimit kombëtar synojmë edhe çlirimin klasor, atëherë jemi duke luftuar për një Shqipëri socialiste, e cila pas bashkimit të tokave që iu shkëputën padrejtësisht trungut shqiptar, do të jetë Shqipëria socialiste e të gjithë shqiptarëve.

Ai që bënë zhurmë duke na e mohuar një të drejtë të tillë, në thelb është reaksionar, sepse pikëpamjet e tilla janë kryekëput pikëpamje imperialiste, kolonialiste e revizioniste. T'i mohosh popullit tonë të drejtën e luftës nacionalçlirimtare, do të thotë të pajtohesh me robërimin e popujve, dhe kjo është antimarksiste e antileniniste.

Bashkëpunimi internacionalist i forcave tona çlirimtare

Sa i përket bashkëpunimit internacionalist me forcat përparimtare në botë, Fronti i ka vënë vetes detyrë të përhershme afirmimitin e luftës sonë të drejtë dhe ndihmën reciproke ndërmjet elementeve revolucionare. Më në fund, konsiderojmë se ngadhënjimi i luftës dhe i revolucionit tonë do të jetë njëherazi kontribut për fitoren e revolucionit socialist në botë. Në këtë drejtim rezultatet tash për tash janë modeste, por ato inkurajojnë për suksese të mira në të ardhmen.

Po kur është fjala për bashkëpunim me fqinjët e parë, çështje që parimisht duhet të ketë edhe vendin e parë, në këtë drejtim dalin pengesa të shumta. Në gjithë të kaluarën tonë fqinjësore, siç tregon përvoja shekullore, "Bashkimi i armëve(shqiptare) me fqinjët e Ballkanit ka qenë (për ne) vetëvrasje". Edhe më keq ka dalë puna në luftën e fundit. Në emër të internacionalizmit proletar dhe të frontit të përbashkët antifashist e nacionalçlirimtar shqiptar i pati bashkuar armët me serbin, malazetin dhe maqedonasin.

Mirëpo udhëheqja e PKJ-së, pa mbaruar mirë lufta, e hodhi maskën dhe e tregoi qëllimin e vërtetë; ajo kishte bërë me shqiptarin marrëveshjen që mund të bëjë xhelati me viktimën me urdhrin e saj në Kosovë erdhën brigada e divizione partizane, që likuiduan mbi 40 000 shqiptarë të pafajshëm në emër të lëvizjes balliste. Pas lufte ishte e natyrshme që popull ynë, për gjakun e derdhur në Srem e Slloveni, të gëzonte një simpati sado të vogël së paku nga ana e popujve fqinjë sllavë, atë që nuk e gëzonin nga qeveria revizioniste. Po gjithë argumentet që mund të mblidhen nga fërkimet e popullsisë sonë me serbët, malazezët e maqedonasit bien më shumë erë shovinizmi të papërmirësueshëm nga ana e tyre, sado që ata kanë hyrë në borxh te ne e jo ne te ata.

Kështu çështja e bashkëpunimit në baza të internacionalizmit proletar me serbët, malazezët dhe maqedonasit për ne është gjë shumë e vështirë, ndoshta edhe e pamundshme. Megjithate, kur te këto popuj të kemi hetuar disponim të mirë për bashkëpunim mbi bazat e përmendura, ne nuk do ta refuzojmë.

Kolonët serb, malazez e maqedonas, që janë sjellë nga kralët e hershëm dhe të sotëm me qëllim që të popullzojnë tokat e pushtuara shqiptare dhe t'ua ndërrojnë atyre fizionominë etnike, me pretendim që të fitojnë të drejta "historike" mbi tokat tona, duhet të vendosin me kohë për qëndrimin që do të mbajnë karshi luftës sonë nacional-çlirimtare. Ata duhet të jenë të vetëdijshëm se, duke qenë të ngulitur këtu nga kralët, apo duke ardhur pas lufte në tokat shqiptare, ndërkohë që pjesa më vitale e shqiptarëve është e detyruar të emigrojë - për shkak të politikës diskriminuese të pushtetit beogradas ndaj shqiptarëve, janë duke u bërë vegël e verbër në dorën e aspiratave shoviniste beogradase. Ne, shqiptarët, s'kemi si ta kuptojmë politikën e maqedonasve me diasporën e tyre të Egjeut, të cilën po e vendosin me favore të shumta në viset shqiptare, dhe të ashtuquajturit "egejci" po i bëjnë pykë për shtyrjen e shqiptarëve nga vatrën e veta.

Detyra të ngutshme

Jugosllavia është duke përjetuar krizën më të madhe në historinë e saj. Si bishë e plagosur për vdekje, ajo po e kompenson agoninë e vet me diktaturë e terror mbi popujt që ka mbërthyer në kthetrat e veta të përgjakshme. Si gjithmonë, egërsia e saj po shprehet më së shumti mbi popullin e robëruar shqiptar. Kohëve të fundit po dalin gjithnjë më haptazi edhe aksione çetnike, të nxitura e të përgatitura nga pushteti. Këto, se dhe tejmbushja e kupës së quajtur robëri, na detyrojnë të marrim qëndrim përkatës e të prerë për t'iu ndajvënë sa më me sukses veprimeve të armikut dhe për t'i shërbyer sa më mirë çështjes sonë të shenjtë: çlirimit dhe bashkimit të trojeve dhe të popullit shqiptar në një shtet kombëtar me pushtet popullor.

"Detyrat e njerëzve revolucionarë, përparimtarë, patriotë në vendet me zhvillim të ulët ekonomik-shoqëror dhe të varura prej fuqive imperialiste e socialimperialiste, është t'i bëjnë të ndërgjegjshëm popujt për këtë shtypje e shfrytëzim, t'i edukojnë, t'i mobilizojnë, t'i organizojnë, t'i hedhin në luftë çlirimtare, duke mbajtur parasysh kurdoherë se revolucionin e bëjnë masat e gjëra, popujt." (Enver Hoxha, Imperializmi dhe revolucioni).

Dhe pakënaqësia ekzistuese e popullit si dhe situata e përgjithshme na bëjnë optimistë kur e do puna të hymë në radhët e popullit për t'i çuar në vend detyrat tona. Klika në pushtet nuk është më në gjendje t'i shtyp popujt si më parë, me mashtrime e demagogji, dhe mbase as me diktaturë. Përditë po bëhet më e qartë se mbarësia a prapësia e Jugosllavisë nuk varet nga mbarësia a prapësia e ndonjë individi (a grupi) në krye të saj. Puna është te rendi i kalbëzuar antipopullor, i cili s'ka shërim. Sa më shpejtë që të fillojë përfundimtare, aq më shpejtë do t'u kthehet liria dhe lumturia e grabitur popujve të kësaj pjese të Ballkanit.

Mirëpo kjo pakënaqësi, që vetvetiu përbën një nga forcat kryesore të luftës së ardhme, implikon para së gjithash edhe nevojën e përdorimit të saj me kohë e me vend. Sepse, si forcë goditëse, ajo ka një cilësi të atillë, që nuk i shfaqet kujtdo. Ajo do t'i shfaqet vetëm atij që është i denjë për luftën e vendosur dhe serioze, deri në fitore, pa marrë parasysh vështirësitë dhe sakrificat. Prandaj, si bij revolucionarë të popullit tonë, ne, në radhë të parë, duhet ta kemi parasysh pakënaqësinë e madhe të popullit dhe të hyjmë në esencën e saj e t'i përgatisim asaj terren të vërtetë për grushtin e saj të fuqishëm. Skënderbeu s' bëri gjë tjetër, veçse e mblodhi atë, rebelimin e shpërndarë dhe e sistemoi." (Ismail Kadare, Ura me tri harqe).

Një nga detyrat e ngutshme të patriotëve dhe të revolucionarëve shqiptarë në kushtet aktuale, është që t'u bashkangjiten radhëve tona të organizuara, Frontit të Kuq Popullor dhe organizatave e grupeve të tjera revolucionare. Ne nuk e nënçmojmë as legale e gjysmëlegale të disa njerëzve të ndershëm. Por s'ka asnjë dyshim se revolucionari, sado i përgatitur dhe i gatshëm që të jetë deri sa të mos u bashkohet radhëve të organizuara, do të jetë një ishull i vetmuar dhe i brishtë.

Ndërkaq për organizatat dhe grupet revolucionare, sot më shumë se kurrë shtrohet nevoja e njohjes reciproke dhe e bashkimit të shpejt. Siç mund ta dimë, në viset shqiptare nën Jugosllavi ekzistojnë një numër i konsiderueshëm grupesh e organizatash patriotiko-revolucionare, me karakter regjional e mbiregjional. Kjo është e natyrshme për një periudhë të caktuar në përgatitjen e luftës çlirimtare dhe revolucionit, sepse e kushtëzojnë rrethanat e vështira të punës në ilegalitet të thellë - për shkak të presioneve të mëdha të armikut për shuarjen e çdo shkëndijëze revolucionare. Por duke u nisur nga kushtet konkrete, nga kriza që po pëson sidomos kohëve të fundit armiku ynë, nga zhvillimi i këtyllë i ngjarjeve që flet për procesin e shembjes gjithnjë më të shpejtuar të tij, si dhe nga qëllimet, strategjia e taktika e njejtë e grupeve dhe organizatave tona revolucionare, sot ekzistojnë shumë mundësi për bashkimin e tyre në një organizatë të vetme e të fortë. Dikur, kur ngjarjet të kenë marrë përmasa të tjera, do të mund të bëhet vonë për bashkim të suksesshëm. Sepse si thoshte Lenini, në "çastet e shpërthimeve e plasjeve, është vonë për krijimin e organizatës; ajo duhet të jetë e gatshme që të mund të zhvillojë menjëherë veprimtarinë e vet."

Çështje organizative - strategjia dhe taktika

Vetëdija për procesin e shthurjes dhe të shembjes së shpejtë të socialshovinizmit jugosllav në krye me hegjemonizmin serb, nuk na jep të drejtë të nënçmojmë forcën armike. Përkundrazi, Jugosllavia, duke qenë e mbështetur fort në forcat e errëta reaksionare dhe antipopullore nga brenda dhe jashtë, përkundër plagës së rëndë që ka marrë nga kriza ku është katandisur me të katër këmbët, mund të zvarritet edhe për një kohë të gjatë, po s'ia dhanë të shtyrën forcat përparimtare nga gjiri i popullit tonë dhe i popujve të tjerë që vuajnë nën klikën e Beogradit. Prandaj, është e qartë se për t'ia arritur qëllimit, duhet një organizim i fuqishëm e serioz, që do të jetë në gjendje ta godasë atë për vdekje.

Para nesh tani shtrohet një çështje e rëndësishme, ajo e raportit dhe programit revolucionar dhe veprimit revolucionar. "Çdo gjë që bënë lëvizja e vërtetë, - shkruante Marksi, - ka më tepër rëndësi se një duzinë programesh." Kurse Lenini shton se "pa teori revolucionare nuk ka revolucion." Prandaj, pasi ne nuk kemi pse të frikësohemi për "teorizime", do të thoshim se na duhet një program i denjë për një lëvizje të denjë. Me këtë rast duhet të vëmë në dukje se ne ende nuk kemi qenë në gjendje ta formojmë partinë tonë komuniste marksiste-leniniste, pa të cilën gati do të jetë e pamundshme hyrja konkrete në luftën e ardhshme nacionalçlirimtare dhe në revolucionin tonë. Kjo na nxjerr

te një çështje tjetër që kërkon sqarim. Ishte Partia Komuniste Shqiptare (sot Partia e Punës e Shqipërisë) ajo që e pat themeluar Frontin Nacional Çlirimtar (sot Fronti Demokratik). Dhe kjo ishte rruga e drejtë. Te ne ka ngjarë e kundërta. Fronti i Kuq Popullor, i themeluar prej forcash patriotike, pret themelimin e partisë sonë komuniste marksiste-leniniste e cila do të vihet në ballë të luftës dhe të revolucionit. Sipas vlerësimeve të Frontit, arsyeja për këtë inverzion qëndron në kushtet konkrete, të cilat kanë ndikuar që forcat patriotike të masave të gjëra të ecin një hap përpara organizimit të komunistëve tanë. Në kësi konteksti e shohim aktivitetin e Lëvizjes Nacional Çlirimtare të Kosovës dhe të Viseve të tjera Shqiptare nën Jugosllavi - një organizatë e hershme, që ka mbledhur dhe mban rreth vetes njerëz me eksperiencë patriotike e revolucionare dhe me të cilën jemi duke bërë përpjekje për njohje reciproke dhe për bashkim. Në kësi konteksti jemi duke përcjellë gjithashtu edhe aktivitetin e Marksist-leninistëve të Kosovës, që po shfaqen këto kohët e fundit me organin e tyre "Liria". Duke u nisur nga kryeartikulli në numrin e parë të këtij organi, si dhe nga përmbajtja e tij përgjithësisht e nga trajtimi marksist-leninist i problemeve nga ana e krijuesve të "Lirisë", ne e vlerësojmë shumë të drejtë punën e Marksist-leninistëve kosovarë. Kjo na jep shpresë që së shpejti, ndoshta pikërisht nga radhët e tyre, do të realizohet edhe kërkesa e domosdoshme për themelimin e vetë partisë komuniste marksiste-leniniste.

Për sa i përket strategjisë së ndjekur gjer më tash në luftë kundër socialshovinizmit jugosllav, ne kemi vlerësuar se pjesa më e madhe e grupeve dhe organizatave patriotiko-revolucionare shqiptare janë puqur në një pikë: në etapën e deritashme të luftës e të revolucionit tonë, ato i kanë dhënë armikut një grusht nga aspekti politik, duke bërë me veprimtarinë e tyre të ngritet vetëdija kombëtare e masave tona popullore. Vitet e fundit bashkë me vetëdijen kombëtare janë arritur rezultate të shënueshme edhe në ngritjen e vetëdijes klasore, që është një hap i madh cilësor drejt revolucionit. Këtë ua dimë për nder patriotëve e revolucionarëve tanë, që ditën ta përqafojnë e ta përhapin në masa literaturën revolucionare marksiste-leniniste, sidomos atë që po botohet në Tiranë dhe është bërë fener ndriçues edhe për forcat revolucionare në të gjithë botën.

Mirëpo, vlerësojmë ne gjithashtu, tani ka ardhur koha që të kalohet në një etapë tjetër të luftës: në aksione të sinkronizuara për dëmtimin e armikut edhe në pikëpamje ekonomike e luftarake. Kështu sikurse strategjia, edhe taktika e deritashme, në rast të tillë, duhet t'ia lëshoj vendin taktikës së re. Në këso kushtesh bëhet edhe më i nevojshëm bashkimi i shpejt i organizatave tona patriotiko-revolucionare, të cilat, deri më tash, megjithë strategjinë e njejtë apo të ngjashme, kanë aplikuar taktika të ndryshme."

Qëndrimi ndaj burgosjeve politike

"Do të ketë gjithmonë koka që ngrihen, sepse, s' do të ishte as fjala kryengritje, që, në fund të fundit s' do të thotë gjë tjetër, veçse "kokëngritje". Pra do të ketë gjithmonë koka që do të ngrihen e pastaj, si rrjedhim, do të priten, dhe ata që do t' i shikojnë ato... do të thonë me vete: jo, unë s' do ta bëjë kurrë një gjë të tillë. Kështu do të thonë, mirëpo sikur t' i ketë shtyrë djalli, fill pas kësaj s' do mendojnë veçse të bëjnë pikërisht atë që s' duhet të bëjnë."

Shtimi gjithnjë më i madh, dhe jo zvogëlimi i aktivitetit të organeve ndjekëse jugosllave ndaj forcave patriotike, e dëshmon në mënyrë të gjallë këtë mendim të Kadaresë. Klika titiste, me bajraktar hegjemonizmin serbomadh dhe përcjellës të parë shovinizmin maqedonas dhe malazez, "me forcën brutale po përpiqen të skllavërojnë racën tonë e të përjetësojnë qeverimin tiranik të tyre". Po bëhen katër dekada (vetëm nga Lufta e këtij) që ata nuk po zgjedhin mjete për ushtrimin e gjenocidit mbi popullin shqiptar. Një nga këto mjete, shumë e preferuar ishte dhe mbeti burgosja e çdo filize

shqiptare, posa ta ketë dhënë shenjën e parë se nuk do ta pranojë verbërisht robërinë. Populli ynë është në dijeni për bijtë e tij të zgjedhur, që dergjen në burgjet e Jugosllavisë. Ai po i përcjell e dhembje edhe burgosjet e paradokohshme, që edhe sot po rrëmbejnë valë-valë shumë patriotë shqiptarë. E di mirë populli pse Klika titiste nuk po ka guxim të na denjësojë as me të drejtën tonë elementare: që të informohemi publikisht se kush janë të burgosurit, sa u dënuan dhe pse. Prandaj, më shumë se kurrë po e çjerrë marimangën e harresës, me të cilën ka qëllim ta mbulojë e ta hedhë në harresë UDB-ja fashiste.

Karshi këtyre akteve të egra, ne duhet të kemi qëndrimin tonë përkatës. Edhe ky qëndrim, vlerëson Fronti i Kuq, duhet të ndërroj nga i deritashmi. Mendojmë se duhet t'i kthehem pak historisë. Xhandarët e Stojadinoviçit, ta zëmë, e vranë komunistin Zef Lush Marku, në fillim të këtij shekulli; por ata s'patën si t'i përballojnë kërkesës së opinionit që kërkonte informim të hollësishëm për vrasjen e tij mizore. Ata nuk ia dolën ta ndalin as shoqërinë e ngushtë dhe familjen e tij që kufomën e komunistit e nxorri nga varri dhe e varrosi atje ku përkiste. Në Jugosllavinë e sotme, UDB-ja e PKJ-ja e vrasin mizorisht Fazli Grajqevcin në burg (më 1964) dhe djaloshin Murat Mehmeti (në demonstratat e vitit 1968); dhe as na informojnë pse e si i vranë dhe nuk na lejojnë t'ua bëjmë gjëmën si ka hija as t'i varrosim ku duhet e si duhet! Prandaj, në qoftë se terrori i sotëm ia kalon terrorit të kralëve të vjetër jugosllavë, të cilit Kamer Loshi, Shotë e Azem Galica iu përgjigjën me zjarr, pse atëherë ne të mos i lejojmë vetes t'ia kthejmë njëherë e mirë dhe me të njejtën masë armikut tonë të tërbuar.

Lidhur me atë që do të duhej të ndryshonte te ne në këtë qëndrim, ne propozojmë sa vijon:

1. Ata po na burgosin pa të drejtë. Dhe ne, me të drejtë, të mos u dorëzohemi. Kur ta rrethojnë shtëpinë, nga e cila s'ke ku shkon më tej, nëse je i përgatitur shtjer mbi ta dhe ua mbush barkun barot! "Udbashi" është një terrorist, që e çon në vend terrorin e planifikuar shtetëror jugosllav. Po s'pate kushte për mbrojtje me armë, ruaje gjakftohtësinë, mbli dhe urrejtjen, në qëndrimin tënd të palëkundshëm, jepi grusht armikut gjatë hetimeve dhe në burg. Mos jeto në iluzione për dobinë nga qëndrimi më i butë. Ti je dënuar në Beograd, dënimin tënd e përtyp gjyqtari në Prishtinë si shiriti i magnetofonit fjalët e inçizuara kushedi se kur.

2. Ta kanë arrestuar djalin, vajzën, vëllaun, motrën, burrin, babanë apo shokun. Më së miri do t'ia nxjerrësh hakun nëse menjëherë i kërkon radhët e organizuara dhe hidhesh në luftë të organizuar revolucionare.

3. Ta kanë arrestuar kushëririn, fqinjin apo mikun e shtëpisë, bashkëqytetarin a bashkëfshatarin. Ata do të bëjnë mbi ty presione të ndryshme që të mos mbash kontakte me familjen e të burgosurit. A do ta dëgjosh armikun dhe t'ia kthesh shpinën njeriut tënd në çastet më të nevojshme?! "Miku i mirë në ditë të vështirë!" Sa herë e ke përdorur vetë këtë frazë?! Zbatoje, pra, në jetë! Kështu, edhe s'ia çon armikut amanetin në vend edhe solidarizohesh me tëndin dhe i jep krah atij. Sepse, mos harro, qysh nesër mund të të burgosin edhe ty, apo të të burgosin djalin e dëshirit, vajzën, vëllaun. Ç'do të ngjajë atëherë me familjen tënde, nëse rrethi e izolon fare?!

4. Burgosjet masive që po i bënë armiku në viset shqiptare, kurrsesi, nuk duhet të na ligin. Mos u dëshpëro dhe, mbi të gjitha, mos u frikëso. Ti je duke përcjellë në burg një pjesë të djalërisë shqiptare, por nesër do ta shoqërosh, në luftën çlirimtare, të cilën po e përgatisin bashkëluftëtarët. A s'ke dëgjuar kurrë se burgosjet, kur bëhen kaq masive, janë shenjë e dobësimit të armikut dhe përparimit të shpejtë të lëvizjes çlirimtare. Kështu burgoseshin para disa vjetësh edhe revolucionarët e Nikaraguas, por, e fituan lirinë. Dhe, liria s'ka çmim.

Ngritja e forcave organizative që do të zëvendësojnë organizatorët e arrestuar

Me burgosjet masive, që bëri me valë gjithnjë më të mëdha për më se një vit e gjysmë, UDB-ja nuk e realizoi dot qëllimin e vet. Ajo kishte ndier praninë e fuqishme të një dore të organizuar patriotiko-revolucionare, që ushtronte ndikim thuaja në të gjitha viset shqiptare të pushtuara nga Jugosllavia. Por, megjithë rrjetin e fortë të spiunëve dhe provokatorëve të regjur, ajo nuk ia doli të siguroj kurrfarë të dhënash konkrete për bazën e aktiviteteve revolucionare. Dhe, meqenëse aktiviteti po shtohet dita më ditë, duke shtrirë një ndikim gjithnjë më efektiv në masat popullore dhe në punonjësit shqiptarë, UDB-ja u detyrua të ndërmerre më në fund diçka konkrete për të penguar zhvillimin e hovshëm të luftës dhe të revolucionit tonë. E vetmja mundësi, që i kish mbetur asaj në këtë drejtim, ishte asgjë tjetër përveç se një gjah nëpër mjegull.

Kështu, në kulmin e dëshpërimit, të mospërfilljes së ligjeve kushtetuese e ndërkombëtare, dhe në kulmin e papërgjegjësisë ndaj popullit dhe masave punonjëse, UDB-ja burgosi në mënyrë energjike disa qindra e mijëra djelmosha e vajza shqiptare, pa siguruar as argumentet më elementare kundër tyre (pos nëse merret si argument një libër, vetëm pse është botuar në Tiranë, një shkrim me përmbajtje revolucionare, eventualisht një gazetë ilegale, siç është ta zëmë "Bashkimi"). Nga ky numër jashtëzakonisht i madh të arrestuarish, UDB-ja shpresonte se do t'i bjerë në fije lëmshit: qoftë duke gjetur në mesin e të arrestuarve pahiri ndonjë revolucionar të organizuar, qoftë duke nxjerrë me terror prej tyre ndonjë emër të rëndësishëm organizatorësh.

U arrestuan, u torturuan njerëzit tanë nëpër burgje, disa edhe dolën para gjyqit, të tjerë u lëshuan të shkonin në shtëpi, por nën përcjelljen e kujdesshme të agjentëve të fëlliqur. U çua një pluhur i madh në shtyp, Mahmut Bakalli iu kërcënua edhe një herë popullit të vet, e për hir të armikut shekullor, dhe mbi të gjitha u kujdes të fshihte sa më me kujdes përmasat e aktivitetit policor të sforcuar deri në shkallë fashiste në tokat shqiptare të robëruara. Por grupet dhe organizatat tona revolucionare mbetën thuaja të paprekura. UDB-ja nuk ia doli të shtjerë në dorë asnjë organ udhëheqës të këtyre grupeve dhe organizatave.

Dhe gjithë ky proces i tmerrshëm u përsërit disa herë dhe po vazhdon edhe sot. Më në fund, edhe nëse pohimi ynë është i gabueshëm, d.m.th. edhe nëse UDB-ja e ka zënë pikërisht zemrën e forcave tona të organizuara, kjo s'i bënë asaj kurrfarë dobie. Përkundrazi, pozita e saj bëhet edhe më e pashpresë. Sepse, është fakt se që nga fillimi i arrestimeve të nëntorit 1979, aktiviteti revolucionar në trojet shqiptare jo vetëm që nuk u rrudh as u shua, por vazhdoi me ritëm më të shpejtë dhe me përmasa më të mëdha. Pra, edhe nëse gjendja faktike flet për zënien e forcave tona të organizuara, ajo flet njëherazi edhe për lindjen dhe aktivitetin e sforcuar të forcave të reja, që vazhduan aty ku e kanë lënë të tjerët.

Me këtë kapitull për UDB-në dhe revolucionarët tanë, kësaj radhe patëm për qëllim të dalim te një kërkesë e rëndësishme që shtrohet para luftën dhe revolucionit tonë: te ngritja e forcave organizative, të cilat do të zëvendësojnë në mënyrë sa më të plotë e më energjike radhët e organizatorëve të dëmtuar nga armiku. Në situatën konkrete, ne vlerësojmë se është bërë një punë e shëndoshë, për aq sa është fryt i punës së forcave të organizuara aktivizimi i forcave të reja për dëmtimin e radhëve të armikut. Por, në qoftë se e vërteta qëndron ndryshe, atëherë, kjo gjë duhet të bëhet preokupim për punën revolucionare në të ardhmen. Sepse, pa rezervat e revolucionit, vihet në dyshim edhe vetë ngadhënjimi i revolucionit.

Një nga mënyrat e përshtatshme në përgatitjen e forcave të reja organizative, thotë Lenini, është ndarja e drejtë e punës revolucionare, e cila nuk guxon të koncentrohet në duar individësh apo grupesh të kufizuara. Gjithë puna revolucionare, sidomos ana e saj

organizative, duhet të përvetësohet në shkallë sa më të gjerë dhe në të gjitha punktet ku ushtron ndikim grupi apo organizata e caktuar revolucionare. Po s'u veprua kështu, do të krijohen patjetër marrëdhënie personale e lokaliste brenda organizatave. Do të lihen pas dore anëtarët "periferikë" të tyre. Ata nuk do të mund të ushtrohen dhe përvetësojnë aftësinë e organizimit, sidomos në kushte të ndryshuara objektive; ata nuk do ta përvetësojnë e lëre më ta përsosin, as teknikën e konspiracionit, e do të mbesin të mangët edhe në zotërimin e literaturës revolucionare, duke e përhapur atë, e jo edhe duke e studiuar për vete. E keqja më e vogël që mund të dalë nga një qëndrim i tillë, është paaftësia e anëtarëve "periferikë" për propagandë e agjitacion të shëndoshë në mesin ku veprojnë ata. Kur punës revolucionare t'ia marrësh edhe momentin e propagandës dhe të agjitacionit të vërtetë, atëherë ia ke marrë edhe dimensionin e saj primar dhe e ke shndërruar në punë antirevolucionare.

Më në fund, marrëdhëniet demokratike revolucionare, që janë synim i parë dhe i përhershëm i revolucionit tonë, patjetër shprehen qysh në hapat e parë të organizimit të forcave revolucionare.

Rinia përparimtare - rezervë e pashtershme

22-vjeçari i sotëm ende nuk ka qenë i lindur, kur UDB-ja e pat burgosur herën e parë për veprimtari patriotike shokun Adem Dema-Demaçi, në vitin 1958. Sot këtë 22-vjeçar e kemi burrë të rritur e të pajisur me vetëdije të lartë kombëtare e klasore dhe me një gatishmëri e guxim të pashoq për t'u futur si e kërkon nevoja në zjarrin e luftës e të revolucionit. Në qoftë se ai është aftësuar edhe në pikëpamje organizative, atëherë, për kauzën tonë kanë ardhur kohë të mbara.

Si ka mundur ai të aftësohet në pikëpamje organizative, pasi me moshë është shumë i ri dhe është rritur në kushte të atilla, në të cilat njeriu e ka vështirë të shtjerë në dorë literaturë përkatëse; pastaj kushtet e ilegalitetit dhe të rrezikut të madh nga agjentët e regjur, kanë qenë në fuqi edhe për të, madje veçanërisht për të, si njeri i ri dhe pa përvojë.

As historinë e mirëfilltë kombëtare, as teorinë marksiste-leniniste të mirëfilltë, ai nuk ka pasur mundësi t'i mësojë në shkollë dhe as në kushte të hapëta publike. Cilat paskan qenë, pra, burimet e frymëzimit të tij dhe si u stërvit ai në punë organizative?

Natyrisht, momentet që ndikojnë në edukimin e përgjithshëm të njeriut dhe në formimin e plotë të personalitetit të tij, pra edhe të personalitetit të tij revolucionar - janë të shumta dhe të pallogaritshme. Kështu ka ngjarë edhe me 22-vjeçarin tonë në shqyrtim. Por, këtu e do puna që, pa hyrë në ndonjë analizë tjetër, ta veçojmë ndikimin që ka mundur ta ushtrojë ndonjë grup apo organizatë revolucionare e llojit të atillë që kanë vepruar ndër ne, duke u hapur edhe ndaj të rinjve, që do të thotë, duke analizuar edhe këtë premisë të propagandës së shëndoshë revolucionare.

Po e ndoqëm edhe më tutje këtë fill, do të dalim te një dimension i domosdoshëm i revolucionit - te çështja e vazhdimësisë së tij.

Rinia është rezervë e pashtershme e revolucionit. Konkretisht, rinia jonë, si për shkallën e arsimit, të vetëdijes kombëtare e klasore, ashtu edhe për vitalitetin e saj, paraqet një kërcim të madh përpara, në pikëpamje të sasisë dhe të cilësisë. Gjasat e armikut tonë, revizionistëve jugosllavë dhe renegatëve shqiptarë, për shtrirjen e ndikimit në rininë tonë po bëhen përditë më të vogla. Rinia jonë i shmanget si lisë së zezë këtij armiku të egër. Kështu, heshturazi dhe haptazi, ajo po tregohet e gatshme të pranojë një ndikim tjetër - ndikimin e forcave tona përparimtare patriotike e revolucionare. Prandaj, në këto kushte, edhe ne e kemi detyrë t'i kushtojmë vëmendjen e duhur punës organizative me rininë tonë përparimtare, shkollore e studenteske, fshatare e punëtore etj., duke e aftësuar atë për

propagandimin e idesë revolucionare në mesin e vet e në popull, por edhe për t'u organizuar në shkallën më të lartë.

Këtë detyrë duhet ta kuptojmë aq më seriozisht, sa më seriozisht të kemi kuptuar se revolucioni nuk është problem që zgjidhet për një ditë, por një proces i gjatë e i mundimshëm, me sakrifica të mëdha.

Dy fjalë për konspiracionin

Shtrohet çështja: si mund të zhvillohet aktiviteti i hapur organizativ në kushtet e sotme, kur armiku ka stërvitur agjentë të regjur, të ngarkuar për zbulimin e radhëve tona dhe për shkatërrimin definitiv të idesë e të aksionit luftarak e revolucionarë? Pastaj: ç'qenka, pra, gjithë ai theksim i domosdoshmërisë për zotërimin e teknikës së konspiracionit më të thellë?!

Konspiracioni, ose teknika e ruajtjes rigoroze të fshehtësisë, është një nga faktorët kryesorë të veprimtarisë revolucionare të organizuar. Konspiracioni i jep revolucionarit mundësi për punë sa më të fuqishme ilegale, kurse armikut të popullit dhe të klasës aspak mundësi për ta zbuluar atë punë revolucionare të organizuar. Proporcionalisht, çdo dobësim i konspiracionit, aq sa merr nga mbarësia e punës revolucionare, aq i shton gjasët për prapësinë e punës së armikut në zbulimin e veprimtarisë revolucionare, e kështu edhe në dëmtimin e revolucionit përgjithësisht.

Në një shkallë të caktuar të organizimit revolucionar, ka ngjarë edhe të keqkuptohet e të simulohet konspiracioni: si rrudhje e tepërt, mendimi i tillë ekziston në radhë të parë tek ato forca, që në fakt janë pozitive dhe të pastra, por jo edhe të stërvitura për luftë të gjatë, te ato forca që janë të orientuara kah efektet e rrëmbyeshme të luftës, pa durim për të pritur aksionet me ndikim afatgjatë. Konspiracioni, siç vë në dukje Lenini, udhëheqësi i madh i revolucionit socialist, është i domosdoshëm për punën revolucionare, pasi ajo zhvillohet në kushte të vështira të ilegalitetit më të thellë. Bile, pa përsosjen e konspiracionit, shton Lenini, nuk ka as aktivitet të mirëfilltë revolucionar.

Kësaj radhe, sa për udhëzimet praktike se çka duhet ruajtur sekret e çka duhet shpallur me daulle, po ndalemi në pika të shkurta. Konspiracioni më i thellë, që nuk guxon të çenohet në asnjë mënyrë, përbëhet nga ruajtje e fshehtësisë lidhur me dokumentet interne të organizatës revolucionare. Këtu bëjnë pjesë statuti i organizatës, bazat e organeve udhëheqëse, shtypshkronja, depoja e armëve. Po kështu, kurrë nuk duhet të përmendet asnjë emër konkret i cilitdo person të inkuadruar në radhët e organizatës revolucionare. Këto gjëra e kanë peshën e sekreteve ushtarake dhe zbulimi i tyre, te organizatat me përvojë, konsiderohet tradhti e dorës së parë dhe dënohet rëndë.

Nuk duhet të ruhet në fshehtësi, po, përkundrazi, të shpallen, masivisht pikëpamjet e organizatës lidhur me situatën në botë e në vend sidomos për strategjinë dhe taktikën e armikut dhe mjetet me të cilat ka mundësi të dëmtohen ajo strategji e ajo taktikë. Me këtë rast, gjithmonë duket të kesh parasysh se nuk të lejohet në asnjë mënyrë të tregosh se di diçka për ekzistimin e ndonjë organizate patriotiko-revolucionare.

Statuskuoja, ngrirje e të drejtave të popujve e të punonjësve

Për të mbrojtur pozitat e veta: sundimin mbi popujt e shtypur, mbi pasuritë e veta e të huaja, mbi rezultatet e punës së punonjësve në botë, kapitalizmi, socialshovinizmi dhe revizionizmi kanë siguruar edhe mekanizma përkatëse në shkallë shtetërore e ndërshtetërore. Kryerorë e "trashëgimisë" imperialiste e revizioniste janë ushtritë dhe policitë e tyre antipopullore, që ruajnë shtypjen dhe shfrytëzimin e përligjur me dhunën

ndërkombëtare. Po një nga armët më dinake të gjakpirësve të popujve e të punonjësve në botë, është përpjekja që te masa të krijohet e të forcohet ideja dhe ndjenja e përjetësisë së kësaj gjendjeje, dhe të avullohet çdo iniciativë për ndryshimin e saj.

Një nga mjetet kryesore, që i shërbejnë në shkallë ndërkombëtare këtij qëllimi, është edhe popullarizimi me çdo kusht i idesë imperialisto-revizioniste për mbajtjen e të ashtuquajturës statuskuo, qoftë kur është fjala për "pandryshueshmërinë" e kufijve të tashëm shtetërorë në botë, qoftë për raportin në mes klasave ekzistuese në vendet e ndryshme, e në kurriz të klasës punëtore dhe të fshatarësisë.

Viktimë e dorës së parë të statuskuosë kemi qenë dhe kemi mbetur kurdoherë, në shqiptarët. Për të kënaqur apetitet pansllave dhe apetite të tjera ekspansioniste, fuqitë e mëdha i kanë shkëputur tringut të përbashkët shqiptar më se gjysmën e tokave dhe gati gjysmën e popullsisë, duke i lënë ato në mëshirën e shteteve të huaja me regjime të egra antipopullore, hegjemoniste e shoviniste. Kështu ngjau para dhe pas Luftës I Botërore, kështu edhe pas Luftës II.

Me daljen në dritë të përpjekjeve tona të mundimshme për luftë nacionalçlirimtare, për vetëvendosje dhe shkëputje nga Jugosllavia, e bashkim me vendin amë, RPS të Shqipërisë, është e natyrshme që dalin forca të errëta - te ne dhe në botë - të cilat përpiqen të na frikësojnë e të bëjnë presione të ndryshme, pikërisht duke pasur parasysh statukuonë e përmendur. Dhe kjo gjë ne s'na habit aspak, sepse propaganda dhe agjitacioni imperialisto-revizionist nuk mund të kalojnë pa bërë ndonjë efekt. Mirëpo na habit qëndrimi i pacipë i disa forcave, të cilat ndjekin rrugën revolucionare, siç janë ta zëmë disa parti marksiste-leniniste. Pa informata të sakta mbi historinë e popullit shqiptar dhe mbi gjendjen e mjeruar të shqiptarëve me banim në Jugosllavi, ato sikur duan të na e mohojnë gjithashtu të drejtën për luftë nacionalçlirimtare. Duke përdorur disa klishe prej arrivistësh të revolucionit, ata pëshpërisin: Ju duhet të veproni vetëm për ngadhënjimin e revolucionit proletar në Jugosllavi, jo ju duhet patjetër të zhvilloni një bashkëpunim internacionalist me serbët e malazezët, jo duhet të hiqni dorë nga vetëvendosja gjer në shkëputje dhe bashkimi me vendin amë, sepse vendi amë nuk e potencon kështu si ju çështjen tuaj, ju nuk keni të drejtë, e të tjera, e të tjera. Nga ana tjetër, kudo që u shfaqet rasti, ata nuk lënë pa propaganduar përkrahjen e tyre ndaj luftërave nacionalçlirimtare dhe revolucioneve. Dhe ne, duke pasur megjithatë konsiderata për punën e tyre përgjithësisht revolucionare, në vend që t'u hidhërohemi atyre, kemi parapëlqyer që t'i njoftojmë me çështjen tonë ashtu siç është ajo në të vërtetë.

Sa për zëdhënësit e imperializmit e të revizionizmit, që në emër të statuskuosë së tyre "shpëtimtare" na e mohojnë të drejtën elementare të ekzistencës kombëtare dhe të luftës klasore, ne, siç ua kemi vënë grushtin përpjekjeve të armikut jugosllav për të na shfarosur ose për të na mbajtur nën thundrën e egër, do t'ua vëmë edhe atyre. Sepse, sikur me statuskuonë të pajtoheshim në cilëndo shkallë, atëherë as që do të flitnim për luftë e revolucion. Në instancën e fundit, revolucion do të thotë më së shumti mospajtim me gjendjen ekzistuese dhe luftë për ndërrimin e saj cilësor.

("BASHKIMI" Nr.1, Janar 1981, faqe 1-2. Këtë artikull ia dërgova faqes pashtriku.org më 25 tetor 2010, por nuk u botua aty. Në bashkëpunim me Faridin Tafallarin u ribotua për herë të parë në www.albaniapress.com, 30 shtator 2011 së bashku me punimin e F. Tafallarit, Kur Jusuf Gërvalla shkruante).

9. "BASHKJETESA" E XHELATIT ME VIKTIMËN

30 vjet nga dalja në skenë e Jusuf Gërvallës

Në rrjedhën e botimit të shkrimeve të Jusuf Gërvallës (me rastin e 30 vjetorit të daljes së tij në skenë), faqja www.pashtriku.org në vijim boton artikullin: "Bashkjetesa" e Xhelatit me viktimën", botuar në nr.4 të gazetës Bashkimi (janar 1981). Në këtë artikull Jusuf Gërvalla, duke ju kundërvënë revistës "NIN" të Beogradit, e cila shtron çështjen e bashkjetesës së popujve të Jugosllavisë në federatën jugosllave, ka theksuar se, për popullin shqiptar "Kjo "bashkjetese" është e dhunshme dhe e paligjshme, sepse viset shqiptare në Kosovë, Dukagjin, Maqedoni, Mal të Zi e në Serbi janë vise shqiptare, që trugut të përbashkët shqiptar iu shkëputën në mënyrë të paligjshme, në kushte të errëta historike dhe kundër vullnetit të popullsisë vendëse shqiptare."

Këto viset të etnikumit shqiptar edhe sot, pas 30 vjetësh janë kështu të ndarë e të copëzuar brenda vetes, madje nuk dallon shumë as gjuha politike e përdorur para 30 vjetësh nga gjuha e sotme politike që përdorin politikanët tanë.

* * *

Jusuf Gërvalla, duke u nisur nga disa premisa të jetës së rëndë ekonomike, politike e shoqëror të popullit shqiptar në Kosovë në raport me popujt tjerë (në shkrim merrë shembullin e mirëqenjes në raport me Slloveninë) konkludon se kjo "bashkjetese", s'është gjë tjetër pos bashkjetesë e xhelatit me viktimën. (Moderatori i pashtriku.org, 26 korrik 2010)

"BASHKJETESA" E XHELATIT ME VIKTIMËN

Nga Jusuf Gërvalla

Revista "NIN" e Beogradit, nëpërmjet intervistash me funksionarë të lartë shtetërorë, nga numri në numër po e shtron çështjen e bashkjetesës së popujve të Jugosllavisë në federatën jugosllave. Natyrisht, ndonëse ky paraqet një hap të çuditshëm të kësaj reviste, pas të cilit mund të supozohet se qëndron kryekëput qeveria dhe i cili sigurisht fsheh ndonjë qëllim tinëzar, s'ka kurrfarë "rreziku" se mund të pyeten popujt e Jugosllavisë sa e duan dhe a e duan fare ata "bashkjetesën". Sa për popullin shqiptar, e sidomos për pararojën e tij patriotike dhe revolucionare, nuk shtrohet fare çështja e bashkjetesës me popujt e tjerë në kuadër të kufijve administrativë të Jugosllavisë. Kjo "bashkjetese" është e dhunshme dhe e paligjshme, sepse viset shqiptare në Kosovë, Dukagjin, Maqedoni, Mal të Zi e në Serbi janë vise shqiptare, që trugut të përbashkët shqiptar iu shkëputën në mënyrë të paligjshme, në kushte të errëta historike dhe kundër vullnetit të popullsisë vendëse shqiptare. Që nga fillimi i këtij akti barbar, të kryer në fillim të shekullit tonë dhe të përsëritur edhe njëherë pas Luftës II botërore nga fuqitë e mëdha e nga forcat më të errëta jugosllave, mbi popullsinë tonë u ushtrua politika e asimilimit dhe e gjenocidit. Dhe që atëherë, politikës së tillë barbare, populli ynë iu përgjegj me një rezistencë të pandërprerë. Aktualisht, rezistenca e fuqishme po spontane e popullit tonë, përditë e më shumë po merr përmasa të një lëvizjeje të organizuar, e cila nesër do të na çojë në luftën e përgjithshme çlirimtare - kombëtare e klasore dhe në bashkimin me vendin amë të shqiptarëve, Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë. Por, për t'iu treguar renegatëve dhe tradhtarëve të mëdhenj e të vegjël shqiptarë të të gjitha ngjyrave, që interesat jetike dhe aspiratat shekullore të popullit të vet i kanë shitur për një kockë të hedhur apo për një pozitë të mjerë në administratën revizioniste jugosllave, këtu

poshtë po nxjerrim disa të dhëna nga premiset e jetës ekonomike, politike e shoqërore, që janë rrjedhim i kësaj "bashkjetese", e cila s'është gjë tjetër pos bashkëjetesë e xhelatit me viktimitën.

KALIFORNIA E VOGËL BANGLADESH I MADH

Po të nisemi nga rezervat natyrore të Kosovës, nga toka e saj cilësore dhe kushtet e favorshme klimatike e gjeografike, Kosova, me një trajtim të barabartë ekonomik, do të kish qenë ndër viset më të zhvilluara në gjithë territorin administrativo-politik të Jugosllavisë. Kosova plotëson 64 % të të gjitha rezervave jugosllave të thëngjill-linjitit, 57 % të rezervave të plumbit dhe zinkut, 24% të rezervave të hekur-nikelit, 30% të të gjithë energjisë elektrike etj. Në Kosovë gjenden gati të gjitha rezervat "jugosllave" të argjendit e të kromit dhe pjesa më e madhe e rezervave të arit.

Për konfiguracionin e saj, raportin shumë të favorshëm të sipërfaqeve të punëshme të tokës ndaj atyre të papunëshme, me një bimësi të dendur etj., Kosova është bërë që moti me një emër të dytë të popullarizuar - Kalifornia e Ballkanit.

Edhe popullsia e Krahinës sonë është jo thjeshtë një popullsi punëdashëse, po njëherit një popullsi, që siç i thonë fjalës, e ka pasur mall punën në plang e shtëpi të vet. Sot vullnetit të madh të kësaj popullsie i është shtuar edhe një potencial i madh i krahut të punës, me një strukturë gjithnjë më të volitshme arsimore, madje me ekspertë gati për të gjithë lëmenjtë e jetës.

Po gjendja e tashme e saj, megjithatë është jashtëzakonisht e mjerueshme. Në saje të politikës diskriminuese e kolonialiste të Jugosllavisë, Krahina jonë ka mbetur regjioni më i pazhvilluar jo vetëm në Jugosllavi, po edhe ndër më të pazhvilluarit në botë. Rezervat natyrore të saj grabiten nga federata jugosllave në trajtë lëndësh të para dhe, pasi të jenë përpunuar në republikat industrialisht më të zhvilluara jugosllave, i shiten Kosovës me çmime të shumëfishuara. Përveç kësaj një rol minus për ekonominë kosovare luan politika diskriminuese e çmimeve. Lëndët e para të Kosovës, në tregun e brendshëm jugosllav shiten me çmime shumë më të ulëta se ato në tregun botëror. Vetë Kosova, prodhimet finale, të përpunuara në republikat e zhvilluara, i blen me çmime deri 124% më të larta se çmimet e tregut botëror.

Në saje të kësaj politike diskriminuese bujqësia e Kosovës, me të cilën është e zënë pjesa më e madhe e popullsisë sonë aktive, ka mbetur në nivelin e një bujqësie ekstensive e me produktivitet jashtëzakonisht të ulët. Toka e punëshme, për shkak të masave të hershme e të vona administrativo-politike që ka marrë Jugosllavia për të bërë presion mbi popullsinë vendëse, është e copëtuar në ngastra shumë të vogla. Në qoftë se në një të kaluar bujqësia siguronte për popullsinë kosovare punëdashëse një ekzistencë solide, ajo sot nuk ka si ta siguroj as kafshatën e gojës për pronarët e saj të imtë.

Ndërkaq, puna në të ashtuquajturin sektor shoqëror, paraqitet edhe më ligisht për shqiptarin e Kosovës. Ky sektor ka një aftësi fare të vogël absorbuese të fuqisë punëtore, gjithsej 6400 punëtorë të inkuadruar në vit (këto 3-4 vitet e fundit). Përballë ritmit të shpejtë në shtimin e krahut të ri të punës, shkalla e punësimit te ne kufizohet me papunësinë totale.

Gjithë kjo ka pasur për pasojë një lëvizje të atillë të popullsisë së aftë për punë, e cila nuk mbahet mend për asnjë periudhë tjetër historike të Kosovës, madje emigrimet e popullsisë sonë thuaja se nuk kanë qenë më masive as në periudhat e shpërnguljeve të mëdha e të dhunshme për në Turqi.

A IA BËJMË KINSE PO BASHKJETOJMË

Për të parë se sa është e arsyeshme, e leverdishme dhe e domosdoshme bashkëjetesa e shqiptarëve me popujt tjerë të mbërthyer brenda kufijve administrativo-politikë të Jugosllavisë revizioniste, po e bëjmë një krahasim të ndarjes së të ardhurave personale të punëtorëve në Republikën e Sllovenisë dhe në Kosovë. Tabela që po e botojmë këtu, është bërë sipas të dhënave të Entit Federativ Statistikor dhe paraqet gjendjen në muajin mars 1979.

Në kohën në shqyrtim, Sllovenia kishte 1 milion e 826 mijë banorë, Kosova po aq, 1 milionë e 600 mijë. Por, në këtë kohë, numri i të inkuadruarëve në Slloveni, 780 mijë, ishte gati 5 herë më i madh se ai në Kosovë (167 mijë - fjala është për sektorin shoqëror). Punëtorët e Sllovenisë realizonin së bashku 5 miliardë e 38 milion e 878 mijë dinarë të rinj kurse ata të Kosovës vetëm 909 milion e 649 mijë dinarë, ose më se 6 herë më pak.

Punëtorët sipas lartësisë së të ardhurave personale*

	SLLOVENIA	KOSOVA
Të ardhurat personale	PUNËTORË	PUNËTORË
Deri në 3 000 dinarë	2 340 ose 0,3%	25 217 ose 15,1%
3 001 - 4 500	111 540 ose 14,3%	72 144 ose 43,2%
4 501 - 6 000	244 140 ose 31,3%	39 579 ose 23,7%
6 001 - 8 000	241 020 ose 30,9%	18 704 ose 11,2%
8 001 - 10 000	104 520 ose 13,45	7 014 ose 4,2%
Mbi 10 000 dinarë	76 440 ose 9,8 %	4 342 ose 2,6%

*mars 1979

Është jashtëzakonisht të shohim se në përqindjeje paraqiten përkatësisht punëtorët e Sllovenisë dhe ata të Kosovës në ndarjen e të ardhurave të ulëta dhe rrogave të larta. Siç shihet edhe nga tabela, sa më e ulët të jetë shkalla e të ardhurave aq më e lartë është përqindja e punëtorëve kosovarë që marrin pjesë në ndarjen e tyre; dhe anasjelltas, sa më shumë të ngjitet shkalla e të ardhurave, aq më i vogël bëhet numri i punëtorëve që marrin pjesë në ndarjen e tyre (në Kosovë) dhe aq më i madh numri i punëtorëve të Sllovenisë, që i gëzojnë ato të ardhura të larta. Konkretisht, paga me lartësi deri në 3000 dinarë marrin vetëm 2340 punëtor sllovenë, ose 0,3% e të të gjithë të inkuadruarëve të kësaj republike, dhe 25217 punëtorë kosovarë, ose 15,1% e të të gjithë të inkuadruarëve të Krahinës sonë. Nga 3000-4500 dinarë marrin 14,3% punëtorë sllovenë dhe 43,2% punëtorë kosovarë; nga 4500-6000 dinarë marrin 31,3% punëtorë sllovenë dhe 23,7% kosovarë; nga 6001-8000 dinarë marrin 30,9% sllovenë dhe 11,2% kosovarë; nga 8001-10000 dinarë 13,4% sllovenë dhe 4,2% kosovarë, dhe, mbi 10000 dinarë 9,8% sllovenë dhe vetëm 2,5% kosovarë.

Kur kësaj t'ia shtojmë edhe faktin se papunësia në Kosovë është 20 herë më e madhe se në Slloveni dhe absolutisht më e madhja në gjithë Jugosllavinë, atëherë bëhet e qartë se bashkëjetesa 68-vjeçare me popujt e Jugosllavisë ka qenë për ne, shqiptarët me banim në Jugosllavi, një nga periudhat tona më të vështira e më të rrezikshme për shfarosje të plotë.

TELALLI THOTË: BESOMË EDHE NË GËNJEFSHA

Revizionistët jugosllavë, këta telallë absurd të "socializmit specifik", "mosangazhimit", "vëllazërim-bashkimit", "barazisë" së kombeve e kombësive, i shtrembërojnë në mënyrë drastike disa fakte vitale karshi opinionit të vendit dhe atij botëror. Ndër të tjera, atyre ua do puna të mos flasin kurrsesi me të dhëna reale kur është fjala për papunësinë në disa vise të caktuara, sidomos në Kosovë.

Sipas kriterëve, me të cilat vlerësohet problemi i papunësisë në shkallë jugosllave, del se numri më i madh i të papunëve është në Maqedoni, po edhe atje vetëm 5,7 për qind. Vendi e dytë e zë Serbia me 4,7 për qind të papunë, ndërkohë që në Kosovë, sipas këtyre kriterëve, as që ekziston problemi i papunësisë! Në Krahinën tonë, gjithnjë sipas këtyre kriterëve, që as "Rilindja" revizioniste nuk durohet pa i quajtur "sa mashtruese, aq edhe joreale", të papunë qenkan vetëm 3,7 për qind.

Ku është nxjerrë vallë ky 3,7 përqindësh famoz?! Ose, edhe përqindja e të papunëve në regjione tjera! Pasi, siç e pranon edhe vetë Enti Federativ i Statistikave, Jugosllavia zë një nga vendet e para në botë për nga shkalla e papunësisë.

Këto "fakte" i kundërshton edhe vetë "Rilindja", duke u mbështetur, siç thotë, "në disa mjete tjera të informimit në Jugosllavi". "Po të vlerësohet papunësia me kriterë reale, shkruan ajo, sipas një analize, del se papunësia në vend është 12 për qind, ndërsa në Kosovë 27 për qind; në Bosnjë e Hercegovinë 13,5 për qind, në Maqedoni 21,3 për qind, në Serbi 11,9 për qind, e të tjera. Papunësia në Slloveni, 1,4 për qind, është njëzet herë më e vogël se ajo në Kosovë".

"Rilindjes" do t'ia dinim për nder sikur pas botimit të kësaj informate të qëndronte edhe më në të njejtën pozitë, atleti i mirë që nuk bien nën rekordin që e ka hedhur një herë. Mirëpo, sado që të dëshirojmë ne, kështu nuk ngjan. Madje, artikulli në fjalë na duket më shumë t'iu ketë përvjedhë redaktorëve, sesa të jetë botuar esëll. Megjithatë, autori i informatës në fjalë, e meriton një përkrahje prej nesh, sado që edhe ai ha ngapak në peshojë.

Ja, pra, disa nga të dhënat për vitin 1978 që na ofron Enti Federativ i Statistikave dhe që na ndihmojnë t'i dalim krah gazetarit të "Rilindjes" dhe të vërtetën që e ka sheshuar ai.

Më 1978, Kosova kishte përafërsisht 1 milion e 525 mijë banorë. 799 mijë, ose 52,4 për qind e popullsisë së përgjithshme ishin banorë të aftë për punë. 167 mijë veta, ose 11 për qind e popullsisë së përgjithshme ishin të inkuadruar në sektorin e ashtuquajtur shoqëror, kurse aktiv në të gjithë sektorët gjithë krahina kishte vetëm 387 mijë vetë, ose 25,4% të popullsisë së përgjithshme. Po t'u besohet këtyre shifrave (më vonë do të shohim kundërthëniet e shumta që dalin prej tyre) atëherë del se më 1978 412 mijë banorë të aftë për punë kanë mbetur të papërfshirë në asnjë sektor të veprimtarisë. Dhe numri 412000 paraqet 27 për qind të popullsisë sonë të përgjithshme (1 milion e 525 mijë), e jo 3,7 për qind!

Përveç kësaj, siç vë në dukje edhe vetë "Rilindja", te ne afro "140 000 vetë për çdo vjet bëhen krah i ri pune". Kurse ekonomia, me aftësinë e mjerë absorbuese të fuqisë punëtore, mund të çelë vende pune vetëm për 6400 vetë në vit (që nga viti 1977 e këtej). Del që, prej katër vjetësh e këtej, ushtrisë së të papunëve në Kosovë i janë shtuar deri më tash edhe nja katër njësite të mëdha me nga 133 600 banorë, që, bashkë me të papunët e vitit 1978, bëjnë jo më pak se 946 400 veta.

Pra në vitin 1981, ne kosovarët po hyjmë me afro 1 milion të papunë!

Në qoftë shtuar më 1980 popullsia e Kosovës sipas parashikimeve të Entit Federativ (se me çfarë saktësie i bënë si parashikimet, mund të shihet edhe nga ky fakt. Në të njejtin publikim, "Kalendari Statistikor i RSFJ 1980", numri real i popullsisë së

Sllovenisë figuron 1 626 000 banorë në vitin 1979, kurse i parashikuar i popullsisë së kësaj republike për vitin 1980, në vend që të jetë më i madh, figuron për 1000 banorë më i vogël, do të thotë - 1 625 000!), pra, në qoftë për t'u besuar këtyre "parashikimeve", atëherë fillimi i 81-shit e zë Kosovën me afro 1 592 000 banorë dhe vetëm me 179 000 të zënë në punë në të ashtuquajturin sektor shoqëror, ose me 11,3% e popullsisë. Një kosovar i zënë me punë në këtë sektor, do të ketë në kurriz mesatarisht 9 banorë (slloveni vetëm 1,7)!

3,7 përqindëshi që paraqitka sipas revizionistëve titistë, shkallën e papunësisë në Kosovë, duke "zëvendësuar" si me shkop magjik 30 përqindëshin, është nxjerrë nga 61000 të papunët që kërkojnë punë nëpërmjet enteve të inkuadrimin. Dhe për këtë numër kapen, si i mbytyri për kashtë, revizionistët, kur duan të na e hedhin syve, neve dhe botës. Mëkot do të ngulë këmbë edhe një pjesë e shtypit revizionist sesi "një numër i madh i kosovarëve të papunë, për shkaqe subjektive e dobësi të ndryshme (ne do të themi për shkak të pritjes së gjatë e të pa shpresë - "Bashkimi"), nuk paraqiten fare në BVI-të gjegjëse". Kjo për ata nuk ka asnjë domethënie. Ata duan që ky numër të përmendet, numrin e saktë e dinë më mirë se ne vetë dhe kënaqen. Por, po vjen dita që kjo kënaqësi t'u mbetet në fyt dhe t'ua zërë frymën.

SHPËRBLIMI I TË KOLONIZUARIT PËR KOLONIZATORIN

Kosovës i kërcënohet rreziku nga një lëvizje e atillë e popullsisë, që pjesa e saj e aftë për punë - strukturalisht më e reja dhe biologjikisht më e shëndosha - të braktisë vendlindjen dhe të marrë masivisht rrugën e hidhur të kurbetit për në republikat e zhvilluara jugosllave, në Evropë e më larg. Në pozitë më të vështirë në këtë pikëpamje janë vetëm edhe viset shqiptare në Maqedoni, Mal të Zi dhe në Serbi, për shkak të kompaktësisë më të vogël etnike të shqiptarëve në strukturën e përgjithshme të popullsisë të këtyre republikave si dhe për shkak të masave edhe më të vështira administrativo-politike, të cilave u ekspozohen vlerat e përmendura shqiptare.

Po t'u drejtohesh statistikave jugosllave lidhur me emigrimet e popullsisë sonë në cilëndo periudhë brenda këtyre 68 vjetëve robëri ato i fshehin faktet si gjarpri këmbët. Ç'është e vërteta, numri 12000 kosovarë të inkuadruar në republikat e Jugosllavisë e në botën e jashtme, nuk ka mundur të fshehet në asnjë mënyrë. Dhe ky numër, edhe po të jetë vetëm kaq, paraqet një shkallë shumë të lartë e të rrezikshme të emigrimit karshi numrit të përgjithshëm të popullsisë së Kosovës, afro 10 për qind të popullsisë së aftë për punë. Por kjo shifër as që i afrohet numrit të vërtetë të kurbetçinjve "modernë" shqiptarë.

"Bashkësia krahinore për inkuadrim përmes enteve të saj të inkuadrimin e mban njëfarë evidence për këta punëtorë, por vetëm për ata që më parë janë paraqitur në këto ente... Mirëpo një numër i madh i fuqisë punëtore punësohet në territoret e tjera të vendit përmes kanaleve të tjera, e sidomos me vetiniciativën e tyre. Prandaj, ky numër i punëtorëve të tillë gjithnjë është më i madh nga ai që evidentohet në entet përkatëse." (Dr. Hivzi Islami, "Popullsia e Kosovës", Prishtinë 1980, f. 123) Një shembull simptomatik lidhur me "objektivitetin" e të dhënave statistikore të këtyre enteve, na e ka dhënë po Dr. H. Islami në veprën e përmendur: "Derisa në vitin 1966 në tërë Slloveninë, sipas evidencës së shërbimeve krahinore të punësimit, ishin 217 punëtorë nga Kosova, vetëm në Lublanë në atë vit ishin të inkuadruar 676 punëtorë nga kjo Krahinë."

Një shtrembërim i tillë i fakteve, me skandalozitetin që përmban në vete, nuk flet për lëshime të rastit, që nganjëherë mund të ndodhin edhe në statistikat më pedante. Përkundrazi, ai na shpie te një mjet sa perfid, aq edhe i preferuar i administratës jugosllave në drejtim të fshehjes së numrit të përgjithshëm të shqiptarëve me banim në Jugosllavi dhe të gjitha të dhënave që e tregojnë në mënyrë reale gjendjen e mjeruar të popullsisë sonë të përfshirë me dhunë brenda kufijve administrativo-politik të këtij armiku të përбетuar të farës sonë.

Këtë shtrembërim faktesh, revizionistët e realizojnë me mjeshtëri edhe në saje të përvojës më të hershme jugosllave në këtë drejtim. Edhe qëllimi kryesor mbetet po ai që ishte para 68 vjetësh; me plane të ngritura në shkallë shtetërore, viseve shqiptare nën pushtetin, viseve shqiptare nën pushtetin administrativo-politik të Jugosllavisë t'u ndërrohet në rrënjë struktura kombëtare. Për këtë qëllim u ndoqën mes dy luftërave botërore dhe pas Luftës II botërore më se 600 mijë shqiptarë dhe në vend të tyre u sollën në këto vise shumë e shumë kolonë të kombësive serbe e malazeze, e tani së fundi po sillen edhe maqedon nga Greqia. Dhe pikërisht për këtë qëllim po u jepet edhe sot rruga e mërgimit "ekonomik" shqiptarëve të robëruar. Ata i mban shpresa se edhe me trojet tjera shqiptare do të ngjajë ashtu siç ka ngjarë me Prespën dhe Ulqinin, banorët e të cilëve, për shkak të presionit ekonomik dhe politik, i kanë braktisur gati përgjithmonë vatrat e veta dhe kanë marrë në sy Amerikën e Australinë.

Natyrisht, është e tepërt dhe gati banale t'u thuhet revizionistëve gjakpirës jugosllav se këto shpresa të tyre nuk janë gjë tjetër pos qep me ujë.

Mbi të gjitha, ndërsa është arritur që ata të pranojnë cilësimin e shpërnguljeve të mëdha për në Turqi si migrime politike, përkatësisht të terrorit dhe të dhunës, ata i propagandojnë migrimet e sotme të shqiptarëve thjeshtë si një dukuri të rëndomtë ekonomike, të parrezikshme, madje edhe të dobishme, duke i lidhur këto migrime me gjoja inkuadrimitin e Jugosllavisë në "ndarjen ndërkombëtare të punës". Po dokrrat e tilla nuk pinë ujë te populli ynë i shumëvuajtur. Pararoja patriotiko-revolucionare e Kosovës dhe e viseve të tjera shqiptare e di mirë se ne, për aq sa është çështje politike - bile e një politike diskriminuese që kufizohet me fashizmin e racizmin - niveli jashtëzakonisht i ulët i zhvillimit ekonomik të viseve shqiptare, aq është politike edhe çështja e emigrimeve të sotme, që janë pasojë e drejtpërdrejtë dhe e domosdoshme e diskriminimit të tillë. Dhe, e gjithë kjo s'është gjë tjetër përveç aplikim i mjeteve të reja "bashkëkohore" për sendërtimin e qëllimeve të vjetra kolonialiste e asimiluese.

Dhe ne, ja ku u premtojmë se do t'i shpërblejmë pikërisht ashtu si i ka hije të kolonizuarit ta shpërblej kolonizatorin: me zjarrin e fuqishëm të dekolonizimit dhe të çlirimit kombëtar. Dhe le ta shqyrtojnë ata vetmevete jerm çështjen se ç'të mira mund të dalin nga "bashkjetesa" që na e ofrojnë në këmbim të lirisë së rrëmbyer.

Marrë nga numri i fundit i gazetës "Bashkimi"
(www.pashtriku.org, 26 korrik 2010)

10. TRADHTARËT E VJETËR DHE TRADHTARËT E RINJ

30 vjet nga dalja në skenë e Jusuf Gërvallës

Në janar 1980, (30 vjetë më parë), në Shtutgart, del në skenën e Teatrit të Dramës së viseve Shqiptare, për të mos u larguar kurrë, Jusuf Gërvalla. Faqja pashtriku.org, kohë pas kohe do të sjellë materiale lidhur me këtë ngjarje. Në fund të korrikut 1981, në adresën e paharruar e të përjetshme, Habichthöhe 40 në Untergruppenbach, Jusufi përgatitë për shtyp numrin 4-5 të revistës Liria. Ky numër i revistës "Liria" shtypet në Shtutgart, dhe nga Habichthöhe nis fluturimin drejt Kosovës. Organizimi i dërgimit në Kosovë bëhet nga Jusufi, i cili me këtë detyrë e ngarkon Haxhi Berishën nga Prapaqani. Përveç Haxhi Berishës në këtë detyrë, angazhohet edhe një person tjetër nga atdhetari Kadri Zeka.

Nga ky numër i Lirisë, zgjodhëm për botim artikullin:

TRADHTARËT E VJETËR DHE TRADHTARËT E RINJ

Nga Jusuf Gërvalla

Çdo pushtues, për të bërë zap popullsinë e pushtuar, rekruton në organet e pushtetit të vet një numër vendësish, të cilët bëhen përçues të politikës, të ideologjisë dhe të urdhrave të atij pushteti.

Nga viti 1912, kur tokat shqiptare në Kosovë e Rrafsh të Dukagjinit, në Maqedoni, Mal të Zi si dhe ato në Serbinë e sotme të ngushtë iu shkëputën padrejtësisht trungut shqiptar dhe hynë nën zgjedhën e egër serbomalazeze, në shërbim të pushtetit të huaj hynë edhe njerëz nga radhët e popullsisë vendëse shqiptare, që nga “poverenikët” më të thjeshtë e deri te deputetët në parlament.

Përfaqësues tipikë të indigjenëve të rekrutuar në aparatet shtetëror të pushtuesve jugosllavë ishin dikur Dragajt e Mitrovicës, Begollët e Pejës, Kryezitë e Gjakovës etj., dhe më pastaj, në aparatet revizionist titist- Fadilj Hodzët, Dzavid Nimanët, Mahmud Bakalët etj.

Në kohën e Jugosllavisë së vjetër kishte ndodhur që populli shqiptar, duke u nisur nga të drejtat formale që garantonte kushtetuta e atëhershme, bënte edhe përpjekje për të zgjedhur përfaqësuesit e vet në organet e pushtetit (rasti i Zef Lush Markut, Lufta e Baranit e 1937-ës) dhe, për ta realizuar këtë të drejtë, ishte përgjakur sa e sa herë me pushtetin shovinist. Ndërkaq, në Jugosllavinë e Titos, pushteti e ka kursyer popullin; ai është kujdesur vetë për njerëzit që do të zgjidhen në organet shtetërore. “Poverenikët” dhe deputetët shqiptarë në “parlamentin” titist i gjejmë në një pozitë më të mirë se ata në Jugosllavinë mbretërore; këta s’kanë nevojë as të luajnë veshin për të bërë çka don për popullin në mënyrë që të fitojë simpatinë e tij. Mjafton që t’u përgjigjen kërkesave të pushtuesit dhe e kanë të siguruar kolltukun e butë. Vullneti i popullit përjashtohet fare, sepse, në vendet udhëheqëse (qoftë edhe për një drejtor të thjeshtë) funksionarët nuk zgjidhen , por emërohen nga forumet e larta lokale dhe qendrore. Pasi t’i ketë zgjedhur për qejfi, pushteti i quan këta njerëz – përfaqësues të popullit. Po edhe populli, logjikisht, ata i quan – tradhtarë të popullit. Sepse, sipas praktikës së deritanishme, është dashur të japësh provime të shumta të gatishmërisë për të bërë politikë antishqiptare, ani pastaj të të emërojë pushteti në ndonjë organ lokal apo qendror.

S’ka tjetër emër për këta sahanlëpirës që i shërbyen me besnikërinë e qenit, jo popullit, nga gjiri i të cilit kanë dalë, po regjimit të egër antipopullor e antishqiptar, te i

cili janë shitur badihava. Ata u bënë thjeshtë një vegël e verbër në realizimin e politikës shoviniste dhe të gjenocidit mbi shqiptarët.

Me pajtimin e plotë të këtyre tradhtarëve u masakrua, më 1945, popullsia shqiptare në Drenicë e Gjilan, në Tetovë e gjetkë. Me heshtjen e tyre aprovuese u likuiduan dhjetëra mijëra partizanë shqiptarë në Tivar, në Srem e Slloveni, ku kishin vajtur për t'u dalë në ndihmë popujve fqinjë jugosllavë në dëbimin e çizmes fashiste. "Poverenikët" dhe funksionarët titistë ishin kokë e këmbë të pranishëm kur u shkel me të dy këmbët vullneti i popullit shqiptar në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare, i shprehur në Rezolutën e Konferencës së Bujanit, më 1943, e cila shqiptarëve u garantonte të drejtën për vetëvendosje deri në shkëputje dhe bashkimin me vendin amë, Shqipërinë, e që ishte aspiratë e natyrshme shekullore e popullit tonë të martirizuar. Në vend që të viheshin me guxim në ballë të popullit tonë të shkretë e të dërmuar luftërash, masakrimesh e skamjeje, t'i prinin atij në rrugën e mëtejshme të çlirimit kombëtar dhe klasor (kur Jugosllavia shkeli të drejtat e premtuara, për të cilat populli ynë pat derdhur pa kursim gjakun e bijve të vet të shtrenjtë), tradhtarët Fadilj Hodza e Dzavid Nimani me shokë, parapëlqyen qyqarinë dhe pajtimin në heshtje me të gjitha të zezat që kishte përgatitur për shqiptarët klika titiste. Ata ishin këtu edhe kur zbriti dhe u shkel për më se 20 vjet flamuri shqiptar. (të verbërit: Pse edhe ata nuk kërkuan të ndaloheshin flamujt e kombeve të tjera në Jugosllavi – në emër të "internacionalizmit proletar" – siç bënë jugosllavët me shkabën tonë dykrenare?!) Ata nuk paraqitën kundërshtimin më të vogël as më 1947, ku u zbrazën drithnikët e Kosovës dhe populli ynë i uritur u detyrua të ushqej me barishte, se kopallat e demagogjitë revizioniste nuk jepnin bukë. Për më tepër, tradhtari Xhevdet Hamza u ndodh në krye të detyrës për realizimin e aksionit famëkeq të armëve, më 1956, kur populli shqiptar u masakrua, kur dinjiteti i popullit tonë u kërcënua të ulej deri në baltë nga zullumet e gjakpirësve titistë-rankoviçistë. Qyqarinë e tyre nuk e preku as vajtimi i djepeve shqiptare, loti i nënave as malli i burrave shqiptarë, që u dëbuan nga vatrë stërgjyshore dhe morën në sy shkretëtirat e Anadollit. Tradhtarët ishin gjithnjë këtu, të pranishëm kudo, si biberi në tavë dhe bënin jetën e tyre të rehatshme në kushtet e "vëllazërim-bashkimit" të xhelatit me viktimën. Dhe për këtë merrnin shpërblim racionin e turpshëm prej sahanlëpirësish; së pari në triska të majme për ushqim e veshmbathje, pastaj në shtëpi të mëdha e apartamente, e më pastaj në vila e vetura.

Kur krimet individuale e masive të ushtruara nga klika titiste mbi popullin tonë, s'e prekën dot atë lëkurë bualli-mamuth të renegatëve shqiptarë, marrëzia më e madhe është të pritësh prej tyre që të preken nga pabarazitë ekonomike, shoqërore e kulturore nën regjimin titist. Në qoftë se të ardhurat kombëtare në Kosovë janë gjashtë herë më të vogla se ato në Slloveni, kurse zhvillimi i Kosovës bëhet me një ritëm 106 për qind në zotimet e jugosllavëve, në qoftë se papunësia te ne është njëzet herë më e madhe se ajo në Slloveni dhe krahu i lirë i punës derdhet varë-darë nga Kosova nëpër republikat e Jugosllavisë dhe në shtetet Perëndimore. Në qoftë se në Kosovë punohet në zhvillimin e një industrie nxjerrëse, që e pasuron Beogradin dhe jo të një industrie përpunuese – që do të pasuronte Kosovën, nëse fshatarësia kosovare është varfëruar deri në kufirin e zisë së bukës dhe rënkton në kushtet e një jete asociale, në qoftë se gruaja shqiptare ka mbetur edhe në fund të shekullit XX në errësirën mesjetare, e diskriminuar nga aspekti shoqëror dhe familjar, në qoftë se, më në fund, ky mjerim përjetohet në përmasa të shumëfishuara në viset shqiptare në Maqedoni, Serbi e Mal të Zi, ç'kanë të bëjnë të gjitha këto me renegatët shqiptarë!!! Ata e kanë kolltukun e tyre, kanë pallatet dhe veturat, kanë rrogat e tyre të majme, si gjithë funksionarët dhe borgjezia jugosllave. Dhe, mbi të gjitha – nëse popullit i ka ardhur shpirti në fyt dhe ngre zërin e tij të fuqishëm për të kërkuar bukë, të drejta e liri, kushte të njëjta a të përafërta me popujt e tjerë të mozaikut jugosllav, me të cilët e lidhin "vëllazërimi" e "bashkimi" – tradhtarët e kanë në dorë milicinë dhe ushtrinë.

Natyrisht, jo për të për të përkrahur interesat e kërkesat e popullit, po për t'i shtypur në gjak ato. Dhe, kur të mos u mjaftojnë milicia e ushtria e stacionuar në tokat shqiptare të robëruara, ata mund ta thërrasin edhe milicinë dhe ushtrinë e Beogradit. E dinë se, për të bërë zap shqiptarët, Beogradi nuk kursen ushtri as milici. Tanke as avionë. Helikopterë as municion.

Kjo gjë, ç'është e vërteta, dihej mirëfilli. Ishte parë në ngjarjet e 1945-ës e në ato të 1968-ës. U pa edhe në tragjedinë më të re të Kosovës, në mars e prill.

Por, nuk dihej një gjë tjetër. Megjithë besnikërinë e tyre të pashoqe ndaj Beogradit, tradhtarët shqiptarë si Dzavid e Mahmudi, a e meritonin ata që Beogradi t'i nxirrte në rrugën e madhe? Dyzet vjet luftë antishqiptare të shkurtabiqit-bullafiq Dzavid Nimani nuk i siguruan atij as një pensionim të rehatshëm nga gospodari! Si qen i zgjebosur e i shogur i stanit, të cilit i janë rralluar të lehurat dhe i është dobësuar nuhatja, ai u detyrua të lërë stanin e kaçorren, të lërë koritën dhe qullin e përbashkët me qentë e tjerë të gospodarit. Ç'mund të bënte për Beogradin më shumë seç ka bërë, i shkreti Dzavid! Stazhi më se 10 vjeçar i shërbimit të Mahmudit që vërtet më i shkurtër, po ky ishte një qen me dresurë dhe shërbimi i tij – shumë më intensiv e efektiv. Megjithatë, edhe Mahmudin e hodhi në shportë Beogradi si lëvoren e limonit të shtrydhur.

Po pse?

Edhe budalla e di se ajo që kërkon aktualisht prej tyre Beogradi, nuk është më fare në mundësinë e tyre. Populli i robëruar shqiptar kishte nevojë të madhe t'ia qanin hallet e t'ia mjekonin plagët e mëdha, që ishin pezmatuar sa s'bën më. Kurse Beogradi kërkon që renegatët shqiptarë t'i flasin këtij populli ashtu si i kanë folur që 40 vjet, me demagogji, frikësime e shantazhe, Kërkon që ata të injektojnë edhe më në popullin shqiptar po ato mendime që kanë Beogradi, Mahmudi e Fadilji. Por, kjo është e kotë. Aq e kotë, sa do të kish qenë e kotë sikur shqiptarët të kërkonin nga Beogradi që ky t'ua japë falas ato të drejta e liri, të cilat s'fitohen veçse me luftë këmbëngulëse e me gjak.

Duhet të jesh i verbër fare nëse nuk sheh se s'qitet më në krye me shqiptarin. Ka ndodhur diçka e re me të. Ai gjithmonë e ka urryer regjimin antipopullor jugosllav, i cili mban nën thundrën e vet të përgjakshme edhe popujt e tjerë të këtij mozaiku artificial, por dëmton veçanërisht shqiptarin. Po sot kjo urrejtje ka dalë haptazi dhe është bërë mur i pakapërcyeshëm për pushtuesin dhe tradhtarët e vendit. Në ngjarjet e marsit e të prillit, populli ynë tha njëherë dhe përfundimisht: Jo! Kjo i kushtoi gjak. Ndërmjet nesh dhe qeverisë së Beogradit tani ka hyrë gjaku i bijve të shtrenjtë të popullit tonë. Dhe ky gjak është ai që i fshin të gjitha perspektivat e kthimit në gjendjen e mëparshme. Beogradi kërcënohet haptazi me gjakderdhje të re. Por s'i bën dobi. "Zemra jonë ka gjak sa gurra". Dhe mbi gjakun e derdhur forcohen edhe më shumë themelet e vetëdijes kombëtare e klasore të shqiptarit të robëruar. Ndjenja e fuqishme e lirisë e ka bashkuar popullin tonë trim si një trup të vetëm. Me tanket e aeroplanët, me helikopterët e mitralozët, me ushtrinë e milicinë speciale, Beogradi s'bëri gjë tjetër pos që dogji etapat e luftës sonë të pashmangshme dhe na ndihmoi shumë në afrimin sa më të shpejtë kah dita e fitores së sigurt.

E di mirë Beogradi se nuk gjendet dot ilaç për ta shëruar te populli ynë kujtimin e vrasjeve e të plagosjeve, as akullin e burgjeve të kësaj pranvere.

Por, këtë sikur nuk po e dinë ca tradhtarë të rinj që pushteti i ka futur në lojë si kartën e fundit. Kryesia e Serbisë e pat thënë që në fillim të prillit se disa udhëheqës vasalë kosovarë si Fadilji, Dzavidi e Mahmudi "janë të pjekur për t'u larguar nga skena politike". Kjo i gjeti tashmë Dzavidin e Mahmudin, pritjet të gjejë edhe Fadiljin. Nga ana tjetër, kur populli shqiptar shtroi çështjen e republikës së federuar të Kosovës, ishte e vetëkuptueshme që, kur të shpallej republika, nga postet e tyre duhej të binin dhe të merrnin nga populli dënimin e merituar të gjithë ata udhëheqës e kriminelë kosovarë e

jugosllavë, që aprovuan apo urdhëruan gjakderdhjen në Kosovë. (Si mund të jetojë shqiptari nën shkopin dirigjues të atij që i vrau, i plagosi e i burgosi bijtë më të shtrenjtë?) Tani plaga po pezmatohet gjithnjë e më shumë, sepse Beogradi, i vetëdijshëm për krimet e deritanishme dhe për rrugën e krimeve më të mëdha që ka ndër mend, emëroi në vende kyçe të pushtetit krahinor renegatë të rinj shqiptarë me kondicion edhe më të madh për tradhti të reja. Garnitura e vjetër e tradhtarëve të urryer u zëvendësua këmbadoras me një garniturë findo të re tradhtarësh që çirren si të flamosur, duke pandehur se do ta frikësojnë e ta përulin një popull që kurrë s'është përulur, e përulet aq më pak sot që ka vendosur të luftojë pa u zbrapsur për të drejtat dhe liritë e veta.

Tash që s'ka bukë, dhe shteti ka hartuar plane për një "otkup" të ri, këta renegatë të rinj thërresin: "Mirëqenia", "Begatia"! Kur populli kërkon me të drejtë, republikën që e kanë të gjithë popujt e tjerë të Jugosllavisë, ata thërresin: "E kemi republikën – Serbinë". Kur begatitë tona plaçkiten pa mëshirë dhe marrin rrugën e Beogradit, ata thërresin: "Vëllazërim-bashkim"! Kur ushtria e milicia fashiste mbulojnë në gjak Kosovën, duke shkelur mbi popullsinë e pambrojtur, ata çirren: "Të distancohemi nga nacionalistët, shovinistët, reaksionarët e kundërrevolucionarët shqiptarë, që duan të rrezikojnë revolucionin dhe integritetin territorial të Jugosllavisë"! Me një fjalë, ata thërresin si qyqarët më të mëdhenj të kësaj bote për një nënshtrim akoma më të madh të popullit tonë, për t'u pajtuar me humbjen edhe atyre pak të drejtave formale që kishin deri më tash në Serbinë. Ata e thërresin kështu popullin shqiptar që ky, me sy në ballë, t'ia hapë vetvetes me duart e veta varrin e sigurt.

Ku e shohin vallë perspektivën këta renegatë të rinj? Ata s'e kanë as përvojën e paraardhësve të tyre, e kushtet kur u ngjiten në skenë janë pakrahasueshëm më të ndërlikuara se ato kur mbretëronin renegatët e vjetër. . Për pushtuesit jugosllavë, shërbime më të mëdha se Fadilji, Dzavidi e Mahmudi nuk mund që nuk mund të bëjnë. Kurse populli shqiptar jo vetëm nuk po frikësohet nga shantazhet e tyre, po përditë po i konsolidon më shumë radhët e veta, po e forcon frontin e luftës e të hakmarrjes së madhe popullore.

U mbetet një mundësi e vetme tradhtarëve të çirren e të përpëliten si peshku në zall, e kur t'i shtrydhë deri në fund pushtuesi e t'i hedhë në rrugë, atje t'i presë dora hakmarrëse e popullit.

Të mjerët tradhtarë, ç'po u përgatit populli!

"Liria" nr.4-5 gusht 1981, faqe 12 dhe 17 (www.pashtriku.org, 2 prill 2010)

11. JUSUF GËRVALLA DHE ROMANI I TIJ "RROTULL"

(Me rastin e 63 vjetorit të lindjes së Jusuf Gërvallës, në pashtriku.org)

Në mbarim të vitit 1981 në panairin ndërkombëtar të librit në Frankfurt të Gjermanisë Perëndimore, pata rastin të takoj për herë të parë e të fundit shkrimtarin, gazetarin dhe personalitetin e shquar të Kosovës, Jusuf Gërvallën. Erdhi te stenda e librit shqiptar së bashku me të vëllanë një ditë shiu, pa rënë fare në sy, midis dhjetëra vizitorëve. Trupmesatar, gjysmëbiond ai kishte në tërë qenien e tij atë lloj thjeshtësie dhe paraqitjeje të zakonshme, pas të cilës ndihet menjëherë thellësia dhe e pazakonshmja.

Biseduam gjatë atë ditë midis rrëmujës së panairit dhe pastaj më gjatë në mbrëmje në një kafe të qytetit. Poet, prozator, publicist militant, Jusuf Gërvalla kishte të gjitha

cilësitë dhe dimensionet që e bëjnë të shquar një personalitet të letrave e të kulturës. Për fat të keq mundësitë e tij mbetën të pashprehura plotësisht.

Pak kohë më vonë, në natën e errët të 17 janarit 1982, ai bashkë me të vëllanë u vranë në Untergruppenbach në afërsi të Shtutgartit të Gjermanisë Perëndimore nga plumbat e armiqve të kombit shqiptar, duke shtuar kështu numrin e martirëve të këtij kombi. Vrasja e Jusuf Gërvallës ndërpreu, veç të tjerash, një nga krijimtaritë më origjinale e me kolorit të letrave shqipe.

Romani "Rrotull" që lexuesi ynë e merr në dorë sot, është përpjekja e parë e Jusuf Gërvallës në prozën e gjatë. I shkruar në traditën e rrëfimit popullor dhe duke shfrytëzuar arketipat e letërsisë orale shqiptare, ky roman është nisja e një rruge që mbeti, në fillimet e saj.

Duke përshtuar mjedise të fshatit kosovar, tipa dhe ngjarje të ndryshme, autori ka prekur plagë të ndjeshme të atij realiteti, siç janë varfëria, kurbeti, mentalitetet prapanike etj.

Krijimtaria letrare e Jusuf Gërvallës, poezitë e tij, si dhe proza artistike e publicistika përbëjnë një kontribut të rëndësishëm në rrugën e zhvillimit të artit e të mendimit shqiptar.

Ismail Kadare

Ky shkrim është si parathënie e romanit "Rrotull" që për herë të parë u botua në Tiranë më 1983 nga Shtëpia Botuese "Naim Frashëri". Këtë botim e ilustroi me njëmbëdhjetë punime Piktori i Popullit - Abdurrahman Buza. (www.pashtriku.org, 12 shtator 2008)

12. SI U DENUAN SHABAN KLAIQI E ISLAM RAFUNA PËR ZËRIN E KOSOVËS

Ekskluzivisht për pashtriku.org

Shaban Klaiqi e Islam Rafuna - bartësit e parë të Stafetës së Flakës së Janarit

Në nëntor të vitit 1981 Jusuf Gërvalla boton numrin e parë të "Zërit të Kosovës" si organ i "Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve tjera shqiptare në Jugosllavi". Në diskutimet se si të dërgohet ky numër në Kosovë, Shaban Klaiqi nga fshati Poliçkë i Komunës së Dardanës dhe Islam Rafuna nga e njëjta komunë, e marrin për detyrë nga Jusuf Gërvalla që gazetën e tij ta fusin në Slloveni deri në një vend të caktuar. Gjatë kryerjes së kësaj detyre arrestohen nga policia jugosllave dhe më 3 korrik 1982, dënohen me nga 3 vjet burg, nga Gjykata e Qarkut të Gjilanit.

Të njejtin dënim ua shqipton Gjykata Supreme e Kosovës, më 17 janar 1983, pikërisht në njëvjetorin e vrasjes së Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe Kadri Zekës. Në këtë mënyrë Shaban Klaiqi dhe Islam Rafuna bëhen bartësit e parë të Stafetës së Flakës së Janarit, e janareve që do të vinin më pas. Për Shaban Klaiqin e Islam Rafunën, për këta dy punëtorë të guximshëm të rrethit të Shtutgartit, që kanë bërë e sakrifikuar shumë për Jusuf Gërvallën, për tokën e për qiellin e Kosovës, është folur pak apo gati aspak.

Për burgosjen e veprimtarëve Shaban Klaiqi dhe Islam Rafuna, Jusuf Gërvalla përmes një letre ka informuar edhe bashkëveprimtarin e organizatës LNÇKVSHJ z.Sabri Novosella, i cili asokohe ishte strehuar në Turqi. Jusufi këtë letër e ka shkruar më 14 janar 1982, vetëm tri ditë para vrasjes në Untergruppenbach të Gjermanisë (më 17 janar 1982).

Në letrën dërguar S. Novosellës, Jusufi ka shkruar:

"Siç e di, ne kemi pas bërë këndeje njëfarë transporti të shtypit. E kemi futur atë në Atdhe, por atje s'i kemi pasur njerëzit që do ta shpërndanin si duhet. Tani, në drejtimin e transportit, kemi pësuar më në fund edhe një disfatë. Me numrin 1 të "Z.K." dërguam për në Atdhe dy punëtorë. Rruga e futjes së materialit ishte po ajo që kishim ndjekur në tri raste të suksesshme të transportit. Por kësaj radhe puna dështoi dhe ata dy punëtorët ndodhen në duartë e UDB'së. Pas kësaj e kemi shumë vështirë të ndjekim të njejtën rrugë. Tani a ta qajmë materialin që nuk ra në duartë e lexuesit, apo të qajmë njerëzit që na u dëmtuan. Aktualisht s'po i bëjmë ballë dot t'u japim rrugë. Është disfata e parë kësodore që dy vjet e këtej dhe na ka demoralizuar shumë. Sa patëm zënë të kënaqemi e të marrim krah nga materialet që po na arrinin për revistën, tash u desh të na dilte ky problem." (Jusuf Gërvalla, 14 janr 1982)

Me rastin e 28 vjetorit të vrasjes së Jusufit, Bardhoshit e Kadriut, në faqen www.pashtriku.org, për herë të parë publikojmë aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës - datë 17 janar 1983, ku shpërfaqet veprimtaria e Shaban Klaiqit dhe Islam Rafunës. Le të jetë ky një satisfaksion sado i vogël për z.Klaiqi dhe z.Rafuna. Veprimtari Shaban Klaiqi burgoset edhe në vitin 1989. Ai arrestohet me vendim të Sekretariatit Krahinor për Punë të Brendshme nr.330/1, datë 28. 03. 1989, të nënshkruar nga kryeudbashi i Kosovës Jusuf Karakushi, dhe për dy muaj rresht (deri më 25. 05. 1989) përjeton masën e izolimit nëpër kazamatet serbe. (Pashtriku.org, 10. 01. 2010)

* * *

Ap - Kzh. nr. 372/82

N Ë E M Ë R T Ë P O P U L L I T

Gjykata Supreme e Kosovës - kolegji i përbërë nga kryetari i gjykatës Riza Fazlija dhe gjyqtarët: Tadej Rodiqi, Aqif Tuhina, Durmish Koqinaj dhe Halil Halilaj, anëtarë, me bashkëpunëtoreshen profesionale Milica Smajli, procesmbajtëse, në çështjen penale të të akuzuarve Shaban Klaiqi dhe Islam Rafuna, për veprën penale të pjesëmarrjes në veprimtari armiqësore, të parashikuar nga neni 131 të LP të RSFJ, të kryer si bashkekzekutorë, duke vendosur përkitazi me ankesën e prokurorit publik të qarkut dhe ankesën e mbrojtësit të të akuzuarve Zhivana Bersavleviq, paraqitur kundër aktgjykimit P-nr. 34/82 datë 3 korrik 1982 të Gjykatës së Qarkut të Gjilanit, në seancën jopublike të mbajtur më 17 janar 1983, zëvendësprokurori publik krahinor Ndue Selmani, mori këtë

A K T G J Y K I M

Në rastin e ankesës së prokurorit publik dhe ankesës së mbrojtëses së të akuzuarve, e sipas detyrës zyrtare, aktgjykimi P-nr. 34/82 datë 3 korrik 1982 i Gjykatës së Qarkut të Gjilanit ndryshohet sa i përket zbatimit të ligjit penal, kështu që Gjykata Supreme konstaton se në veprimet e të akuzuarve Shaban Klaiqi dhe Islam Rafuna qëndrojnë elementet e veprës penale të propagandës armiqësore, të parashikuar nga neni 133 par. 3 të LP të RSFJ.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin P - nr. 34/82 datë 3 korrik 1982, Gjykata e Qarkut të Gjilanit i ka shpallur fajtorë të akuzuarit Shaban Klaiqi dhe Islam Rafuna për veprën penale të propagandës armiqësore, të parashikuar nga neni 133 par. 1 të LP të RSFJ dhe i ka dënuar me nga tri vjet burgim, duke i detyruar edhe t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor prej 1000 dinarësh.

Kundër këtij aktgjykimi ankesa brenda afatit kanë bërë:

- prokurori publik, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënimin, duke propozuar që aktgjykimi të ndryshohet dhe të akuzuarit të shpallen fajtorë për veprën penale të pjesëmarrjes në veprimtari armiqësore, të parashikuar nga neni 131 të LP të RSFJ dhe të dënohen më ashpër;

- mbrojtësja, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe të mangët të gjendjes faktike dhe për shkak të vendimit për dënimin, duke propozuar që aktgjykimi i shkallës së parë të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i jepet një dënim më i lehtë. Ajo njëkohësisht iu përgjegj edhe ankesës së prokurorit publik dhe propozoj që kjo të refuzohet si e pabazuar.

Zëvendësprokurori publik krahinor Ndue Selmani deklaroi se qëndron prapa propozimit me shkrim që të akuzuarit të shpallen fajtor për veprën penale të parashikuar nga neni 131 të LP të RSFJ, për të cilën t'u jepen dënime të merituar, ndërsa ankesa e mbrojtësit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme shqyrtoi shkresat e lëndës, ekzaminoi aktgjykimin sipas nenit 376 par. 1 të LPP, vlerësoi pretendimet ankimore dhe konstatoi se ankesat janë të pabazuara.

Gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar drejt gjendjen faktike, duke konstatuar se të akuzuarit, gjatë vitit 1981 gjatë kohës që ndodheshin me punë në RF të Gjermanisë, më sakt në firmën "Daimler Benz" në Sindelfingen, u morën me veprimtari armiqësore kundër vendit tonë, ashtu që u inkuadruan në demonstratat armiqësore të mbajtura në Zurich, në Gjenevë, në Shtutgart dhe në Munih, kurse i akuzuari Islam Rafuna e voziti Nuhi Sylejmanin me veturën e vetë për të shpërndarë thirrje për demonstratat; që të dy këta, në nëntor të po atij viti, së bashku me të tjerët hodhën parullën "Kosova-Republikë" kurse me anë të fishkëllimave ndërpre në koncertin e RTP'së, që ishte organizuar për nder të Ditës së Republikës, kurse më 13 dhjetor 1981 nga Nuhi Sylejmani morën në dorëzim 1000 ekzemplarë të "Zërit të Kosovës", botim i organizatës armiqësore në emigrim "Fronti i Kuq" dhe u përpoqën që ata t'i sjellin në RSFJ, por më 14 dhjetor 1981 u zunë nga milicët e postkomandës së milicisë së hekurudhës të Lublanës.

Këtë gjendje faktike gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar në radhë të parë në mbështetje të deponimeve të të akuzuarve. Ata gjatë hetimeve pranuan se morën pjesë në demonstratat armiqësore, duke mohuar i akuzuari Shaban Klaiqi pjesëmarrjen në demonstratat e Gjenevës, kurse i akuzuari Islam Rafuna, pjesëmarrjen në demonstratat e Munihut. Me atë rast që të dy këta deklaruan se nuk kishin pasur dijeni që demonstratat të ken qenë të organizuara nga organizata armiqësore në emigrim "Fronti i Kuq", porse shkuan për të marrë pjesë mbasi ishin ftuar me thirrje që i kishin marrë, i pari tek porta e banesës së vet, kurse i dyti nga Nuhi Sylejmani.

Për pjesëmarrjen e të akuzuarit Shaban Klaiqi në demonstratat e zhvilluara në Shtutgart dhe në Munih në shkresa ndodhen edhe fotografitë e tij.

Për këto arsye dalin të pabazuara pretendimet ankimore të mbrojtëses se i akuzuari Shaban Klaiqi "kishte shkuar të interesohej të gjente punë për të vëllan" e se i akuzuari Islam Rafuna, ndonëse shoqërohej me Nuhi Sylejmanin, nuk mori pjesë në asnjërën nga demonstratat e zhvilluara.

I akuzuari Islam Rafuna deklaroi në seancën kryesore se para demonstratave të zhvilluara në Shtuttgart e kishte vozitur Nuhi Sylejmanin deri në Grubingen dhe ai kishte një çantë me vete, por ky nuk e dinte se ç'kishte brenda. Mirëpo, nisur nga deklarata e të akuzuarit se ky edhe më parë i ishte përgjegjur disa herë kërkesës së Nuhi Sylejmanit, të cilit i kishte dhënë veturën dhe e kishte vozitur vet tri herë, duke supozuar se këto udhëtime kishin lidhje me demonstrata, mund të përfundohet se ai kishte dijeni se në çantë ndodheshin thirrjet për të marrë pjesë në demonstrata, të cilat i shpërndau Nuhiu. Lidhur me këtë gjykata e shkallës së parë përmban arsye bindëse, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë.

Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se koncerti i RTP'së, me rastin e Ditës së Republikës, që ndërprerë në fillim të tij, për shkak se spektatorët, ndër të cilët edhe i akuzuari, filluan të hedhin parullën armiqësore "Kosova-Republikë!", dhe duke fishkëlluar, gjë që çoi në intervenimin e policisë Gjermane.

I akuzuari Shaban Klaiqi u mbrojt gjatë gjithë procedurës se nuk kishte marrë pjesë në futjen ilegale të revistës "Zëri i Kosovës" në RSFJ dhe se të akuzuarin Islam Rafuna e njohu për herë të parë në Postkomandën e Milicisë së Lubjanës.

Mirëpo, sipas deklaratës së të akuzuarit Islam Rafuna, këta të dy, duke mbartur valixhen dhe çantën ku ndodhej materiali që e kishin marrë prej Nuhi Sylejmanit, ishin nisur së bashku nga RF e Gjermanisë, duke i respektuar udhëzimet e pranuar.

Në bazë të këtyre rrethanave e duke pasur parasysh faktin se i akuzuari Islam pikërisht nën ndikimin e Nuhi Sylejmanit filloi të merret me veprimtari armiqësore kundër vendit tonë, mund të përfundohet se të akuzuarit e kishin të ditur se për çfarë materiali ishte fjala. Këtë konkluzion e përforcon edhe fakti se të akuzuarit, gjatë udhëtimit, ndërronin trenat, kurse për të hyrë në vendin tonë zgjodhën trenin që shkonte për në Kardelevë, që kontrollohet më pak, në krahasim me trenat që shkojnë drejt Kosovës.

Për këto arsye mund të konstatohet se mbrojtësja e të akuzuarve e kundërshton aktgjykimin pa baza për shkak të vërtetimit të gabuar e të mangët të gjendjes faktike.

Nisur nga gjendja faktike e vërtetuar, Gjykata Supreme vlerësoi se gjykata e shkallës së parë mbi këtë gjendje ka zbatuar gabimisht ligjin penal, duke i shpallur fajtorë të akuzuarit për veprën penale të propagandës armiqësore të parashikuar nga neni 133 par. 1 të LP të RSFJ.

Qëndron fakti se të akuzuarit, me veprimtarinë e tyre, sulmuan ato vlera shoqërore që janë nën mbrojtjen e dispozitës së nenit 133 par 1 të LP të RSFJ. Mirëpo në këtë rast nuk është kontestues as fakti se të akuzuarit tentuan të futin revistën në fjalë në RSFJ nga një vend i huaj, nga RF e Gjermanisë, në të cilën, siç u tha edhe më sipër, morën pjesë në demonstratat armiqësore dhe në pengimin e koncertit të RTP-së, kurse i akuzuari Islam Rafuna edhe në vozitjen e Nuhi Sylejmanit për të shpërndarë thirrjet për demonstratat e zhvilluara në Shtuttgart.

Revista "Zëri i Kosovës" i organizatës armiqësore emigrante "Fronti i Kuq" dhe ajo përmban shkrime me karakter propagandues armiqësor kundër bazave të shoqërisë vetëqeverisëse socialiste dhe rendit e sigurisë së RSFJ.

Prandaj, në veprimet e të akuzuarve, sipas konstatimit të kësaj gjykate, qëndrojnë elementet e veprës penale të propagandës armiqësore, të parashikuar nga neni 133 par. 3 të LP të RSFJ.

Për këtë arsye del i pabazuar pretendimi i prokurorit publik se me veprimet e sipërme të akuzuarit kanë kryer veprën penale të parashikuar nga neni 131 të LP të RSFJ. Kjo vepër penale i ka dy forma kryesore: hyrjen në lidhje me një shtet të huaj ose

emigrante ose me një grup njerëzish, dhe ofrimi i ndihmës për kryerjen e veprim- tarisë armiqësore.

Në rastin konkret nuk është provuar që të akuzuarit kanë qenë anëtarë të organizatës armiqësore “Fronti i Kuq”, që të kenë pasur dijeni që kjo organizatë t’i ketë organizuar demonstratat dhe që njëri nga udhëheqësit e saj të jetë i përmenduri Nuhi Sylejmani, si dhe që të kenë njohur vëllezërit Gërvalla.

Mbasi nuk është provuar që të akuzuarit të kenë hyrë në lidhje me organizatën armiqësore të përmendur dhe me udhëheqësit e saj dhe, siç u tha edhe më tepër, mbasi këta kryen veprimet e përshkruara në paragrafin 3 të nenit 133 të LP të RSFJ, nuk mund të pranohet pretendimi i prokurorit se në veprimet e tyre qëndrojnë elementet e veprës penale të parashikuar nga neni 131 të LP të RSFJ.

Vendimin për dënimin e kundërshtojnë si të pa baza si prokurori publik, ashtu edhe mbrojtësja e të akuzuarve.

Duke u dhënë të akuzuarëve dënimin me nga tri vjet burgim, gjykata e shkallës së parë u njohu atyre si rrethana lehtësuese: pagjykueshmërinë e mëparshme, qëndrimin e mirë para gjykatës dhe gjendjen familjare. Dënimi i dhënë sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, i përgjigjet peshës së veprës dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të akuzuarve dhe si i tillë ai është i domosdoshëm që të arrihet qëllimi i dënimit, i parashikuar nga dispozita e nenit 33 të LP të RSFJ.

Nga sa u parashtrua dhe në mbështetje të nenit 387 par. 1 të LPP u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISIHTINË

Ap - Kzh. nr. 372/82 **Më 17 janar 1983**

Procesmbajtëse
Milica Smajli

Kryetar i kolegjit
Riza Fazlija

(www.pashtriku.org, 10 janar 2010)

13. BALADË PËR VDEKJEN E JUSUF GËRVALLËS

Ismail Kadare

I

Spitali i ri i qytetit të vogël Untergruppenbah (ai në të cilin dhjetë muaj më vonë, pikërisht në një ditë të ngjashme do të vdiste J.G.) u përrua në mbarim të dimrit. Ishte ftohtë dhe kishte ende dëborë të pashkrirë në kopshtin dhe rrethojën prej kangjellash të hekurta. Bardhësinë e saj, sidomos në ato vende ku ajo kontrastonte me tokën e zezë, kronisti i TV e shfrytëzoi me mjeshtëri në marrjet e tij duke e gërshtuar me kontrastin që krijojnë përparset e bardha të personelit shëndetësor me kostumet e zeza të zyrtarëve e të të ftuarve të tjerë në ceremoni. Ishte pa dyshim një rastësi, por në sfond të asaj pamje, tingëllonin vërtet fjalët e drejtorit të spitalit, i cili pasi falenderoi qeverinë e Landit të Baden Vyrtembergut për kujdesin e saj dhe pasi i siguroi qytetarët e Untergruppenbahut se ai bashkë me gjithë personelin tjetër do të bënin çmos që të përligjinin këtë kujdes, e përfundoi fjalën e tij me një mbyllje disi patetike, që bëri shumë njerëz të përloreshin. Të

jeni të bindur tha ai, se në këtë spital jeta do të luftojë kundër vdekjes, drita kundër errësirës, e mira kundër të keqes. Do të luftojmë dhe do të fitojmë.

II

Ministrisë së punëve të Brendshme të Landit të Baden Vyrtembergut, Drejtorisë së Emigrantëve.

Unë i nënshkruari J.G. ish-qytetar jugosllav me kombësi shqiptare, me profesion gazetar, i arratisur nga RF e Jugosllavisë për arsye politike, duke falenderuar edhe një herë qeverinë e RF Gjermane për dhënien e strehimit politik, shfaq dëshirën time që për arsye sigurimi të vendosem në Untergruppenbah.

Siç kam deklaruar edhe në kërkesën time për strehim politik, krahas punës sime si gazetar do të merrem njëkohësisht, ashtu si edhe më parë me letërsi dhe me muzikë.

Me respekt, etj. etj.

III

Drejtorisë së spitalit të Untergruppenbahut.

Në bazë të shkresës Nr. 311 dt 3. V. 1980 të Ministrisë së Shëndetësisë së Landit të Baden Vyrtembergut, bazuar në protokollin e bashkëpunimit kulturor midis RF Gjermane dhe Jugosllavisë, nënshkruar nga qeveritë e dy vendeve (pika 14 C e aneksit mbi këmbimin e përvojës profesionale) mjeku jugosllav G. Vidiç, kirurg, dërgohet në spitalin tuaj për një afat njëvjeçar.

IV

Nga hetimet private për G. Vidiqin

Vidiq? Ishte një burrë i gjatë afër të pesëdhjetave, apo ndoshta dukej aq për shkak të tëmthave të thinjur. Ishte profesionist i mirë, madje unë disa herë kisha bërë me veten time pyetjen: vërtetë përfiton ndonjë gjë të madhe në spitalin tonë? Fliste mirë gjermanishten, ishte i rregullt dhe kishte fituar simpatinë e një pjese të mjekëve për gatishmërinë që tregonte për t'i zëvendësuar në rojën e natës.

Në fillim ne ia kërkonim me drojtje një gjë të tillë, kishim përherë frikë se mos abuzonim me gatishmërinë e tij, por pastaj e kuptuam se e bënte këtë gjë me dëshirë. S'ka pse të druemi, tha një ditë kolegu ynë. Ai është i huaj këtu dhe, në atë mënyrë jetese të mbyllur që bënë për kalimin e mbrëmjes, roja e natës është padyshim formula më e përshtatshme, për të përdorur një shprehje tepër të kohës.

Tjetër?

Çfarë të them unë tjetër? Ishte përgjithmonë një tip i qetë. Veç e kapte një lloj trazimi, ndoshta kjo s'është fjalë e saktë, një lloj ankthi do të thosha, ndonëse edhe kjo s'është e saktë. S'di si t'ua shpjegoj, do ta quaja trazim ndoshta edhe ankth sikur të mos kishte një si pikë të ngrirë në vështrim. Afrohej te xhamllëku i madh i dhomës së pritjes, ja atje, dhe ashtu përhumbshëm vështronte rrugën automobilistike. Nganjëherë të dukej se priste diçka, apo ndoshta e jepte këtë përshtypje ngaqë ishte i huaj dhe dihet që për të huaj rruga do të thotë diçka më shumë se për vendësin, andej vijnë letrat për të, ndonjë pako për Vitin e Ri, lajmet për të vetët.

Ah, me që ra fjala për postën, desha të them se ishte veçanërisht i ndjeshëm ndaj ziles së telefonit. Madje disa herë, po ta vëreje me kujdes të jepte përshtypjen se ishte në përgjim të paprerë të tij. Po kjo ishte gjithashtu e kuptueshme për një të huaj, megjithëse duhet thënë se nuk mbaj mend t'i kenë telefonuar ndonjë herë të vetët, me përjashtim të ndonjë rasti, në mos gabohem në kujtesën time.

Dhe ky përgjim i telefonit mos u shpeshtua kohët e fundit?

Nuk mund ta them një gjë të tillë më kuptoni, ishte një gjë të them e rëndomtë, që edhe po të ndodhte vështirë se do të binte në sy. Një gjë me të vërtetë mund të ishte pakëz e habitshme, madje që të jem i saktë dua t'ua pohoj se tani që po e sjell ndërmend po më duket për herë të parë e tillë. Por... para se të vij te kjo, desha të them se ajo turbullira për të cilën fola pak më parë, domethënë xhamllëku, ngrirja e vështirimit, rruga automobilistike, etj. ndodhte sidomos sa herë që dëgjohej sirena e makinës së ndihmës së shpejtë, e asaj që sillte të aksidentuarin. Ishte ndonjë kujtim personal, tronditja para operimit të ngutshëm, apo diçka tjetër, vështirë të përcaktosh. Ai nuk ishte mjek i ri, dorën e kishte të sigurtë dhe veç kësaj, dihet që operacioni i ngutshëm i një të aksidentuari të mbytyr në gjak, ka gjithmonë më pak ankth se operimi i të sëmurit për të cilin ke ditë që përgatitesh.

Kështu që... ah, po e kisha fjalën te gjëja e habitshme, që e përmenda pak më parë. Pra, të gjitha këto ishin të shpjegueshme njëfarë soj. E vetmja gjë që mund të dukej e habitshme ishte fakti që kureshtja e tij për telefonin (nuk e di nëse fjala kureshtje është e përshtatshme për këtë rast), pra kureshtja e tij për telefonin në vend që të zbehej, me afrimin e makinës së urgjencës theksohej më tepër. Kështu për shembull e mbaj mend fare mirë rastin kur pasi kishte vënë dorëzat e operacionit dhe maskën, për habinë tonë të madhe e hoqi në çast këtë të fundit për të pyetur: "Mos po më kërkoni në telefon?" Në të vërtetë zilja e telefonit po binte në sallon, dhe ai nuk e vuri maskën vetëm pasi e mori vesh se kërkonin dikë tjetër.

Po në ditën e shtatëmbëdhjetë janarit a foli në telefon me dikë?

Me sa di unë, jo.

V

Nga dëshmitë për natën e shtatëmbëdhjetë janarit. Zigrid D., gjerman, banor i Unterguppenbahut fqinj i viktimës.

Ora kishte kaluar dhjetën. Megjithëse nata ishte e ftohtë kisha dalë në ballkon për të marrë ajër të pastër. Rruga përpara shtëpisë sime ishte e shkretë, kështu që e dëgjova fare qartë gërvimën shkaktuar prej hapjes së garazhit të J.G. prej nga ai bashkë me dy të tjerë po nxirrnin makinën. Një copë herë u morën me të ngaqë siç dukej rruga kishte zënë akull dhe rrotat rrëshqisnin. Më në fund u futën të tre në makinë, por nuk arritën të nisen. Dikush u afrua nga e djathta dhe e qëllloi me breshëri makinën. Pastaj njeriu u largua me vrap. Dy-tri sekonda më pas, ndoshta nga qoshja prej nga kishte behur ai, ndoshta nga ndonjë tjetër drejtim që s'e vura re, një tjetër njeri iu afrua makinës, nuk ishte i pari, sepse ndryshonte nga shtati, veç kësaj në vend të armës automatike mbante në dorë diçka të vogël, me siguri revolver ose bombë. Sa mbërriti te makina hapi derën e prapme dhe në çast u tërhoq pas, sepse njëri nga viktimat u rrëzua në këmbët e tij. E kapërceu me këmbë trupin e tij dhe nëpër derën e hapur vështroi një grimë brenda makinës, pastaj u largua me vrap, njëlloj si i pari.

Rruga vazhdonte të ishte e boshatisur dhe unë hyra brenda për t'i telefonuar policisë.

Nga dëshmia e Peter S., polic.

Kur mbërritëm ne (ora po afrohej njëmbëdhjetës, në mos gaboj), njëri prej viktimave gjendej ende i rrëzuar përdhe, me fytyrë nga toka. Tjetri, ai që ishte në timon, dukej menjëherë që kishte ngrirë në vend ashtu siç e kishte zënë çasti i vdekjes. Një grua, e shoqja me sa dukej qante me kokën rrëzuar në timonin e makinës. I treti, J.G, siç e morëm vesh më pas vazhdonte të rrinte gjysmë i përkulur te dera e prapme, si njeriu që bëhet gati të zbresë. E shoqja i fërkonte ballin si dhe njërin krah. Flisnin të dy në një gjuhë të panjohur (shqip, siç e morëm vesh më pas).

Sipas dëshmisë së Karl K, ndihmës mjek i spitalit të Untergruppenbahut.

Makina e ndihmës së shpejtë mbërriti një minutë pas asaj të policisë. Dy nga viktimat kishin vdekur, madje ishin ftohur. I treti J.G. ishte gjallë.

Në kohën që po e ngrinin për ta vendosur në makinë ai tha: "Dua të bëjë një deklaratë" gjë që tregonte se ishte krejtësisht në gjendje të ndërgjegjshme.

"Më vonë thash unë. Do të keni kohë më vonë."

Ndihej menjëherë që kishte shumë plumba në trup. Gjatë rrugës përsëriti edhe njëherë dëshirën për të bërë deklaratën. Siç duket një ide e tillë e lehtësonte.

VI

Nga dëshmia e S.G, bashkëshorte e J.G.

Sapo u dëgjuan krismat kunata thirri e para: "I vranë"! Isha e veshur dhe u sula jashtë pa e pritur. Makina ishte disa metra larg hyrjes së garazhit me faret ende të ndezur. Po unë nuk i hiqja do sytë nga një gjë e zezë në anën e djathtë të saj. Kur u afrova dhe pak dallova që ishte një trup njeriu i rënë përmbys. Rrëshqita, gati u rrëzova mbi të. Ishte K.Z. i vdekur. Nuk e mbaj mend si u ngrita. Mbaj mend vetëm se u gjeta te xhami i hapur nga ana e timonit. Ishte kunati i ngujuar në ndenjësë. Duart i kishte hequr nga timoni dhe i mbante mbi gjunjë. Sytë i kishte të mbyllur. Tepër i zbehtë.

I futa duart pas zverkut për t'i kërkuar plagët. S'kishte. Pa pritur i pash brimat e plumbave në faqe. Edhe ai kishte vdekur. Brenda në makinë ishte gjysmë terr dhe në krye s'dallova kurgjë, gjersa ndjeva zërin e J. që tha:

- Çikë, qe ku jam.

Kështu më thërriste zakonisht, "çikë". Zërin e kishte të qetë të kthjellët. Apo ndoshta m'u duk ashtu prej fjalëve që shqiptoi. Kurse mënyra si qe mbledhur kruspull me një dorë të mbështetur te shkallina e makinës, jepte në kundërshtim me zërin, një mundim të madh.

- Oh, - ia bëri kur e preka në shpatulla, - Aty i kam.

Kështu më tha, me siguri për plumbat.

Pastaj:

- Kjo dorë m'u mpi. Ma liro pak.

- J. më ndjen? - e pyeta

- Në bark kam të tjera, - foli ai.

- S'dija si t'ja lehtësoj dhimbjet.

- K. e shoh që ka vdekur, - tha me vështrimin e ngulur nga kufoma në rrugë. – Shife B. te timoni.

U mata t'i thosha se vëllai ishte gjallë, po në atë çast u ndie kuja e kunatës, që porsa kishte mbërritur.

- Ka vdekur, - tha ai.

- Ndoshta jo.

Që nga larg u ndie një sirenë makine. Duhej të ishte policia ose ndihma e shpejtë.

VII

Rruga gjer në spital ishte vende-vende e mbuluar nga bora. Ashtu pjesë-pjesë e mbuluar, me mpirje riprodhohej ajo më vonë në kujtesën e S.G.

Meqenëse nuk e lejuan të hipte në makinën e ndihmës së shpejtë ajo e ndoqi atë me taksi. Dritat e prapme të makinës së spitalit regëtinin si të ngulura me tyrjelë në trupin e saj. Ishte e vetme. Kunata kishte mbetur me fëmijët që kishin arritur të dilnin gjithashtu nga shtëpia për të parë ç'kishte ndodhur.

Përpiqej të kujtonte faktet e ditëve të fundit, gjëra që mund të kishin zgjuar dyshime, fjalë të J., për ndonjë rrezik të mundshëm, por nuk i kujtohej asgjë. Nuk i kujtoheshin as numrat e telefonave të miqve, të njerëzve të afërt. Qysh te shifra e tretë binte mjegulla. Pastaj te e katërta, te e pesta... Shifrat e fundit këputeshin në humnerë.

I kujtoheshin vetëm ca parandjenja të këqija. Por edhe për to nuk ishte e sigurtë nëse i kishte dëgjuar diku apo i kishte menduar ajo vetë. Ishte thënë diçka për natën e 17 janarit. Për 17 janarin e vitit 1467. Madje ishte përmendur vdekja: Ah, po, një orë më parë e kishte përmendur J. Sot është dita e vdekjes së Skenderbeut. Kështu kishte thënë duke kthyer kokën nga kalendari ku ishte një pikturë e Degas, një balerinë aq e papërshtatshme për ditën e mbarimit të kryezotit mesjetar... E megjithatë, tani dukej se pikërisht ajo balerinë i sulej nga grumbujt e borës ndanë rrugës, drejt xhamit të veshur të taksisë si për t'i kumtuar diçka që ngjante herë si shpresë e dhimshme, herë si një hare misterioze.

VIII

Në orën 23.20 J.G. gjendej i shtrirë në tryezën e operacionit. Në kohën që narkozdhënësi po i afrohej ai i bëri një gjest me dorë si për ta ndalur dhe për herë të tretë tha se donte të bënte një deklaratë në prani të mjekëve dhe të një përfaqësuesi të ligjit. E futën policin Peter S. pasi i veshën me shpejtësi bluzën e bardhë dhe në prani të tij e mjekëve tha me një zë që për herë të parë jepte shenjën e lodhjes: "Deklaroj se mua J.G., vëllanë tim B.G. dhe shokun i vrau policia e fshehtë jugosllave... për të vetmen arsye se ne luftojmë për të drejtat e shqiptarëve të Kosovës... dhe që Kosova të jetë Republikë... Kaq kisha."

Dy mjekët dhe infermierët me maskat, që gjatë deklaratës kishin qëndruar si të ngrirë, lëvizën pas fjalëve të tij "Kaq kisha."

Në të vërtetë përpara se të vihej re lëvizja vetë, atë e dhanë rrezatimet e bisturive në duart e tyre.

Në valën e parë të turbullirës që i dha narkoza, i plagosuri i pa fytyrat e mjekëve si të ngjitura me njëri tjetrin dhe emri "Vidiq" që mjeku i parë, që u përkul mbi të kishte shkruar te jaka, atij duhet t'i jetë dukur si "Vilhelm" ose "Vili", përndryshe ishte ende në gjendje të bënte së paku një shenjë për të shmangur mjekun me emrin e rrezikshëm.

Në të vërtetë ia nguli sytë një grimë për herë të dytë jakës së Vidiçit(???ç ose q gjithkund), tha më vonë infermierja Marta H. por nuk pati në vështrimin e tij kurrfarë shenje pakënaqësie, pa le pastaj frike ose ankthi. Pati vetëm një lloj habie, por edhe ajo e lehtë.

Që s'pati kurrfarë shqetësimi e pohoi edhe polici Peter S. që ende s'kishte dalë nga salla dhe që, për shkak të deklaratës së porsabërë hetonte me kujdes fytyrën e viktimës.

Mungesa e shqetësimit vërtetonte se i plagosuri nuk e kishte lexuar saktë emrin e Vidiçit. Habija, për të cilën foli infermierja dhe që nuk u kundërshtua prej policit mund të jetë shkaktuar prej tërheqjes së vëmendjes nga diçka e atypëratyshme, për shembull përse emri Vilhelm, ose Vili ishte shkruar me një V dhe jo me W.

Në qoftë se kishte qenë kështu, atëherë kishte mundësi që në çastet e agonisë në prag të humbjes së ndërgjegjes V-ja ose V-të së bashku të jenë vendosur e zhvendosur shumë herë mbi njëra-tjetrën, në përfytyrimin e tij me shpejtësi të ethshme siç ndodh në gjendjet delirante. Dhe gjithmonë siç ndodh në gjendje të tilla objektet e përfytyruara, jo vetëm lëvizin me shpejtësi të çmendur, por me të njejtën shpejtësi marrin formë e kuptime simbolike nga më të larmishmet. Ka mundësi që këto V, të kenë marrë dhjetëra e qindra pamje e kuptime të ndryshme aty për aty, gjithmonë po të ndjekim këtë pandehmë, aherë mund të ketë ndodhur që midis qindra pamjeve ato V t'i kenë ngjarë viktimës, qoftë edhe për një grimë, me dhogat që vendosin dikur pjerrtasi në varre, në vendlindjen e tij të largët, përpara se i vdekuri të mbulohej me dhe.

IX

Nga hetimet krejtësisht private për Vidiçin.

Si qëlloi që Vidiçi kishte roje atë natë? Kishte radhën e tij apo si zakonisht zëvendësonte dikë?

Nuk më kujtohet saktë. Zëvendësimet që bënte ishin aq të shpeshta saq s'binin në sy si të tilla. Më kuptoni ç'dua të them, zëvendësimet e tij prej kohësh na dukeshin të gjithëve si një gjë normale.

Ju kuptova. T'ju pyes për diçka tjetër. Atë mbrëmje, kur mori rojen, a ishte në po atë gjendje si mbrëmjet tjera? Desha të them na erdhi si zakonisht apo me ndonjë farë nguti, shqetësimi, apo me atë ndjenjë ankthi për të cilën folëm para ca ditësh?

Si të them, nuk vura re një gjë të tillë. Më kuptoni, kur nuk e ke mendjen në diçka të tillë.

Ju kuptoj. Po më pas, në kohën kur u dëgjua sirena e makinës së ndihmës së shpejtë dhe sidomos kur u pa se viktimja që ajo solli nuk ishte thjesht një i aksidentuar, por një viktimë e bërë shoshë nga plumba a pati ndonjë trazim të veçantë?

Si të them. Kur u dëgjua sirena nuk e pashë. S'di ku ishte, ndoshta pinte cigare në sallon. Kurse më pas, kur e zbritën të plagosurin ne ishim aq të tronditur të gjithë, sa që vështirë se tronditja e dikujt mund të binte në sy. Qyteti ynë është i vogël dhe të masakruar të tillë nuk të bie rasti të shikosh shpesh.

E mori vesh Vidiçi ç'ishte i plagosuri?

Pa dyshim. Ai e bëri deklaratën në sytë e të gjithëve midis një heshtje varri.

Në se ju kujtohet, në kohën kur viktimja bënte deklaratën ç'shprehje në fytyrë kishte Vidiçi!

S' mund të them asgjë. Ne i kishim sytë të gjithë te fytyra e të plagosurit. Ishte aq tronditëse gjithçka sa që edhe tani ngjethem ku e kujtoj.

Operacioni i parë u bë prej Vidiçit dhe Weberit, asistentit të tij apo jo? Pas këtij operacioni J.G. ishte gjallë, dhe përgjithësisht në gjendje të mirë. Në qoftë se Vidiçi do të donte të...

O, ju lutem zotni mos më bëni pyetje të tilla.

Unë po ju bëjë një pyetje që është lehtësuese për Vidiçin... Pra nëqoftëse Vidiçi do të donte t'i bënte atë... ai kishte mundësi qysh në operacionin e parë, apo jo?

Natyrisht.

Atëherë ç'ndodhi pas operacionit? Si ishte gjendja e tij shpirtërore? A ndihej mëdyshja, lufta e motiveve, lehtësi apo zymtësia?

O, ju bëni pyetje tepër të vështira, zotni. Ju më premtuat se do të më bëni disa pyetje të thjeshta.

Më falni zonjushe, që nuk e mbajta dot fjalën. Është fjala jo vetëm për një jetë njeriu, është fjala për shumë, shumë më tepër, besoni!

Ju besoj zotni.

A e kërkoi ndokush Vidiçin në telefon pas operacionit të parë?

Jo.

Po ai vetë a telefonoi? Kaldajisti thotë se ai mori në telefon dikë nga telefoni i bodrumit.

Ka mundësi të ketë marrë andej, unë nuk di gjë.

Dhe ka folur në gjuhën e vet.

Unë s'di gjë. S'e kam dëgjuar kurrë të flas në atë gjuhë.

Si ishte gjendja e tij pas telefonimit? Desha të them gjendja e tij shpirtërore, aty rreth orës një pas mesnate?

Si të them... e zymtë.

X

Na pohimi i rastësishëm i kaldajistit Johan T.

Vidiçi foli nga telefoni i bodrumit në orën një pas mesnate. Duhet të ishte fill pas operacionit të parë, sepse në mëngët e përparses kishte ende njolla gjaku. Zërin e kishte të lodhur, të munduar. Ai sa vinte i dobësohej, kurse në fund të bisedës, vuri dorëzen e telefonit, mbështeti ballin mbi aparat dhe ndenji mjaft kohë ashtu. Kishte ndjenjën e njeriut krejtësisht të dërmuar, sa që në çast m'u duk se po qante dhe u bëra gati ta pyesja: "Ç'keni kështu zotni?" Por e mbajta veten ngaqë ai nuk më kishte vënë re dhe mendova se ndoshta do t'i vinte zor që po e shihja në një gjendje të tillë.

XI

Në orën 1.10 pas mesnate në kujtesën e S.G. erdhi numri i parë i telefonit. Pas tij u çliruan të tjerët. Njëri pas tjetrit vinin nga sferat e panjohura ku ishin tërhequr.

Kur ajo formoi numrin e parë ndjeu duartë t'i dridheshin dhe vetëm atëherë e kuptoi se sa fort i kishte copëtuar gishtat gjatë gjithë kohës që kishte vazhduar operacioni. Alo, jam S. Tim kunat e vranë para dy orësh. K.Z. gjithashtu. J. porsa doli nga salla e operacionit. Është plagosur rëndë. Narkoza ende s'i ka dalë.

Në orën 2 ende s'kishte mbërritur asnjë nga miqtë. Ishin larg në qytete tjera dhe koha që krejt e papërshtatshme për të nxituar në rrugët e akulluara.

N'orën 2.30 pritej dalja e narkozës.

N'orën 2.40 asaj i dhanë përsëri një qetësues.

N'orën 2.46 u ndie një gjallërim përpara sallës së reanimacionit. Ç'është? mendoi ajo. Pastaj e bëri pyetjen me zë. Një ndihmës mjeku i tha që të mos shqetësohej. I plagosuri kishte një keqësim të lehtë dhe po i bënin një gjilpërë. Janë gjëra të zakonshme pas një operacioni të tillë, i tha ndihmësmjekja.

N'orën 2.52 trazimi nuk po qetësohej në reanimacion.

N'orën 3 ora ngjante si e mbetur në vend.

N'orën 3.10 truri i saj i lodhur kapi fjalën "operacion".

Iu desh disa sekonda sa ta dallonte nëse e kishte dëgjuar vërtet apo ishte brenda mendimit të saj.

N'orën 3.11 e kuptoi të vërtetën dhe pyeti me dënësë:

Përsëri operacion? A është e mundur? A është e nevojshme?

Asnjë nga miqtë nuk kishte mbërritur ende.

Ejani në sallon zonjë. Ky është një operacion i thjeshtë. Shumë më i thjeshtë se i pari. Ka mundësi të ketë ngelur ndonjë plumb i fundit. Mos u shqetësoni.

N'orën 3.15 ajo ndodhej përsëri në kanapenë e sallës së pritjes. Duart i kishte të akullta dhe në mendje iu krijuan prapë zona boshe.

Iu duk se që jashtë u dëgjua frenimi i një makine, por e harroi sakaq.

Një infermiere, ajo që i dha qetësuesin e fundit u ul pranë saj në kanape.

-Nga jeni? – e pyeti me dhimbshuri. – Nga e folura dihet që jeni e huaj.

- Jam shqiptare nga Jugosllavia – tha ajo. – Nga Kosova.

- Nga Jugosllavia? – tha infermierja. – Sa mirë paska qëlluar, mjeku që po e operon burrin tuaj është jugosllav.

-Si???

(Nuk kisha parë ndonjëherë vështrim që mund të shkatërrohej në çast si në filmat me tmerre, kishte thënë infermierja).

E çmendur, gruaja kishte renditur përjashta nëpër korridor, tamam në kohën që mjeku Vidiç sapo kishte dalë nga salla e operacionit dhe po i thoshte diçka një të panjohuri.

Ajo nuk i dëgjoi fjalët e mjekut në fillim, as e njohu të porsaardhurin, njeriun që e kishte kërkuar të parin në telefon, në kohën kur u bë e aftë për një gjë të tillë... ajo dalloi vetëm

tre gishtat e mjekut të ngritura përpara fytyrës së panjohurit, siç bëhet në rastet kur tjetri nuk e kupton mirë gjuhën.

-Çfarë? – pyeste me egërsi i panjohuri dhe mjeku vazhdonte të mbante përpara tij, skeptër të mënyrshëm, cfurk tredhëmbësh të Posejdonit, tre gishtat e tij.

- Të thashë një herë, kanë vdekur të tre.

- Ç'po thua rrezikzi, - thirri i panjohuri. – Po mua më thanë se njëri është gjallë.

Në atë çast ai ndjeu praninë e gruas dhe iu kthye asaj, për ta përqaftuar, për ta ngushëlluar, për ta pyetur se ç'ka po fliste ky i çmendur, kurse e vërteta siç ia kishte thënë ajo në telefon duhej të ishte krejt ndryshe.

Por gruaja nuk shihte kurrigjë. Sytë e saj vështronin vetëm një pikë te jaka e mjekut, atje ku në një pllakë të vogël plastike blu ishte shkruar emri "Vidiç".

Ajo e afroi kokën edhe më shumë mbi atë pllakën, pastaj e kapu mjekun nga përparsja e bardhë si të donte ta rrëzonte atë.

- Ti e vrave? – klithi me zë të çjerrë. – I ti si ga ubio.

I bardhë në fytyrë si gëlqere mjeku u mbajt me një dorë nga muri, ndërsa gruaja vazhdonte të klithte në gjuhën serbe. Gjatë gjithë kohës që vazhdoi kjo skenë e rëndë ai nuk iu përgjigj asaj asnjëherë në sërbiisht, pohuan dëshmitarët. Ishte tejet i tronditur, dukej çdo çast se do të rrëzohej, gjersa ndërhyne dhe i larguan gruan.

XII

J.G. emigrant politik shqiptar i arratisur nga Jugosllavia, me nënshtetësi gjermane, gazetar, poet dhe muzikant vdiq më 17 janar 1982, në orën 3.15, pas mesnate, gjatë operacionit.

Ky ishte shënimi për mbarimin e tij në librin e spitalit të Untergruppenbah-ut.

Policia nuk arriti asnjëherë të zbulonte vrasësin. Akuzat e bashkëshortes së tij kundër mjekut Vidiç, megjithëse të formuluar nga një avokat i dëgjuar, nuk u morën parasysh për mungesë provash.

Mjeku Vidiç u largua nga Untergruppenbahu qysh të nesërmen, në ditën e ftohtë të ngjashme me atë ditë në të cilën kishte ardhur. Veçse në ndryshim me ardhjen, largimi i tij nuk figuronte në asnjë shkresë, protokoll, ose shtojcë protokollit.

Për të u fol një farë kohe në rrethe të ndryshme, por ato që fliteshin ishin në përgjithësi gojëdhëna. Delire të ndryshme të sëmurësh në spitale psiqiatrike, pendesa, vrasje ndërgegjesh.etj. u dhanë disa herë si të tjtë, por asnjëherë nuk u saktësua kjo gjë.

J.G. u varros në varrezën e Shtuttgartit. Ndërsa kërkonin një tekst sa më domethënës për ta gdhendur mbi varrin e tij, njerëzit e familjes dhe dashamirësit e tij dëgjuan me radhë disqet me këngë e balada që ai kishte shkruar, kompozuar dhe kënduar vetë, pjesën më të madhe të shoqëruara me kitarë.

Duke i dëgjuar në heshtje, ata erdhën në një mendje se shumica e këtyre teksteve ishin të përshtatshme për t'u gdhendur në mermerin e varrit. Kjo binte në sy kaq qartë, sa që një ditë, në një nga ato ditë kur e qeshura dhe humori, rifituan më në fund të drejtën të pranoheshin në bisedat për kujtimin e të ikurit, si për ta bërë edhe më brilante dhembjen, njëri nga miqtë e tij tha se kishin të drejtë të akuzonin J. se kishte përgatitur ai vetë vrasjen e vet.

Teksti i mbishkrimit u zgjodh më në fund prej njëres prej baladave të tij, por drejtorja e varrezës nguli këmbë që të bëhej një ndryshim në të. Ishte prerja, ose për të përdorur një fjalë më të kohës, censurimi i fundit që iu bë J.G. në jetën e të cilit kishte patur disa herë ndërhyrje të tilla, duke përfshirë këtu edhe vdekjen e tij, e cila në fund të fundit s'ishte veçse një prerje.

Fund

(www.pashtriku.org, 15 janar 2009)

Suzana Gërvalla: *(Për mjekun Vidiq)* "Ne mendojshim se ai e ka vra në operacion por nuk kish qenë ashtu. Se vajza ime e ka marrë dosjen nga (organet) gjermane dhe aty në dosje shkruan se ai (Vidiqi) ka qenë kroat që e ka operuar. Jusufi para se me hy në operacionin e dytë ka kërkuar që ta jep një deklaratë, se neve na ka vra UDB-a dhe ky mjeku (Vidiqi) ia ka përkthye deklaratën". (Suzana Gërvalla, Intervistë/Pjesa e dytë, Oral History Kosovo, YouTube, 3 gusht 2017, koha në film 20:00-20:46)

14. UDB'a E PRANON SE I KA VRA: JUSUF E BARDHOSH GËRVALLËN

Në procesin gjyqësor kundër kryekriminelit Millosheviç në Hagë, ka dëshmuar edhe një shqiptar (ish'udbash) i mbrojtur me Kodin K-6. Në seancën gjyqësore të datës 10 qershor 2002 dëshmitari K-6 ka pranuar se vëllezërit Jusuf e Bardhosh Gërvalla i ka vrarë Sigurimi Sekret serb. Për të argumentuar këtë fakt, po i referohemi dokumenteve zyrtare nga procesi gjyqësor kundër Sllobodan Millosheviçit.

* * *

Dëshmitari i mbrojtur K-6 i prokurorisë në gjykimin e Sllobodan Millosheviçit në Tribunalin e Hagës

I AKUZUARI I KA DITUR TË GJITHA RRETH UÇK-së

Hag, 10 qershor 2002 / FoNet:

Dëshmitari i mbrojtur K-6, një punëtor i Shërbimit të Sigurimit Shtetëror (Služba državne bezbednosti - SDB), i cili ka punuar në fund të viteve nëntëdhjetë në Kosovë, në gjykimin kundër Millosheviçit në Gjyqin e Hagës, deklaroi se "i akuzuari ka qenë i informuar deri në detaje më të hollësishme mbi terrorizmin në Kosovë."

"Çdo informatë e lidhur me Kosovën apo rreth Kosovës i ka shkuar Shefit të Shërbimit të Sigurimit shtetëror Jovica Stanishiçit, dhe mund të ju bindi se i akuzuari (S. Millosheviç) ka qenë i njoftuar mbi të gjitha, edhe për detajet më të hollësishme, dhe atë përmes Stanishiçit" ka thënë ky dëshmitar. Stanishiçi, tregon më tej dëshmitari K-6, i ka marrë informatat nga njeriu i parë i Shërbimit për Kosovën David Gajiq dhe kryesuesi i Sigurimit Shtetëror për Prishtinën Milan Laković Mishko, këshilltar i të cilit ka qenë Lutfi Ajazi.

Dëshmitari K-6 flet shqip, nën masën mbrojtëse distorzion (kamufli) të figurës. Seanca disa herë është mbyllur për publikun, kur janë shqyrtuar çështje, që kishin të bënin me identitetin e tij. Gjykatësi Richard Mej ka tërhequr vërejtjen në fillim të seancës, se përmendja në çfarëdo mënyre e emrit të dëshmitarit do të trajtohet si mosrespektim i gjykatës.

* * *

Fragment i shkëputur nga transkripti

10. 06. 2002 – Millosheviçi dhe Haga

PROKURORI NAJS: Sektori në të cilët është ndarë Shërbimi i Sigurimit Shtetëror, a janë këta sektor nën numrin tetë apo vetë Shërbimi i ka tetë sektore, nuk jam i sigurt. Në cilin numër keni qenë ju? Në cilin sektor keni punuar ju?

DËSHMITARI K-6: Në të tetin.

* * *

I AKUZUARI MILOSHEVIÇ: Kur jeni duke folur për bazat e forta në botën e jashtme, a është e vërtetë se UÇK'ja ka pasur baza të forta në Gjermani, Zvicër dhe Belgjikë? A është e vërtetë kjo apo jo?

DËSHMITARI K-6: Ashtu është.

I AKUZUARI MILOSHEVIÇ: Sipas njohurive tuaja, themeluesit e UÇK'së qysh në vitin e largët 1975, në mes tjerësh kanë qenë vëllezërit Gërvalla, a është kjo e vërtetë?

DËSHMITARI K-6: Kjo nuk është e vërtetë.

I AKUZUARI MILOSHEVIÇ: Nuk është e vërtetë a?

DËSHMITARI K-6: Jo.

I AKUZUARI MILOSHEVIÇ: Mirë. Ju thoni, vetëm një moment, shumë e gjatë është kjo deklaratë, ja në faqen 19: "Themeluesit kanë qenë vëllezërit Gërvalla, Jusuf e Bardhosh, të cilët e kanë themeluar në Gjermani. Ata kanë jetuar në Ludwigsburg." Dhe a është e vërtetë kjo që thoni se njerëzit të cilët i kanë vra këta të dy kanë qenë Lutfi Ajazi (përmendje në vazhdim), Selim Broshi dhe Jusuf Karakushi, gjithashtu të gjithë shqiptarë. A është e vërtetë kjo? E vërtetë apo e pavërtetë?

DËSHMITARI K-6: Është e vërtetë se ata njerëz i ka vra policia, sigurimi sekret.

I AKUZUARI MILOSHEVIÇ: Ju thoni në deklaratën tuaj se këtë e kanë bërë Lutfi Ajazi, Selim Broshi e Jusuf Karakushi, a është e vërtetë kjo apo nuk është?

DËSHMITARI K-6: Është e vërtetë. Ata kanë qenë të punësuar në sigurim. (www.pashtriku.org, 25 janar 2010)

15. VËLLA I DHEMBJES KRENARE

Shkruan: Sabri Maxhuni - Novosella
(Kushtuar Heroit Jusuf Gërvalla)

Sytë i mbylle ashtu siç i ka hije trimit
Ne mbetëm me dy dëshira në gj
Mbi kullat tona të mos valoj flamur i huaj
Dhe ta japim frymën e fundit ashtu si e dhe Ti.
Këto dy dëshira Ti gjithnjë i pate
Pa arrirë në të parën, në kandil u shndërrove
Që ne sot rrugën na e ndriçon,
Këtë rrugë që së bashku e rrahëm,
Kësaj rruge që s'do t'i ndahemi,
Kësaj rruge të ndriçuar si Ti dhe nga ata si Ti.
Kjo rrugë do të na qoj në një ditë
Ku do t'i hudhemi njëri-tjetrit në përfaqim
E lotët e gëzimit do t'i thithim në atë krenitim

Edhe se pranvera do varre do t'i gjelbëroj.
Kështu ka qenë dhe është jeta jonë,
Kështu është pasuruar trualli ynë
Me vëllezër të dhembjes krenare
Që themelet kullave tona ua forcuan,
Që ngjyrën flamurit tonë ia kuqëzuan,
Që shqiponjës dykrenare krah i dhanë
Të valoj mbi kullat tona anembanë...
(Shkruar në Adapazar - Turqi, 1982) (www.pashtriku.org, janar 2010)

16. Letër ngushëlluese nga Feriz Kunushefci

Pas vrasjes së Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës dhe Bardhosh Gërvallës (më 17 janar 1982) në adresë të Familjes Gërvalla dhe të Kadri Zekës kanë ardhur shumë letra ngushëlluese, nga anë të ndryshme të botës, si nga Sydnei i Australisë, nga Nju Jorku i Amerikës etj. Në mesin e këtyre letrave www.pashtriku.org me këtë rast ka përzgjedhur për botim letrën e Feriz Kunushefci, i cili ato ditë ishte prapa grilave - në burgun e Heilbronit.

Ferizi në letrën e tij shkruan:

E DASHURA NANË SHQIPTARE

E dashura Nanë Shqiptare.

Ket leter poe shkruiej edhe deshiroj ngushllime te thella per djemt e juej si e dhan jeten per vendlindje edhe per popullin Shqiptar. Mos u merzit hiq se djemt e juej jeten e kan dhan edhe nuk jan ma ne mesin e familjes se vet. Trupi i tyre ka vdek, por vepra e tyne edhe puna e tyne per popullin shqiptar kurr nuk ka me vdek. Banu e fort edhe thuej: Djemt e mij nuk jan dek por kan lind, se jan dek per Atdhe per popullin shqiptar. Anmiku popullin shqiptar nuk mund mei tut me pushk. Djemt e juej jan Heroja ata nuk jan dek ne krevet por tue punue edhe tue u mundue dit e nat per neve te gjithve shqiptarve. Djemt e tu i ka njoft bota edhe i njef. Djemt e juej nuk vdesin kurr sikur Skender Beu edhe Bajram Curri ata nuk vdesin por jan met neper zemrat e qdo njenit shqiptar. Mos qaj e mos u merzit se qdo Nanë nuk munet me marue asi djemsh! Une Adresin e juej nuk e di por familjen e juej e njef bota tash se e kan dhan jeten vllaznit per popull shqiptar. Une kit leter pi shkruiej se me ardh meu pa per kit vdekje nuk muj se une jam ne burg ne Heilbronn. Vetem zemra po me qan per ata dy trima tu edhe per at shokun apo mikun e djemve tu. Banu e fort edhe zemer guri se djemt tu nuk jan vdek po jan lind se e kan dhan jeten per popull te vet e jo per veti. Vllaznit: Isufin dhe Bardhin i kemi humb por ata na e kan lan ni veper edhe ni pun edhe jan vdek me ftyr edhe per popull edhe kan mbet ne zemrat tona gjithmon oj nanë. Tash po i dha fund edhe mos u mërzit ti as familja e juej hiq se per kto pun nuk mun des gjithkush oj nanë shqiptare.

Feriz Kunushefci

Nga burgu i Heilbronnit (www.pashtriku.org, janar 2011)

17. VRASJA E POETIT

Shkruan: Ndoc Pappleka *
(Kushtuar Jusuf Gërvallës)

Të vranë, he i qëlloftë moti
ata njerëz më të zinj se nata!
Kur të mori plumbi parë
u dogj një pishë në maje të Sharit.
Kur të mori plumbi i dytë
doli nga varra një tufë pëllumba
dhe u nis fluturim për Pejë.
Kur të mori plumbi i tretë
gjaku yt pikëloi mbi botë
- mbrëmë vranë Jusuf Gërvallën!

Kur të dalin gjethet e reja
do të ulet qyqja në degë të blirit
por s'do të thotë: "kuku Jusuf!"
ti nuk je baba i pa djalë
as nuk je vëlla i pa vëlla.

Sot je vëlla me ata që s'vdesin,
je vëlla me brezat që vijnë,
se gjakun tënd ia fale diellit!
Të vranë natën, he i qëlloftë moti,
pa i puthur edhe njëherë fëmijët,
pa e mbaruar vjershën e re,
pa i mbushur dhe njëherë sytë
me re e zogj që vijnë nga Jugu
pa kafshuar edhe një mollë Peje...
Agimi që shkrep mbi dëborë
kishte kuqëlimin e gjakut tënd.
* * *

KUSH ËSHTË NDOC PAPPLEKA?

Ndoc Pappleka, u lind më 1945 në Lekbibaj (Tropojë). Ka kryer studimet e larta për gjuhë e letërsi dhe ka punuar si mësues, redaktor, skenarist etj. Ka nisur të shkruajë poezi shumë herët. Libri i tij i parë me poezi është: "Zëri Im". Me pas vijnë vëllimet me poezi "Ecim"; Njatjeta, diell! - Shtëpia Botuese "Naim Frashëri" 1976; Aleksandër Moisiu Djepi i klithmave - Rilindja 1982; Rrathët e Lisit - "Naim Frashëri" 1984; Gjaku i tokës - Shtëpia Botuese "Naim Frashëri" 1985; Gjethnaja në trup - Shtëpia Botuese "Naim Frashëri" 1990; I miri prej monunit - "Naim Frashëri" 1993; Kulte, rite, magji në traditën orale - Botimet Toena, 1999 etj.

(www.pashtriku.org, janar 2010)

18. JA VDEKJE, JA LIRI!

(www.pashtriku.org, janar 2011)

Enver Hadri (1941- 25 shkurt 1990) ishte veprimtar për të drejtat e njeriut dhe për çështjen kombëtare. Në fillim të vitit 1972 ai u vendos në Bruksel, ku vazhdoi veprimtarinë politike nëpërmjet Organizatës Rezistenca Kombëtare e Shqiptarëve të Kosovës. Organ i kësaj organizate ishte revista "Zëri i Kosovës" në gjuhën shqipe dhe frënge, përmes të cilës bëhej thirrje për bashkimin e trojeve shqiptare në përgjithësi, sidomos punohej që çështja e Kosovës të futej në agjendat e diplomacisë ndërkombëtare, si Unioni Evropian, NATO, etj.. Në Bruksel ai formoi dhe drejtoi Komitetin Shqiptar për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut. Më 25 shkurt, 1990, në moshën 49 vjeçare, Enver Hadri u plagos dhe më vonë vdiq në spital nga një atentat në Sent Zhil (origj. Saint Gilles), Bruksel, i porositur nga Shërbimi Sekret Serb (UDBA). Atentatorët, Veselin Vukotić (Veshko), Andria Lakoniç dhe Darko Ashanin, e qëlluan me dy plumba në kokë deri sa kishte ndaluar makinën në një semafor. Hadri kishte me vete listën e 23 shqiptarëve të vrarë në Kosovë nga Serbia, të cilën mendonte t'ia dorëzonte të nesërmen Komisionit të të Drejtave të Njeriut të Parlamentin Evropian. Pas vrasjes së Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës dhe Bardhosh Gërvallës, më 17 janar 1982, Enver Hadri në numrin vijues të revistës "Zëri i Kosovës" që doli më 20 janar 1982 në Bruksel, botoi shkrimin "JA VDEKJE JA LIRI!" kushtuar dëshmorëve, dhe me rastin e 29 vjetorit të vrasjes së tyre, botohet në pashtriku.org.

Nga Enver Hadri

Vrasja e tre patriotëve liridashës e përparimtarë në Gjermaninë Perëndimore më 17 gjegjësisht 18. 01. 1982 në krye me Jusuf Gërvallën duhet të ngjallin mënin më të madhe kundër armikut. Këto vrasje duhet t'i bashkojnë të gjitha forcat përparimtare kosovare në luftë të vendosur drejt pavarësisë dhe socializmit të vërtetë.

Kosova jonë e dashur që nga 11 marsi 1981 u bë arenë e ngjarjeve të përgjakshme. U bë prova dhe qëndrueshmëria e shqiptarizmit. Kosovarët i vranë dhe i burgosën. Por Kosova nuk u qetësua. Kosova nuk hesht! Politika diskriminuese e qeverisë fashiste jugosllave bëri që Kosova sot të ketë shkallën më të ulët të zhvillimit ekonomik, që papunësia të arrij kulminacionin, që pasuria e Kosovës të shfrytëzohet në maksimum prej firmave të huaja. Politika hegjemoniste e serbomëdhenjve të Beogradit iu mohoi ende të gjitha të drejtat politike e njerëzore shqiptarëve të Kosovës dhe viseve tjera shqiptare në Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi.

Qeveria fashiste dhe revizioniste e Beogradit dërgon ushtri dhe polici speciale për të vrarë rininë tonë liridashëse, revolucionare dhe përparimtare (progresiste). Dërgon tanke për të shkelur fëmijët tanë shqiptarë në Kosovë. Më se tre mijë të vrarë nga policia dhe ushtria jugosllave e me mijëra të tjerë të plagosur e të humbur. Dyqind e tetëdhjetë e gjashtë vetë të dënuar me burg në kohëzgjatje prej tre deri në pesëmbëdhjetë vjet. Më së njëmijë të tjerë presin për t'u gjykuar në gjyqet e UDB'së jugosllave. Dhe ku do të ndalet ky numër... Bijtë dhe bijat më të mira të Kosovës kërkuan të drejtat legjitime të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare të okupuara nga Jugosllavia. Kemi parë ku çon politika jo e drejtë e një pseudosocializmi, siç është politika fashiste e qeverisë jugosllave. Shqiptarët vdiqën në Kosovë - për Kosovën, shqiptarët vdesin në botën e lirë - po për Kosovën! Vdesin djemtë më të mirë të kombit. Por edhe sikur të na vrasin të gjithëve këtu në mërgim, Lëvizja Nacional Çlirimtare për të Drejtat e Shqiptarëve nuk do të shuhet sepse çdo njeri nga ne e din se të vdesësh për atdhe është një privilegj.

Vrasja e tre atdhetarëve kosovarë, me në krye atdhetarin dhe përparimtarin e çmuar Jusuf Gërvalla, nga agjencia fashiste e Beogradit, duhet të ngjallë mëninë më të madhe kundër armikut, duhet t'i bashkoj të gjitha forcat përparimtare kosovare në luftë të vendosur drejt pavarësisë dhe socializmit të vërtetë.

Rezistenca Kombëtare e Shqiptarëve të Kosovës shpreh indinjatën e vet dhe proteston energjikisht kundër masave fashiste që merr qeveria e Beogradit për t'i likuiduar atdhetarët kosovarë, qoftë në Kosovë apo në botën e jashtme. Këto akte kuptohen si shpallje lufte mërgatës shqiptare. Ne të gjithë jemi bijtë e Kosovës. Ne të gjithë jemi vëllezër. E sot ne jemi më të bashkuar se kurrë, më vigjilentë dhe më të vendosur që të vazhdojmë rrugën e lirisë së Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare drejt një të ardhmeje më të lumtur.

Aventurierët, nostalgjikët dhe shërbëtorët e UDB-ës nuk kanë vend në mesin tonë. Para armikut dhe në mes të turbullirave, që ka sot në botë, asgjë nuk është e lejueshme përpos se të bashkojmë idetë tona, njerëzit tanë dhe territoret tona. Këtë detyrë të rëndë ne do ta zbatojmë për lirinë e Kosovës dhe krahinave të saja, me një ndërgjegje që t'i shërbejmë mirë dhe me vendosmëri deri në fitoren e plotë!

Kosova me ne! Ja vdekje - ja liri!

Enver Hadri, d.v.

(Enver Hadri: Zëri i Kosovës", Bruksel, 20 janar 1982. Marrë nga libri Halit Elshani: "Çeta e Brukselit", kapitulli 34, faqe 154, Prishtinë 2007)

Libra nga Xhafer Durmishi – Skenderi i Shtutgartit, për Rilindasit e Shtutgartit

01. Protesta e Aspirata – Tetor 2006
02. Lëvizja e Jusuf Gërvallës- Tetor 2011
03. Zëri i popullit dhe Zëri i Jusuf Gërvallës-Nëntor 2011
04. Të fala s'po na çojnë asnjëherë-Dhjetor 2011
05. Nuk pyesin për çmimin e lirisë-Mars 2012
06. Pa taktizime-Prill 2012
07. Në rrethin e Shtutgartit-Shtator 2012
08. Fakte për Lëvizjen e Jusuf Gërvallës-Tetor 2012
09. Luga dhe Lugina-Dhjetor 2012
10. Filharmonia e Jusuf Gërvallës-Janar 2013
11. Shokët dhe Jusuf Gërvalla-Shkurt 2013
12. Fjalori i Lëvizjes së Jusuf Gërvallës-Maj 2013
13. Argatët agresiv-Maj 2013
14. Pa trazime-Qershor 2013
15. Skena-Qershor 2013
16. Emër që u bë traditë-Qershor 2013
17. Jusuf Gërvalla dhe Liria-Korrik 2013
18. Testamenti-Gusht 2013
19. Ilustrime-Janar 2014
20. Vepra e Jusuf Gërvallës-Janar 2014
21. Ti ia ke besuar arkivin e Jusufit-Korrik 2019
22. Qendra Jusuf Gërvalla-Janar 2023
23. Lufta për liri në letrat e Jusuf Gërvallës, Mars 2024
24. Dëshmi e Dëshmorë, Janar 2025
25. HAPËSIRA, KOHA dhe Drita e Jusuf Gërvallës, Shkurt 2025
26. Referenca – Burime I-1979-1983
27. Referenca – Burime II-1982-1985

Jusuf Gërvalla: *“Kështu e pata kuptuar më në fund edhe zgjedhjen e Shpendit (Skenderit-shën im) dhe timen në Komitetin Qendror.”* (14 janar 1981)

Shënime për autorin

Xhafer Durmishi-Skenderi ka lindur në maj 1958 në fshatin Stanoc të poshtëm të komunës së Vushtrisë. Nga arsimtarët e vetë të shkollës fillore angazhohet në organizatën “Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi”. Në vitet 1977-1981 ka studiuar në Fakultetin Xehtaro-Metalurgjik në Mitrovicë, në degën e Teknologjisë. Nga korriku 1981 gjendet pranë Vëllezërve Gërvalla në Shtutgart. Pas atentatit të 17 Janarit 1982, në mars 1982, falë dhuntive të natyrës, diturive dhe cilësive të ndërgjegjes e tij, me kërkesën e rrethit të Jusuf Gërvallës vazhdon redaktimin e asaj gazete që më parë e kishte redaktuar Jusuf Gërvalla. Fillimisht në redaktimin e plotë dhe në përgatitjen teknike të gazetës kryesore të Lëvizjes për Republikë punon gjer në mars 1983. Pas një qëndrimi prej 100 ditësh në Paris, në korrik 1984 vendoset në Suedi. Në korrik 1985 shërbimet e tij për çështjen apo në emër të çështjes shqiptare, nga rrethi që i kishte qëndruar afër, nuk konsiderohen të nevojshme dhe lirohet nga detyrimet e obligimet e organizuara politike. Vepra e tij pas vitit 1985 e ka bazën në detyrimet e ndërgjegjes. Është përkthyesi i parë i autorizuar për përkthime në mes suedishtes e shqipes. Merret me përkthime. Është njohës i mbi njëzet e pesë gjuhëve të huaja.

XHAFER DURMISHI-SKENDERI

Qershor 2013-Shkurt 2026